

Dr. Musli Vërbani

HUTBE TË XHUMASË

II

Me komentim të sureve të xhuzit Amme
Nga sureja En-Nebeë deri te sureja El-Lelj

Kaçanik, 2026

Titulli: Hutbe të xhumasë II

Autor: Dr. Musli Vërbani

Korrektues: Burim Bunjaku

Përgatitja kompjuterike: Ridvan Vërbani

DHIKRI PARA HUTBES SË XHUMASË

Suret e Xhuzit Amme në përgjithësi janë sure Mekase.

Gati në secilën sure Mekase flitet për ringjalljen, dhe atë:

- Ose nëpërmjet vërtetimit dhe mbjelljes së besimit për të, me përбетim.
- Ose nëpërmjet paraqitjes së fakteve logjike dhe konkrete se një gjë e tillë është e mundshme.

- Ose nëpërmjet përshkrimit të gjendjes së asaj dite me frikësimin dhe trishtimin, dhe gjurmëve të rrezikshme të cilat përkufizohen në dy çështje:

E para: Hyrja në xhenet.

E dyta: Hyrja në xhehenem.

Ajetet Mekase në të shumtën e rasteve merren me çështjen e besimit, e më e rëndësishmja është se merret:

- Me besimin në Një Zot dhe largimi nga idhujtaria.
- Me konfirmimin e pejgamberisë apo mesazhit hyjnor dhe shpalljes, dhe për ngjarjen e kataklizmës.

SURETU NEBEË (1)

Suretu Nebeë: 1-16

عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ ﴿١﴾ عَنِ النَّبِئِ الْعَظِيمِ ﴿٢﴾ الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ ﴿٣﴾ كَلَّا سَيَعْلَمُونَ ﴿٤﴾ ثُمَّ
كَلَّا سَيَعْلَمُونَ ﴿٥﴾ أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهَادًا ﴿٦﴾ وَالْجِبَالَ أَوْتَادًا ﴿٧﴾ وَخَلَقْنَاكُمْ أَزْوَاجًا ﴿٨﴾
وَجَعَلْنَا نَوْمَكُمْ سُبَاتًا ﴿٩﴾ وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا ﴿١٠﴾ وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا ﴿١١﴾ وَبَنَيْنَا فَوْقَكُمْ
سَبْعًا شِدَادًا ﴿١٢﴾ وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا ﴿١٣﴾ وَأَنْزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرَاتِ مَاءً ثَجَّاجًا ﴿١٤﴾
لْنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا ﴿١٥﴾ وَجَنَّاتٍ أَلْفَافًا ﴿١٦﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Nebeë e ka specifikën e vet, të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Nebeë që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Suret mekase dallohen me atë se përbëhen prej ajeteve të shkurta.

Suret mekase dallohen me atë se përshkruajnë ringjalljen dhe kataklizmën.

Sureja Nebeë përshkruan kataklizmën, përshkruan kijametin.

Zoti i Madhërishëm thotë:

عَمَّ يَتَسَاءَلُونَ ﴿١﴾

عَنِ النَّبِإِ الْعَظِيمِ ﴿٢﴾

الَّذِي هُمْ فِيهِ مُخْتَلِفُونَ ﴿٣﴾

“Për çka ata i bëjnë pyetje njëri-tjetrit?

Për lajmin e madh e tronditës.

Në të cilin ata janë në kundërshti.” (*En-Nebeë: 1-3*)

Allahu i Madhërishëm nuk e ka pëlqyer mënyrën e shprehjes së idhujtarëve mekase dhe të asaj kohe se si pyesnin për kataklizmën.

Allahu i Madhërishëm nuk e pëlqen mënyrën e shprehjes së ateistëve të sodit, mënyrën se si pyesin për kataklizmën.

Allahu i Madhërishëm nuk e pëlqen mënyrën e shprehjes e besimtarëve të dobët dhe të hipokritëve se si pyesin me dyshim për kataklizmën. Andaj thotë:

Po për çka e pyesin ata njëri-tjetrin?

Po si është e mundur që pabesimtarët e pyesin njëri-tjetrin për atë të cilën e vërteton Kur’ani. Ai me të vërtetë është lajm madhështor dhe i rëndësishëm!?

Lajmi madhështor është kataklizma në të cilën ditë njerëzit ringjallen për llogaridhënie dhe për t’u shpague për veprat e tyre.

Sa i përket kësaj çështjeje, njerëzit janë nda në dy grupe:

1. Besimtarët në Kur’anin dhe atë që e thotë Kur’ani.
2. Përgënjeshtroes të Kur’anit dhe të Ditës së gjykimit, me fjalë tjera e përgënjeshtrojnë Ditën e gjykimit.

Por Zoti i Madhërishëm thotë:

“Kush do le të besojë, e kush do le të mos besojë”.

Pyesin për një çështje tepër madhështore dhe shumë të rëndësishme.

Pyesin për një çështje, për të cilën çështje konfrontohen.

Pyesin për një çështje për të cilën çështje zhvillojnë debate të panumërta:

- Disa e përgënjeshtrojnë, të tjerët e besojnë;
- Disa e mohojnë të tjerët e vërtetojnë;
- Disa nuk e pranojnë, të tjerët e deklarojnë;
- Disa dyshojnë, të tjerët janë të bindur.

E cila është ajo çështje?

Cili është epilogu i atyre debateve?

E, ajo çështje është dita e ringjalljes dhe e ngritjes nga varrezat pas vdekjes.

Sa i përket thënies së Allahut: **“Për lajmin e madh e tronditës”**. (*Nebeë: 2*), kjo i bie sikur të kishte thënë: “Po pse pyesin për këtë informatë?”. “Po pse pyesin për këtë lajmë tronditës?”, “Po pse pyesin për këtë lajm të rëndësishëm?”.

Kjo është pyetje retorike e cila tregon për mohimin e kësaj ngjarjeje nga pabesimtarët.

Besimtarë të nderuar!

Pas pyetjes retorike, Zoti u jep përgjigjen e merituar duke ju thënë:

كَلَّا سَيَعْلَمُونَ ﴿٤﴾

ثُمَّ كَلَّا سَيَعْلَمُونَ ﴿٥﴾

“Jo, të mos pyesin, sepse ata do ta kuptojnë! Përsëri Jo, se ata do ta kuptojnë!” (*En-Nebeë: 4, 5*)

“Jo, jo, Assesi!”. Për këtë çështje nuk duhet të konfrontoheni.

Nuk keni për çka të debatoni për këtë çështje.

Ajo ngjarje është e saktë, nuk duhet dyshuar në të.

Le të heqin dorë nga parashtrimi i asaj pyetjeje.

Kjo nga shkaku se i gjithë njerëzimi do ta kuptojnë përfundimin e përgënjeshtërimit të asaj ngjarjeje.

Kjo nga shkaku se i gjithë njerëzimi do ta kuptojnë përfundimin e mohimit të asaj pyetjeje.

Përsëri Zoti i Madhërishëm thotë: Jo, jo, assesi! Katakлизma dhe ringjallja absolutisht do të ndodhë.

Do ta kuptojnë se Kur’ani është i vërtetë prej Allahut.

Do ta kuptojnë se ringjallja është gjykim i drejtë dhe kur do ta shohin dënimin – siç thotë kur’ani - do të thonë: **“O, të mjerët ne, kjo është dita e gjykimit!” Kjo është dita e ndasisë që ju e konsideruat rrenë.”** (*Saafat, 29*)

Vëllezër të nderuar!

Në pjesën e dytë, Zoti i tregon begatitë e Tij ku thotë (Po si është e mundur të mos e besoni ringjalljen kur):

أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهَادًا ﴿٦﴾

“A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme (për jetë)” (En-Nebeë: 6)

- Po si është e mundur të mos e besoni ringjalljen kur ju i keni parë faktet absolute të Plotfuqisë së Allahut, se si Zoti e ka bërë tokën të nënshtuar dhe në shërbim të krijesave.

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur Zoti e ka bërë tokën për njeriun si djepi për foshnjën.

Djepi i foshnjës përgatitet ashtu që fëmija të shtrihet në të për të pushuar dhe për të fjetur. Ne tokën e bëmë të përshtatshme për të jetuar.

Pastaj Zoti Famëlartë vazhdon dhe thotë: (Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen kur):

وَالْجِبَالِ أَوْتَادًا ﴿٧﴾

“Ndërsa kodrat shtylla?” (En-Nebeë: 7)

- Si ka mundësi të mohoni ringjalljen kur kodrat i ka ngulitur thellë dhe i ka bërë sikurse shtylla të tokës.

Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen kur kodrat i ka ngulitur thellë që të forcohet dhe të mos lëvizë toka.

Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen kur kodrat i ka ngulitur thellë që të qëndron e qetë dhe të mos bie mbi njerëzit.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë: (Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur):

وَخَلَقْنَاكُمْ أَزْوَاجًا ﴿٨﴾

“Dhe Ne u krijuam juve në çifte.” (En-Nebeë: 8)

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur në këtë botë Zoti ka bërë që të jeni dy gjini: mashkull dhe femër.

Zoti e ka bërë çiftëzimin që të realizohet shtimi i llojit njeri.

Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen kur ne ju krijuam çifte. Njëpërmjet çiftëzimit të njeriut realizohet bashkëpunimi gjinor njerëzor.

Vëllezër të nderuar!

Pastaj Zoti i madhërishëm vazhdon e thotë:

وَجَعَلْنَا نَوْمَكُمْ سُبَاتًا ﴿٩﴾

“Dhe gjumin tuaj ua bëmë për pushim.” (En-Nebeë: 9)

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur gjumin e ka parapa që të pushon trupi juaj, dhe për t’u shkëputur nga puna e lodhshme e ditës.

- Me gjumë rifreskohet energjia fizike, dhe pastaj aktivizohet mendja dhe trupi.

Pastaj Zoti i madhërishëm vazhdon e thotë: (Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen kur:

وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا ﴿١٠﴾

“Dhe natën ua bëmë mbulesë (si rrobat)”. (En-Nebeë: 10)

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur natën e ka bërë të errët, të qetë, për të pushuar në të, sikurse një rrobë e cila mbulon gjësendet dhe trupat.

E kemi bërë sikurse një rrobë që e mbulon trupin për ta mbrojtur njeriun nga i nxehti dhe nga i ftohti, dhe i mbulon organet intime, e ashtu edhe nata i bëhet mbulesë për atë i cili dëshiron që t’i plotësojë nevojat dhe interesat të cilat i ka realizuar gjatë ditës.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen:

وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا ﴿١١﴾

“Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim.” (En-Nebeë: 11)

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur kohën e ditës e ka bërë të ndritshme ashtu që njeriu të ketë mundësi që të realizon të mirat materiale për të jetuar, që të realizon përfitimin e jetës.

Kohën e ditës e ka bërë të ndritshme, ashtu që njeriu të ketë mundësi për të bërë tregti.

Kohën e ditës e ka bërë të ndritshme, ashtu që njeriu të ketë mundësi për të zhvilluar bujqësinë.

Kohën e ditës e ka bërë të ndritshme, ashtu që njeriu të ketë mundësi për t’u marrë me industrinë.

Kohën e ka bërë me aktivitete shkencore, e kështu me radhë.

Vëllezër të nderuar!

Vazhdon Zoti e i tregon begatitë e Tij ku thotë: Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen kur:

وَبَنَيْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا ﴿١٢﴾

“Dhe Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të fortë.” (En-Nebeë: 12)

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur mbi ju ka ndërtuar shtatë qiej të fortë, të konstruktuar dhe të harmonizuar mirë, të përsosur, të stolisur me yje të cilët qarkullojnë nëpër orbita dhe rrugë qiellore.

Zoti i Madhërishëm thotë: Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen:

وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا ﴿١٣﴾

“Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron.” (En-Nebeë: 13)

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur Diellin e ka bërë kandil ndriçues për tokën.

Diellin e kemi bërë dritë të shpërndarë në gjithë tokën dhe prej tij e zbret nxehtësinë, pastaj atë dritë dhe nxehtësi e shfrytëzojnë të gjitha gjallesat.

Përfundim

Po a nuk po ju mjafton si argument për ringjalljen kur:

وَأَنْزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرَاتِ مَاءً ثَجَّاجًا ﴿١٤﴾

لِّنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا ﴿١٥﴾

وَجَنَّاتٍ أَلْفَافًا ﴿١٦﴾

“Dhe prej reve të shtrydhura kemi lëshuar shi të madh.

Që me të të rrisim drithëra e bimë.

Edhe kopshte të dendura palë mbi palë”. (En-Nebeë: 14-16)

- Po si është e mundur të mohoni ringjalljen kur nga retë e dendura, të mbushura me ujë, e të errësuar nga të cilat lëshohet uji, dhe ende pa rënë shi prej tyre shiu zbret për shkak të kondensimit, tubimit, e që më pastaj nga rënia e atij shiu (uji) rezultojnë të mira të shumta:

- Të mira për njerëzit dhe
- Të mira për kafshët.
- Sa i përket të mirave për njerëzit janë: drithërat, gruri, elbi, misri, orizi, e kështu me radhë.
- Sa i përket të mirave për kafshët janë: llojet e barishtet me të cilat ushqehen kafshët.
- Po ashtu edhe bahçe, ara e plantacione me lloje të pemëve të ndryshme me degë të cilat ndërlihen në mes vete,
- me fryte të llojllojshme,
- me shije të llojllojshme,
- me aroma të ndryshme, edhe pse të gjitha këto kultivohen në të njëjtën hapësirë, ndërsa ujiten po me të njëjtin ujë, prapë se prapë dallohen në shije dhe aromë, siç figuron në ajet tjetër:

وَفِي الْأَرْضِ قِطْعٌ مُتَجَاوِرَاتٌ وَجَنَّاتٌ مِّنْ أَعْنَابٍ وَزَرْعٌ وَنَخِيلٌ صِنَوَانٌ وَغَيْرُ صِنَوَانٍ يُسْقَىٰ بِمَاءٍ وَاحِدٍ وَنُفِضَ لِّبَعْضِهَا عَلَىٰ بَعْضٍ فِي الْأُكُلِ ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿٤﴾

“E në tokë, copa sipërfaqesh, te ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të llojllojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njërën prej tjetrës. Të gjitha këto dëshmojnë si argumente për njerëzit e mençur.” (Err-Rrad: 4)

Suretu Nebeë tregon se si në ditën e gjykimit njerëzit do të ndahen në dy grupe:

- Grupi i besimtarëve të afërt me Allahun, të cilët shpërblehen prej Allahut, shpërblehen me Bujarinë e Tij dhe Zoti është i kënaqur me ta.
- Grupi e pabesimtarëve mohues, të cilët janë larg mëshirës së Allahut, të cilët mbeten të ndëshkuar me dënime të llojllojshme.

Grupi i besimtarëve është grup në rrugën e drejtë dhe të udhëzimit, dhe me përfundim më të mirë dhe më të suksesshëm.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin pjesës së parë të sures Nebeë.

SURETU NEBEË (2)

Suretu Nebeë: 17-30

إِنَّ يَوْمَ الْفُصْلِ كَانَ مِيقَاتًا ﴿١٧﴾ يَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ فَتَأْتُونَ أَفْوَاجًا ﴿١٨﴾ وَفُتِحَتِ السَّمَاءُ
فَكَانَتْ أَبْوَابًا ﴿١٩﴾ وَسُيِّرَتِ الْجِبَالُ فَكَانَتْ سَرَابًا ﴿٢٠﴾ إِنَّ جَهَنَّمَ كَانَتْ مِرْصَادًا ﴿٢١﴾
لِّلطَّاغِينَ مَابَا ﴿٢٢﴾ لَا يُبْنِينَ فِيهَا أَحْقَابًا ﴿٢٣﴾ لَا يَذُوقُونَ فِيهَا بَرْدًا وَلَا شَرَابًا ﴿٢٤﴾ إِلَّا حَمِيمًا
وَعَسَاقًا ﴿٢٥﴾ جَزَاءً وَفَاقًا ﴿٢٦﴾ إِنَّهُمْ كَانُوا لَا يَرْجُونَ حِسَابًا ﴿٢٧﴾ وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كِذَابًا ﴿٢٨﴾
وَكُلَّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ كِتَابًا ﴿٢٩﴾ فَذُوقُوا فَلَنْ نَزِيدَكُمْ إِلَّا عَذَابًا ﴿٣٠﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِّيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Nebeë e ka specifikën e vet, të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Nebeë që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Suret mekase dallohen me atë se përbëhen prej ajeteve të shkurta.

Suret mekase dallohen me atë se përshkruajnë ringjalljen dhe kataklizmën.

Sureja Nebeë e përshkruan kataklizmën, e përshkruan kijametin.

Vëllezër të nderuar!

Pjesa e dytë e suretu Nebeë flet për ditën e ndarjes së njerëzëve ku Zoti Madhërishëm thotë:

إِنَّ يَوْمَ الْفُصْلِ كَانَ مِيقَاتًا ﴿١٧﴾

“S’ka dyshim se dita e gjykimit është caktuar.” (En-Nebeë: 17)

Kjo do të thotë se:

- Dita e gjykimit është ditë e vështirë.
- Dita e gjykimit është ditë e rëndë.
- Dita e gjykimit është ditë e tmerrshme.
- Dita e gjykimit është ditë përfundimtare.

Cilësi e ditës së gjykimit është se kjo ditë është ditë e ndarjes. Pra, Dita e gjykimit quhet edhe: Dita e ndarjes!

Koha e ditës së gjykimit është e determinuar në momentin të cilin e di vetëm Allahu dhe askush tjetër.

Dita e gjykimit as nuk përshpejtohet dhe as nuk vonohet.

Parashtrohet pyetja:

Pse quhet dita e gjykimit ditë e ndarjes?

Përgjigjja:

- Dita e gjykimit quhet dita e ndarjes nga shkaku se Allahu i ndanë besimtarët nga pabesimtarët.

- Dita e gjykimit quhet ditë e ndarjes nga shkaku se Allahu e ndanë të vërtetën nga e pavërteta.

- Dita e gjykimit është dita e ndarjes, ku njerëzit ndahen nga një vend përkohësisht në një vend të caktuar, prej të parëve e deri te të fundit për t’u gjykuar në një vend tjetër të botës tjetër të përgjithmonshme.

Dita e gjykimit është dita kur Zoti i ndanë njerëzit për t’i shpaguat.

Besimtarë të nderuar!

Cilat janë shenjat e ditës së gjykimit?

Këtë e sqaron Zoti i madhërishëm ku thotë:

يَوْمَ يُنْفَخُ فِي الصُّورِ فَتَأْتُونَ أَفْوَاجًا ﴿١٨﴾

وَفُتِحَتِ السَّمَاءُ فَكَانَتْ أَبْوَابًا ﴿١٩﴾

وُسِيرَتِ الْجِبَالُ فَكَانَتْ سَرَابًا ﴿٢٠﴾

“Është dita që i fryhet surit, e ju vini grupe-grupe.

Dhe qielli hapet e bëhet dyer-dyer.

Dhe kodrat shkulen dhe bëhen pluhur (si valë rrezesh).” (En-Nebeë:18-20)

Shenjat e ditës së gjykimit janë të shumta. Në këtë rast përmenden tri prej tyre, e ato janë:

- E para:

Është dita kur Israfili do t'i fryjë borisë apo bririt. Fryrja e “Surit” e cila është briri të cilit i bie Israfili për t'u ringjallë njerëzit.

Është dita kur të gjithë njerëzit do të ngriten nga varret dhe do të paraqiten grupe-grupe, dhe shoqëri-shoqëri me shenja dalluese.

Është dita kur secili umet do të paraqitet me pejgamberin e vet.

- E dyta:

Në atë ditë, ndeshen qiejt dhe qahen, dhe bëhen dyer të shumta, bëhen rrugë dhe drejtime për të zbritur njerëzit. Ndeshen dhe përplasen qiejt në mes vete.

“Bëhet me dyer” ka kuptimin e çarjes dhe çeljes ashtu që të ketë korridore sikurse dyert në mur.

- E treta:

Në atë moment kodrat zbresin nga vendet e tyre, dhe zhduken në qiell bëhen hi e pluhur sa që njeriu e sheh dhe i duket si ujë (sikurse avull, ose sikurse rreze drite). Lëvizin kodrat nga vendet e tyre dhe bëhen hi e pluhur, thuaja se bëhen sikurse qielli (ajri).

Pra, në rend të parë kodrat shkulen.

Pastaj kodrat bëhen sikur lëmsh leshi.

Pastaj zbehet dhe bëhet sikurse pluhur.

Pastaj me erë zhduket në qiell, pasi ngrihen nga toka.

Çka ndodhë pas ditës së gjykimit?

Pas vdekjes dhe ditës së gjykimit nuk ka gjë tjetër pos dy çështjeve:

- Ose në xhenet - i paraparë për të devotshmit.

- Ose në xhehenem - i paraparë për mizorët.

Vëllezër të nderuar!

Tani shpjegojmë për Xhehenemin, ku Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ جَهَنَّمَ كَانَتْ مِرْصَادًا ﴿٢١﴾

لِّلطَّاغِيْنَ مَأْبًا ﴿٢٢﴾

“E Xhehennemi është në pritë (në pusi).

Është vendstrehim i arrogantëve.” (En-Nebeë: 22)

“Mirasadë” është vend i përgatitur. Kjo nënkupton se është krijuar dhe ekziston edhe sot. Allahu i Madhërishëm thotë:

“Pa dyshim se vendi i destinacionit të kthimit është te Zoti yt”. (El-Kamer)

Atë që pabesimtarët e devijuar do ta shohin atë ditë është zjarri.

Allahu e ka përcaktuar që vendi për kriminelët të jetë xhehenemi.

Allahu e ka parapa që vendkthimi për kriminelët të jetë xhehenemi.

Allahu e ka parapa dhe e ka përcaktuar që vendqëndrimi për kriminelët të jetë xhehenemi.

Për banorët e xhehenemit Zoti i madhërishëm thotë:

لَّا يَثْنِيَنَّ فِيهَا أَهْقَابًا ﴿٢٣﴾

“Aty do të mbesin për tërë kohën (pa mbarim).” (En-Nebeë: 23)

Aty do të qëndrojnë në një kohëzgjatje të përgjithmonshme. Periodat kohore vazhdojnë njëra pas tjetrës pafundësisht.

Në xhehenem do të qëndrojnë pa limit, do të qëndrojnë në kohë të pakufishme.

Pastaj Zoti i madhërishëm tregon për banorët e xhehenemit se:

لَّا يَذُوقُونَ فِيهَا بَرْدًا وَلَا شَرَابًا ﴿٢٤﴾

“Aty nuk do të shijojnë as freskim, as ndonjë pije.” (En-Nebeë: 24)

Si do të jetë dënimi në xhehenem?

- Të dënuarit në xhehenem nuk do të freskohen me diçka e cila do t'i mbronte nga zjarri. Pra nuk i prek diçka e cila do t'i çlironte nga dënimi i nxehtësisë së madhe.

Fjala “Dhukë” është metaforë “e shijimit” (shijes). Nuk shijojnë freski.

Ata, banorët e xhehenemit nuk kanë pije e cila do ta shuante etjen nga nxehtësia e madhe, përpos ujit valë i cili përvëlon.

Nuk kanë pije e cila do ta shuante etjen nga nxehtësia e madhe përpos djersës së nxehtë e cila rrjedhë nga trupat e banorëve të xhehenemit.

Pastaj Zoti i madhërishëm tregon për banorët e xhehenemit se:

إِلَّا حَمِيمًا وَغَسَّاقًا ﴿٢٥﴾

“Përveç ujë të valë e kalbësirë.” (*En-Nebeë: 25*)

Djersa është e përzier me qelbin e trupave të banorëve të xhehenemit dhe është i fëlliqur.

Besimtarë të nderuar!

Cili është dënimi i banorëve të xhehenemit?

Zoti i Madhërishëm jep përgjigjen ku thotë:

﴿٢٦﴾ جَزَاءٌ وَفَاقًا

﴿٢٧﴾ إِنَّهُمْ كَانُوا لَا يَرْجُونَ حِسَابًا

“Si ndëshkim i merituar.”

Ata ishin që nuk pritnin se do të jepnin llogari.” (En-Nebeë: 26, 27)

Ky është dënim meritore, në bazë të meritës së mëkatit të madh të cilën e kanë bërë, edhe sipas llojit të mëkatit edhe sipas masës së mëkatit.

Nuk ka mëkat më të madh se mëkati i idhujtarisë, ashtu sikurse nuk ka dënim më të madh se dënimi me zjarr.

Veprat e tyre kanë qenë të këqija, andaj janë shpague në bazë të veprave siç thotë Allahu i Madhërishëm:

﴿٤٠﴾ وَجَزَاءُ سَيِّئَةٍ سَيِّئَةً مِّثْلُهَا ۖ فَمَنْ عَفَا وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ عَلَى اللَّهِ ۗ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ

“Ndëshkimi i të keqes, bëhet në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është te All-llahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët”. (Shura: 40)

“Dënim meritore” e ka kuptimin: Për shkak të veprave të tyre dhe të pabesimit të tyre. Pra, ai dënim është meritore për ta. Është në harmoni me paralajmërimin për ato vepra, e ajo vepër është pabesimi, e dënim i pabesimit është zjarri.

- Ata kanë kryer krime të rënda, kanë bërë vepra të këqija, të shëmtuara dhe të papranueshme.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٢٨﴾ وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كِذَابًا

“Dhe argumentet Tona i përgënjeshtroan më këmbëngulje.” (En-Nebeë: 28)

Ata nuk i janë frikësuar llogaridhënies. Ata nuk kanë besuar në ringjallje.

Kjo është ajo se ata nuk kanë shpresuar dhe nuk i janë frikësuar ditës së llogaridhënies.

Kjo është arsye e dënimit të përgjithmonshëm. Allahu i Madhërishëm di për të gjitha veprat e robërve të Tij. Kështu që i ka të shkruara, apo të regjistruara

që më herët dhe janë arkivuar nga melaqet e regjistrimit, të cilat kanë shkruar çdo imtësi me saktësi. Janë llogaritur me precizitet dhe saktësisht.

Allahu i Madhërishëm do t'i gjykon me drejtësi dhe do të merr vendim meritorë për keq, keq, për mirë, mirë.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَكُلُّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ كِتَابًا ﴿٢٩﴾

“Ndërsa Ne çdo send e kemi përlllogaritur dhe ruajtur me shkrim të saktë.” (En-Nebeë: 29)

Thënia e Allahut **“Çdo gjë e kemi përlllogaritur”** ka për qëllim: Çdo çështje duhet që të përlllogaritet. Nga ky informacion është bërë ndërlidhja e pjesëve të tregimit nga fillimi i saj.

Sa i përket ajetit: **“Ndërsa Ne çdo send e kemi përlllogaritur dhe ruajtur me shkrim të saktë.”** (En-Nebeë: 29) ka të bëjë me të gjitha çështjet që ndërlidhen me shpërblimin dhe me dënimin.

Ajeti në fjalë është fjali e cila tregon një ngjarje.

Përfundim

Zoti i madhërishëm do të ju thotë banorëve të xhehenemit:

فَذُوقُوا فَلَنْ نَّزِيدَكُمْ إِلَّا عَذَابًا ﴿٣٠﴾

“E ju pra, vuani, se Ne nuk do t’u shtojmë tjetër vetëm se vuajtje”. (Nebeë: 30)

Gjatë dënimit, në mënyrë qortuese dhe poshtëruese u thuhet:

“E ju pra, vuani, se Ne nuk do t’u shtojmë tjetër vetëm se vuajtje”. (Nebeë: 30)

Banorëve të xhehenemit, për shkak të pabesimit dhe të përgënjeshtërimit të ajeteve dhe veprimeve të këqija, do të ju thuhet: “Shijojeni” këtë dënim të dhembshëm, nuk do të ju shtojmë dënim, përpos dënimit të llojit të dënimit.

Për banorët e xhehenemit nuk ka ajet më të rëndë se ky ajet:

“E ju pra, vuani, se Ne nuk do t’u shtojmë tjetër vetëm se vuajtje”. (Nebeë: 30)

Ata, banorët e xhehenemit janë në dënimin e përgjithmonshëm dhe nuk ka çka të shtohet më shumë.

Përshtkrimi i ditës së gjykimit është trishtues, ku do të ndahen njerëzit në mes vete dhe çështja e llogaridhënies, e shpagimit.

Të gjitha këto informata krijojnë bindje të sigurt se çka do të ndodhë në të ardhmen, në botën tjetër, sa që edhe zemrat sa nuk lëvizin nga vendi nga ngjarjet trishtuese të atij momenti.

Të gjitha këto informata krijojnë bindje të sigurt për llojet e dënimit në zjarr të xhehenemit.

Kjo duke pasur parasysh se e vërteta dhe drejtësia harmonizohen me fjalët dhe me veprat të cilat burojnë nga pabesimtarët dhe i qojnë ato në xhehenem.

Suretu Nebeë tregon se në ditën e gjykimit njerëzit do të ndahen në dy grupe:

- Grupi i besimtarëve të afërt me Allahun, të cilët shpërblehen prej Allahut, shpërblehen me Bujarinë e Tij dhe Zoti është i kënaqur me ta.

- Grupi i pabesimtarëve mohues, të cilët janë larg mëshirës së Allahut, të cilët mbeten të ndëshkuar me dënime të llojllojshme.

Grupi e besimtarëve është grup që është në rrugën e drejtë dhe të udhëzimit dhe me përfundim më të mirë dhe më të suksesshëm.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin pjesës së dytë të sures Nebeë.

SURETU NEBEË (3)

Suretu Nebeë: 31-40

إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ مَفَازًا ﴿٣١﴾ حَدَائِقَ وَأَعْنَابًا ﴿٣٢﴾ وَكَوَاعِبَ أَتْرَابًا ﴿٣٣﴾ وَكَأْسًا دِهَاقًا ﴿٣٤﴾ لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا وَلَا كِدَابًا ﴿٣٥﴾ جَزَاءً مِّن رَّبِّكَ عَطَاءً حِسَابًا ﴿٣٦﴾ رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الرَّحْمَنُ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا ﴿٣٧﴾ يَوْمَ يَقُومُ الرُّوحُ وَالْمَلَائِكَةُ صَفًّا لَا يَتَكَلَّمُونَ إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ وَقَالَ صَوَابًا ﴿٣٨﴾ ذَلِكَ الْيَوْمَ الْحَقُّ فَمَن شَاءَ اتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِ مَآبًا ﴿٣٩﴾ إِنَّا أَنذَرْنَاكُمْ عَذَابًا قَرِيبًا يَوْمَ يَنْظُرُ الْمَرْءُ مَا قَدَّمَتْ يَدَاهُ وَيَقُولُ الْكَافِرُ يَا لَيْتَنِي كُنْتُ تُرَابًا ﴿٤٠﴾

Vëllezër të nderuar!

Më herët kemi shpjeguar për pjesën e parë dhe pjesën e dytë të suretu Nebeë.

Tani do të shpjegojmë për pjesën e tretë të suretu Nebeë, e cila është pjesa e fundit e kësaj sureje.

Në pjesën e fundit të suretu Nebeë Zoti tregon për gjendjen e të mirëve në ditën e gjykimit?

Pasi ka treguar për ditën e gjykimit.

Pasi ka treguar për ditën e ndarjes.

Pasi ka treguar për banorët e xhehenemit, në pjesën e fundit të sures Nebeë Zoti i Madhërisëm përshkruan gjendjen e banorëve të xhenetit ku thotë:

إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ مَفَازًا ﴿٣١﴾

“S’ka dyshim se të devotshmit kanë fitime të mëdha.” (En-Nebeë: 31)

Banorët e xhenetit janë të suksesshëm.

Banorët e xhenetit janë fitimtarë.

Janë të suksesshëm nga shkakun se i shpëtojnë xhehenemit dhe hyjnë në xhenet.

Janë fitimtarë nga shkakun se i shpëtojnë xhehenemit dhe hyjnë në xhenet.

E gjithë kjo me mëshirën dhe me mirësinë e Allahut:

Xheneti është përfundimi i besimtarëve të devotshëm, e ajo është se, ata të cilët i frikësohen Zotit të tyre duke i vepruar urdhëresat, dhe duke u larguar nga ndalesat, do të jenë të shpëtuar.

Të devotshmit janë në vendin e shpëtimit, nga shkaku se janë larguar nga pika kritike e zjarrit, dhe kanë hyrë në xhenet.

Fitimet e banorëve të xhenetit janë të shumta, e prej tyre Zoti ka përgatitë:

﴿٣٢﴾ حَدَائِقَ وَأَعْنَابًا

“Kopshte e vreshta rrushi.” (*En-Nebeë: 32*)

Në xhenet kënaqen në plantacionet me plotë e përplot pemë e fryte.

Në xhenet kënaqen me plantacione e vreshta rrushi me shije të mirë.

Për banorët e xhenetit Zoti ka përgatitë:

﴿٣٣﴾ وَكَوَاعِبَ أَتْرَابًا

“Edhe vasha të një moshe.” (*En-Nebeë: 33*)

Në xhenet kënaqen me hyri të xhenetit.

Në xhenet kënaqen me hyri me mosha të njëjta.

Në xhenet kënaqen me hyri të reja.

Në xhenet kënaqen me hyri të dashura të cilat kanë vija perfekte të trupit,

Në xhenet kënaqen me hyri me gjoksin e bukur.

Banorët e xhenetit do të kenë:

﴿٣٤﴾ وَكَأْسًا دِهَاقًا

“Edhe gota të mbushura plot verë.” (*En-Nebeë: 34*)

- Konsumojnë pije të shijshme me gota komode, të cilat gota mbushen edhe me alkool të xhenetit, i cili nuk dehtë.

Besimtarë të nderuar!

Për banorët e xhenetit Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٣٥﴾ لَا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا وَلَا كِذَابًا

﴿٣٦﴾ جَزَاءً مِّن رَّبِّكَ عَطَاءٌ حِسَابًا

“Aty nuk dëgjojnë fjalë të kota, as gënjeshtër.”

Shpërblime e dhurata të shumta dhënë nga Zoti yt.” (*En-Nebeë: 35, 36*)

Në xhenet nuk dëgjojnë fjalët e padrejta.

Në xhenet nuk dëgjoen fjalë ofenduese, nënçmuese, sharje, e kështu me radhë.

Banorët e xhenetit nuk e gënjejnë njëri-tjetrin, gjë që tregon për ambient dhe atmosferë të mirë dhe të etikës së lartë, ku qetësohen shpirtat.

Në xhenet nuk befasohen me ndonjë fjalë të pazakontë.

Allahu i shpërblen për besimin e tyre dhe për veprat e mira të tyre.

Allahu ua ka mundësuar banorëve të xhenetit ato mirësi, për t'i nderuar dhe për t'i respektuar.

Kjo është solide dhe e mjaftueshme duke u bazuar në veprat e tyre.

Allahu e ka realizuar premtimin e Tij ndaj tyre.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا الرَّحْمَنُ ۚ لَا يَمْلِكُونَ مِنْهُ خِطَابًا ﴿٣٧﴾

“Zoti i qiejve e i tokës, dhe çka ka ndërmjet tyre, që është mëshirues, të cilit nuk kanë të drejtë t'i bëjnë vërejtje.” (En-Nebeë: 37)

Zoti i Madh, i Cili shpërblen me të mira, cilësohet me Madhështinë e Tij.

Zoti i Madh, i Cili shpërblen me të mira, ngase Ai është Zot i qiejve dhe tokës, çka ka në to dhe çka ka në mes tyre.

Ai është Mëshirëploti, i Cili me mëshirën e Tij përfshinë çdo gjë.

Askush nuk ka mundësi të flet para Tij pa lejen e Tij. Kjo për shkak të Madhështisë së Tij Famëlartë.

Besimtarë të nderuar!

Për ditën e gjykimit Zoti i Madhërishëm thotë:

يَوْمَ يَقُومُ الرُّوحُ وَالْمَلَائِكَةُ صَفًّا ۚ لَا يَتَكَلَّمُونَ إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ الرَّحْمَنُ وَقَالَ صَوَابًا ﴿٣٨﴾

“Atë ditë Xhibrili dhe engjëjt qëndrojnë të rreshtuar, askush nuk flet pos atij që e lejon Mëshiruesi, dhe i cili e thotë të vërtetën.” (En-Nebeë: 38)

Nuk mund të flasin para Allahut, në ditën kur do të ngrihet Xhibrili a.s. dhe të gjitha melaqet e përzgjedhura të cilat do të qëndrojnë të rreshtuara dhe të organizuara, edhe pse ata kanë grada të larta dhe janë në nivele të larta.

Në ditën e gjykimit, nuk mund të flet askush nëse nuk plotësohen dy kushte:

- Kushti i parë: Nëse Allahu i jep leje ndokujt që të ndërmjetëson, siç figuron në ajetin tjetër:

مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ

“Kush mund të ndërmjetësojë te Ai, pos me lejen e Tij?” (El-Bekare: 255)

- Kushti i dytë: Që folësi të flet fjalë të drejtë, pra që të jetë në harmoni me të vërtetën dhe me të drejtën, nëse ndërmjetësuesit i është dhënë leja, dhe ai për të cilin ndërmjetësohet në dunja e ka thënë fjalën e vërtetë. Pra e ka dëshmuar Njëshmërinë e Allahut ashtu që ka thënë: “La ilahe il-llell-Llah”.

Pasi i është dhënë leja ndërmjetësuesit.

Fjala “ruhë” është për Xhibrilin, duke u bazuar në thënien e Allahut të Madhërishëm:

نَزَلَ بِهِ الرُّوحُ الْأَمِينُ ﴿١٩٣﴾

عَلَى قَلْبِكَ لِتَكُونَ مِنَ الْمُنذِرِينَ ﴿١٩٤﴾

“Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). (E solli) në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen” (Shuaraë: 193-194)

Ajeti dëshmon se melaqet dhe Xhibrili a.s. janë prej krijesave më të çmuara dhe me pozitë më të larta.

Ajeti dëshmon se dita e gjykimit është një ditë e madhe dhe e rëndë.

ذَٰلِكَ الْيَوْمُ الْحَقُّ ۖ فَمَنْ شَاءَ اتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِ مَآبًا ﴿٣٩﴾

“Ajo është dita e vërtetë, e kush dëshiron le të kthehet rrugës te Zoti i vet.” (En-Nebeë: 39)

Kjo ditë, dita e gjykimit është ditë e vërtetë, pra domosdoshmërisht do të ndodhë. Në ndodhjen e saj nuk ka dyshim.

Kush dëshiron shpëtim, e trason rrugën e Zotit të Tij.

Kush dëshiron shpëtim, udhëzohet në rrugën e Tij për të fituar shpërblimin.

Kush dëshiron shpëtim afrohet te Zoti i tij, i afrohet fisnikërisë së Tij, dhe i largohet dënimit të Tij, dhe atë me besimin e drejtë dhe me vepra të mira.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّا أَنْذَرْنَاكُمْ عَذَابًا قَرِيبًا يَوْمَ يَنْظُرُ الْمَرْءُ مَا قَدَّمَتْ يَدَاهُ وَيَقُولُ الْكَافِرُ يَا لَيْتَنِي كُنْتُ تُرَابًا ﴿٤٠﴾

“Ne ua tërhoqëm juve (idhujtarëve) vërejtjen për një dënim të afërt, në ditën kur njeriu (besimtar) shikon se çka i kanë sjellë duart e veta, e jobesimtari thotë: “Ah, sa mirë do të ishte për mua sikur të isha dhe!” (En-Nebeë: 40)

Zoti tërheqë vërejtjen dhe i frikëson për atë ditë të gjykimit edhe një herë. “O ju pabesimtarë, Ne ua tërheqim vërejtjen dhe ju frikësojmë me dënimin i cili shumë shpejtë do të ndodhë, e ajo ditë është dita e gjykimit.”

Kjo është rikonfirmim i ndodhisë, e cila ndodhë për së afërmi.

Çdo e ardhme është e afërt, kështu që ajo ditë do të ndodhë shumë afër, ashtu që çdo njeri e sheh se çka ka vepruar, keq apo mirë, gjatë jetës së tij në dunja.

Çka do të thotë pabesimtari, ateisti, idhujtari?

Përgjigjja:

Në rend të parë pabesimtari do të dëshiron që të mos ishte njeri.

Në rend të parë ateisti do të dëshiron që të mos ishte krijuar.

Në rend të dytë do të dëshiron që të mos ishte ringjallë.

Kafshët pasi të hakmerren në mes vete do të bëhen dhe (baltë).

Zoti i Madhërishëm thotë:

“Ne ua tërhoqëm juve (idhujtarëve) vërejtjen për një dënim të afërt, në ditën kur njeriu (besimtar) shikon se çka i kanë sjellë duart e veta, e jobesimtari thotë: “Ah, sa mirë do të ishte për mua sikur të isha dhe!” (En-Nebeë: 40)

Për shkak të vuajtjeve dhe llojeve të ndryshme të dënimit, pabesimtarët si f.v.: Ubej bin Halefi; Ebu Xhehli, do të thonë: Mjerë për mua, po të isha dhe sikurse kafshët, dhe të mos isha krijuar.

Këto dy ajete të fundit dëshmojnë se në ditën e gjykimit njerëzit do të ndahen në dy grupe:

- Grupi i besimtarëve të afërt me Allahun, të cilët shpërblehen prej Allahut, shpërblehen me Bujarinë e Tij dhe Zoti është i kënaqur me ta.

- Grupi i pabesimtarëve mohues, të cilët janë larg mëshirës së Allahut, të cilët mbeten të ndëshkuar me dënime të llojllojshme.

Cili grup është në rrugën e drejtë dhe të udhëzimit, dhe me përfundim më të mirë dhe më të suksesshëm.

Po të pyetesh fëmija i logjikshëm para pubertetit do ta jepte përgjigjen, do t'i pasonte besimtarët me mundësinë e tij dhe do të shpëtonte.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e sures Nebeë.

SURETU NAZIATË (1)

Suretu Naziatë: 1-14

وَالنَّازِعَاتِ غَرْقًا ﴿١﴾ وَالنَّاشِطَاتِ نَشْطًا ﴿٢﴾ وَالسَّابِحَاتِ سَبْحًا ﴿٣﴾ فَالسَّابِقَاتِ سَبْقًا ﴿٤﴾
فَالْمُدَبِّرَاتِ أَمْرًا ﴿٥﴾ يَوْمَ تَرْجُفُ الرَّاجِفَةُ ﴿٦﴾ تَتَّبِعُهَا الرَّادِفَةُ ﴿٧﴾ قُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ وَاجِفَةٌ ﴿٨﴾
أَبْصَارُهَا خَاشِعَةٌ ﴿٩﴾ يَقُولُونَ إِنَّا لَمَرْدُودُونَ فِي الْحَافِرَةِ ﴿١٠﴾ أَإِذَا كُنَّا عِظَامًا نَخِرَةً ﴿١١﴾ قَالُوا
تِلْكَ إِذًا كَرَّةٌ خَاسِرَةٌ ﴿١٢﴾ فَإِنَّمَا هِيَ زَجْرَةٌ وَاحِدَةٌ ﴿١٣﴾ فَإِذَا هُمْ بِالسَّاهِرَةِ ﴿١٤﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Naziatë e ka specifikën e vet, të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Naziatë që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Suret Mekase dallohen me atë se përbëhen prej ajeteve të shkurta.

Suret Mekase dallohen me atë se përshkruajnë ringjalljen dhe kataklizmën.

Sure Nebeë përshkruan kataklizmën, përshkruan kijametin.

Suretu Naziat flet për vërtetimin e ditës së gjykimit ku thotë:

وَالنَّازِعَاتِ غَرْقًا ﴿١﴾

وَالنَّاشِطَاتِ نَشْطًا ﴿٢﴾

وَالسَّابِحَاتِ سَبْحًا ﴿٣﴾

فَالسَّابِقَاتِ سَبْقًا ﴿٤﴾

فَالْمُدَبِّرَاتِ أَمْرًا ﴿٥﴾

“Pasha ata (melekët) që marrin shpirtrat me rrëmbim (përmbytshëm)!

Dhe ata (melekët) që marrin shpirtra me lehtësim!

Dhe ata (melekët) që notojnë me shpejtësi!

Dhe nxitësit (melekët) të cilët me shpejtësi në vendin e vet i çojnë!

Dhe pasha ata (melekët) që çdo çështje rregullojnë!” (En-Naziatë: 1-5)

Allahu i Madhërishëm, për të vërtetuar ringjalljen, është betuar në disa dukuri natyrore si f.v.:

- Është betuar në melaqet të cilat i marrin shpirtrat.
- Është betuar në melaqet të cilat e lavdërojnë Allahun në qiell.
- Është betuar në melaqet të cilat zbresin nga qielli për t'i rregulluar disa çështje.

Çka përmban betimi?

Betimi përmban disa informata të ndodhive në ditën e gjykimit.

Betimi përmban kërcënimin e përgënjeshtresve se do të dënohen në këtë botë dhe në botën tjetër.

Kështu pra,

- Allahu i Madhërishëm është betuar në melaqe, të cilat me ashpërsi tepër të madhe i marrin shpirtrat e pabesimtarëve.

- Allahu i Madhërishëm është betuar në melaqe, të cilat shpirtrat e besimtarëve i marrin me shpejtësi dhe me butësi.

- Allahu i Madhërishëm është betuar në melaqet të cilat zbresin me shpejtësi nga qielli, dhe me shpejtësi shpirtrat e besimtarëve i dërgojnë në qiell.

- Allahu i Madhërishëm është betuar në melaqet të cilat zbresin me shpejtësi nga qielli, të cilat i programojnë çështjet, zbresin të programojnë dhe të sqarojnë të lejuarën dhe të ndaluarën.

Me këto pesë fjali qëllimi është për yjet dhe trupat qiellore në lëvizjet e tyre nëpër sisteme qiellore dhe qarkullimi nëpër orbitat e tyre të qeta.

Me këto pesë fjali qëllimi është se me shpejtësi me urdhrin e Allahut janë programuar të gjitha çështjet.

Sa i përket termit: “Emren”. Kjo ka të bëjë me çështjet të cilat i programon Allahu i Madhërishëm, por u është atribuuar melaqeve dhe se ata janë një shkak prej shkaqeve të atyre çështjeve.

Besimtarë të nderuar!

Gjithmonë pas betimit rezulton arsyeja e betimit, e arsyeja e betimit është se:

Melekët e vazhdojnë kryerjen e detyrave pas vdekjes së krijesave.

Melekët e vazhdojnë kryerjen e detyrave atëherë kur toka do të dridhet dhe kodrat do të ndeshen,

Melekët e vazhdojnë kryerjen e detyrave atëherë kur toka palohet me qiellin dhe çdo gjë që është në qiell, të gjitha trupat qiellorë shpërndahen.

Kështu që, në pjesën e dytë të ajeteve Zoti famëlartë flet për agonitë e ditës së kijametit dhe i kërcënon ata të cilët nuk e besojnë atë ditë ku thotë:

يَوْمَ تَرْجُفُ الرَّاجِفَةُ ﴿٦﴾

تَتَّبِعُهَا الرَّادَّةُ ﴿٧﴾

“Ditën që vrullshëm bëhet dridhja.

Që pas saj pason tjetra.” (En-Naziatë: 6, 7)

Pastaj Zoti i madhërishëm thotë:

قُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ وَاجِفَةٌ ﴿٨﴾

أَبْصَارُهَا خَاشِعَةٌ ﴿٩﴾

“Atë ditë zemrat janë të tronditura.

Shikimet e tyre janë të poshtëruara (frikësuara).” (En-Naziatë: 8, 9)

- Në ditën e gjykimit zemrat do të jenë të frikësuara, që nga momenti kur do ta kuptojnë se ndodhen në ditën e gjykimit, e ato zemra janë zemrat e pabesimtarëve.

Kjo nga shkaku se identifikohet gjendja e tyre se kanë vdekur si pabesimtarë dhe se e kanë mohuar ringjalljen.

- Në ditën e gjykimit zemrat do të jenë të mërzitura, që nga momenti kur do ta kuptojnë se ndodhen në ditën e gjykimit, e ato zemra janë zemrat e pabesimtarëve.

Pabesimtarët dhe shikimet e tyre do të jenë të përlura, të ngrysurat dhe të poshtëruara.

Kjo nga shkakun se identifikohet gjendja e tyre se kanë vdekur pabesimtarë dhe si mohues të ringjalljes.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishtëm thotë:

يَقُولُونَ أَأَنَا لَمَرْدُودُونَ فِي الْحَافِرَةِ ﴿١٠﴾

أَإِذَا كُنَّا عِظَامًا نَّخِرَةً ﴿١١﴾

قَالُوا تِلْكَ إِذًا كَرَّةٌ خَاسِرَةٌ ﴿١٢﴾

“Ata (idhujtarët në dynja) thonë: “A thua do të bëhemi përsëri kështu si jemi?”

“A edhe pasi të jemi bërë eshtra të kalbur?”

Ata thanë: “Atëherë, ai kthim do të jetë dëshpërues për ne!” (En-Naziatë: 10, 12)

Idhujtarët dhe të ngjashmit me ta do të thonë: “A do të kthehemi edhe njëherë në botën e parë (të mëhershme), dhe të fillojmë me çështjen e para vdekjes, e të kthehemi në jetën e para vdekjes”.

Fjala “Hafiretun” është fjalë e cila përdoret për dy kuptime:

Fjala “Hafiretun” është fjalë e cila përdoret atëherë kur arrijnë në fund.

Fjala “Hafiretun” është fjalë e cila përdoret kur kthehen prej fillimit.

Banorët e xhehenemit do ta thonë këtë nga habia për shkak se e kanë përgënjeshtuar ditën e gjykimit.

Pabesimtarët do ta thonë këtë nga shkakun se e kanë përgënjeshtuar ditën e gjykimit.

Kuptimi: “A do të kthehemi në dunja, pasi jemi ndarë prej saj kur kemi vdekur!?”

Si është e mundur, ne nuk mund ta imagjinojmë që të kthehemi në jetë, pasi që të bëhemi eshtra të kalbura.

Si është e mundur, ne nuk mund ta imagjinojmë që të kthehemi në jetë, pasi pjesët e trupit të na shpërndahen në tërësi, atëherë i bie se jemi kthyer në jetë

pas vdekjes, por doli e vërteta se ne në ditën e gjykimit u ringjallëm që të dështojmë me dështimin e paraparë, ngase e kemi përgënjeshtruar Muhamedin.

Kjo thënie është sarkazëm e tyre, të cilën e kanë thënë në dunja.

Përfundim

Allahu është kundërpërgjigjur:

Këtë çështje mos e llogaritni si absurditet. Nga shkaku se kjo çështje është e thjeshtë.

Çështjen e ringjalljes mos e konsideroni se për Allahun është çështje e vështirë. Kjo, nga shkaku se nevojitet vetëm një zë.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

فَإِنَّمَا هِيَ زَجْرَةٌ وَاحِدَةٌ ﴿١٣﴾

فَإِذَا هُمْ بِالسَّاهِرَةِ ﴿١٤﴾

“Po ajo (ringjallja) nuk do të jetë tjetër pos një thirrje (një zë).

Dhe ja, ata mbi sipërfaqen e tokës.” (*En-Naziatë: 13, 14*)

Kjo është fryrja e dytë e surit, kur do të ringjallen njerëzit nga varret dhe menjëherë dalin të gjallë mbi tokë.

Fjala: “Sahiretun” është toka e botës tjetër. Ajo është toka e bardhë ku do të qëndrojnë.

Është cilësuar në këtë mënyrë, sepse atëherë nuk do të flenë, nuk bien në gjumë.

- Një pjesë e dijetarëve mendojnë se ajo tokë është kjo tokë, pra toka e kësaj bote.

- Një pjesë e dijetarëve mendojnë se ajo tokë janë kodrat e Shamit afër Mesxhidi Aksasë.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Naziatë.

SURETU NAZIATË (2)

Suretu Naziatë: 15-26

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ مُوسَى ﴿١٥﴾ إِذْ نَادَاهُ رَبُّهُ بِالْوَادِ الْمُقَدَّسِ طُوًى ﴿١٦﴾ أَذْهَبَ إِلَى فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَى ﴿١٧﴾ فَقُلْ هَلْ لَكَ إِلَى أَنْ تَزَكَّى ﴿١٨﴾ وَأَهْدِيكَ إِلَى رَبِّكَ فَتَخْشَى ﴿١٩﴾ فَأَرَاهُ الْآيَةَ الْكُبْرَى ﴿٢٠﴾ فَكَذَّبَ وَعَصَى ﴿٢١﴾ ثُمَّ أَذْبَرَ يَسْعَى ﴿٢٢﴾ فَحَشَرَ فَنَادَى ﴿٢٣﴾ فَقَالَ أَنَا رَبُّكُمُ الْأَعْلَى ﴿٢٤﴾ فَأَخَذَهُ اللَّهُ نَكَالَ الْآخِرَةِ وَالْأُولَى ﴿٢٥﴾ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِّمَنْ يَخْشَى ﴿٢٦﴾

Besimtarë të nderuar!

Në pjesën e tretë të kësaj sure flitet për historinë e Musait a.s. me Firaunit ku thotë:

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ مُوسَى ﴿١٥﴾

إِذْ نَادَاهُ رَبُّهُ بِالْوَادِ الْمُقَدَّسِ طُوًى ﴿١٦﴾

“A të ka ardhur ty rrëfimi i Musait?

Kur Zoti i tij e pat thirrur në luginën e bekuar Tuva (rrëzë kodrës Turi Sina).“ (En-Naziatë: 15, 16)

Me këto ajete, Allahu e inkurajon peygamberin e Tij nga përgënjeshttrimet e popullit të tij, duke sjellë historinë e Musait a.s. me firaunin mizor, ku thotë: **“A nuk të është sjellë historia e Musait a.s.?”**

Me këto ajete, Allahu e qetëson nga përgënjeshttrimet e popullit të tij, duke sjellë ngjarje historike, ku thotë: **“A nuk të është sjellë historia e Musait a.s. (me firaunin).”**

Me këto ajete i tregon se si kur e ka dërguar Allahu Musain a.s. te firauni, e ka mbështetur me mrekulli.

Kur Zoti i tij e ka thirr natën për të biseduar me të, dhe për ta ngarkuar me peygamberi dhe me mesazh në vendin e bekuar të pastër. Ajo kodrinë është kodrina Tuva: e cila gjendet në malin (kodrën) e Sinaut.

Pastaj Zoti i ka thënë Musait a.s:

اَذْهَبْ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ إِنَّهُ طَغَىٰ ﴿١٧﴾

فَقُلْ هَلْ لَّكَ إِلَىٰ أَنْ تَزَكَّىٰ ﴿١٨﴾

وَأَهْدِيكَ إِلَىٰ رَبِّكَ فَتَخْشَىٰ ﴿١٩﴾

“Shko te faraoni se vërtet ai e ka tepruar.

Dhe thuaj: “E ke ndërmend të pastrohesh?”

Unë të udhëzoi te Zoti yt e ti t’ia kesh frikën Atij!” (*En-Naziatë, 17-19*)

Allahu i Madhërishëm duke ia sqaruar detyrën i thotë: Shko te firauni i cili është një kriminel arrogant i Egjiptit.

Kjo nga shkaku se ai i ka tejkaluar kufijtë me arrogancë, me mëkate.

Firauni e ka mohuar Zotin, sa që pretendon se është zot, dhe në këtë mënyrë Firauni e ka robëruar popullin e tij.

Metodologjia e ftesës tënde është që t’i thuash:

“A ke dëshirë që të pastrohesh nga idhujtaria. Kështu që të udhëzoj që ta njohësh Zotin Një”.

“A ke dëshirë që të pastrohesh nga të metat. Kështu që të udhëzoj që ta njohësh Zotin Një, dhe ta adhurosh Atë”.

Allahu e ka urdhëruar që t’i fliste me fjalë të buta, ashtu që të ishte më i suksesshëm në thirrjen e tij.

Argument i kësaj është se qëllimi kryesor i dërgimit ka qenë: “Udhëzimi i njerëzve për ta njohur Allahun”.

Pastaj, Zoti i madhërishëm tregon se Musait a.s. Zoti i ka dhënë mrekulli natyrore ku thotë:

فَأَرَاهُ الْآيَةَ الْكُبْرَىٰ ﴿٢٠﴾

“Dhe ai ia tregoi mrekullinë e madhe.” (*En-Naziatë: 20*)

Argument i vërtetësisë para firaunit: Mrekullitë e Musait a.s.

Musau ka paraqitur shenja madhështore për të treguar vërtetësinë e pejgamberisë së tij, e ato ishin:

- Shndërrimi i shklopit në gjarpër, dhe
- Shndërrimi i dorës në dritë shkëlqyese.

Besimtarë të nderuar!

Zoti tregon se përkundër kësaj:

﴿٢١﴾ فَكَذَّبَ وَعَصَى

﴿٢٢﴾ ثُمَّ أَذْبَرَ يَسْعَى

﴿٢٣﴾ فَحَشَرَ فَنَادَى

﴿٢٤﴾ فَقَالَ أَنَا رَبُّكُمُ الْأَعْلَى

﴿٢٥﴾ فَأَخَذَهُ اللَّهُ نَكَالَ الْآخِرَةِ وَالْأُولَى

“Po ai e përgënjeshtroi dhe e kundërshtoi.

Pastaj u kthye prapa dhe iku me të shpejtë.

I tuboi (të gjithë të vetët) dhe u mbajti fjalim.

E u tha: “Unë jam zoti juaj më i lartë!”

“Atëherë tmerrshëm e dënoi atë, për këtë të fundit dhe për atë të parën.” (*En-Naziatë: 21- 25*)

Firauni e ka përgënjeshtruar Musaun, dhe të vërtetën e tij pejgamberike.

Firauni e ka kundërshtuar Allahun Famëlartë.

Firauni nuk e ka dëgjuar.

Firauni e ka kthyer shpinën dhe nuk ka besuar në Zot.

Përpos kësaj ai ka vazhduar të shkaktoj trazira në tokë për të zhvleftësuar ftesën e Musaut.

- Firauni ka përgënjeshtruar me zemër;

- E ka kundërshtuar me gjuhë (shprehimisht);

- E ka kundërshtuar me vepra duke u rebeluar.

Mbi të gjitha:

E ka tubuar ushtrinë dhe administratën shtetërore për konsultim.

Pastaj i ka tubuar magjistarët për ta kundërshtuar dhe për ta sfiduar.

Pastaj u ka thënë që të gjithëve: “Unë jam zoti më i madhi, dhe unë jam sundimtari absolut”.

Pastaj, Allahu e ka fundosur atë me gjithë ushtrinë.

Allahu e ka dënuar në mënyrë të rreptë, është hakmarrë me hakmarrje, që të mbetet shembull dhe mësim për arrogantët e ngjashëm të kësaj bote.

Allahu ka parapa dy lloje të dënimeve:

- Dënimin e kësaj bote dhe
- Dënimin e botës tjetër.

Në këtë botë me dënim të poshtërimit dhe të fundosjes në det.

Në botën tjetër me dënimin e djegies në xhehenem.

Përfundim

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَعِبْرَةً لِّمَن يَخْشَى ﴿٢٦﴾

“Në këtë ndëshkim ka përvojë mësimi për atë që frikësohet.” (*En-Naziatë: 26*)

Në historinë e firaunit është mësim i rëndësishëm për ata të cilët i frikësohen Allahut dhe dënimit të Tij.

Në historinë si është vepruar me firaunin është mësim i rëndësishëm për ata të cilët i frikësohen Allahut dhe dënimit të Tij.

Në historinë e firaunit dhe siç është vepruar me të është mësim edukimi, ashtu që krahasohen ngjarjet e kaluara për të marrë mësim për të tanishmen.

Në historinë e firaunit dhe siç është vepruar me të është mësim edukimi, ashtu që krahasohen ngjarjet e kaluara për të marrë mësim për të ardhmen.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e pjesës së dytë të sures Naziatë.

SURETU NAZIATË (3)

Suretu Naziatë: 27-46

أَنْتُمْ أَشَدُّ خَلْقًا أَمِ السَّمَاءُ بَنَاهَا ﴿٢٧﴾ رَفَعَ سَمَكَهَا فَسَوَّاهَا ﴿٢٨﴾ وَأَغْطَشَ لَيْلَهَا وَأَخْرَجَ
ضُحَاهَا ﴿٢٩﴾ وَالْأَرْضَ بَعْدَ ذَلِكَ دَحَاهَا ﴿٣٠﴾ أَخْرَجَ مِنْهَا مَاءَهَا وَمَرْعَاهَا ﴿٣١﴾ وَالْجِبَالَ
أَرْسَاهَا ﴿٣٢﴾ مَتَاعًا لَّكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ ﴿٣٣﴾ فَإِذَا جَاءَتِ الطَّامَةُ الْكُبْرَى ﴿٣٤﴾ يَوْمَ يَنْذَكُرُ
الْإِنْسَانُ مَا سَعَى ﴿٣٥﴾ وَبُرْزَتِ الْجَحِيمُ لِمَنْ يَرَى ﴿٣٦﴾ فَأَمَّا مَنْ طَغَى ﴿٣٧﴾ وَآثَرَ الْحَيَاةَ
الدُّنْيَا ﴿٣٨﴾ فَإِنَّ الْجَحِيمَ هِيَ الْمَأْوَى ﴿٣٩﴾ وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَنَهَى النَّفْسَ عَنِ الْهَوَىٰ
﴿٤٠﴾ فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَى ﴿٤١﴾ يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَاهَا ﴿٤٢﴾ فِيمَ أَنْتَ مِنْ
ذِكْرَاهَا ﴿٤٣﴾ إِلَىٰ رَبِّكَ مُنْتَهَاهَا ﴿٤٤﴾ إِنَّمَا أَنْتَ مُنذِرٌ مَّنْ يَخْشَاهَا ﴿٤٥﴾ كَانَهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَهَا
لَمْ يَلْبَثُوا إِلَّا عَشِيَّةً أَوْ ضُحَاهَا ﴿٤٦﴾

Sot do të vazhdojmë me hutben e tretë në komentimin e suretu Naziatë, ku Zoti kërcënon pabesimtarët të cilët nuk besojnë në ringjalljen ku thotë:

أَنْتُمْ أَشَدُّ خَلْقًا أَمِ السَّمَاءُ بَنَاهَا ﴿٢٧﴾

رَفَعَ سَمَكَهَا فَسَوَّاهَا ﴿٢٨﴾

وَأَغْطَشَ لَيْلَهَا وَأَخْرَجَ ضُحَاهَا ﴿٢٩﴾

“A është më i rëndë krijimi juaj apo ai i qiellit? E Ai e ngriti atë!

Ngriti kupolën e tij dhe e përsosi atë.

Natën ia errësoi e ditën ia ndriçoi.” (En-Naziatë: 27-29)

Allahu i Madhërishëm u është drejtuar mohuesve të ringjalljes, duke u argumentuar me zanafillën e krijimit në rikrijimin.

Ashtu siç ka krijuar qiejt, ashtu ka mundësi t'i rikrijon qiejt. Ashtu siç i ka krijuar krijesat ka mundësi t'i rikrijon krijesat. Ashtu siç ka krijuar tokën dhe kodrat, ashtu ka mundësi t'i rikrijon tokën dhe kodrat. Ashtu siç i ka krijuar krijesat, ka mundësi t'i rikrijon krijesat. Kështu do të ringjallë, rikrijon, edhe njerëzit të cilët pastaj do të jenë në dy grupe:

- Një grup në xhenet.
- Një grup në xhehenem.

Allahu i Madhërishëm u është përgjigjur pyetjes së idhujtarëve se kur do të ndodhë kataklizma?

Ua ka bërë me dije se kjo çështje i takon vetëm Allahut Famëlartë, ndërsa pejgamberi a.s. është dërguar vetëm për të paralajmëruar.

Atë që e mohojnë do ta shohin konkretisht, sikurse të kishin jetuar në këtë botë vetëm një çast ditor.

O ju idhujtarë, a është më e vështirë krijimtaria e juve apo krijimi i qiellit të lartë. Padyshim se krijimi i qiellit është krijimtari më e komplikuar.

Allahu i Madhërishëm e ka bërë lartësinë e qiellit ashtu që anën e poshtme të e ka bërë të lartë, pra ashtu siç e ka bërë ultësi e ka bërë edhe lartësi.

Ky ajet është argument se ringjallja e trupave nga varret nuk është e vështirë për Allahun e Madhërishëm.

Natën e qiellit, Allahu e ka bërë errësirë, pastaj e ka ndriçuar ditën me dritën e diellit.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالْأَرْضَ بَعْدَ ذَلِكَ دَحَاهَا ﴿٣٠﴾

أَخْرَجَ مِنْهَا مَاءَهَا وَمَرْعَاهَا ﴿٣١﴾

وَالْجِبَالَ أَرْسَاهَا ﴿٣٢﴾

مَتَاعًا لَّكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ ﴿٣٣﴾

“E pastaj tokën e sheshoi.

Dhe prej saj nxori ujin e saj dhe kullosat e saj.

Kurse kodrat ia përforcoi.

Si furnizim për ju dhe për kafshët tuaja.” (En-Naziatë: 30-33)

E ka sheshuar tokën, dhe e ka bë elipsoide. Kjo, pas krijimit të qiellit.

E ka sheshuar tokën, dhe e ka bë sikurse veza. Kjo, pas krijimit të qiellit.

Toka ka qenë e krijuar, por e pa konstruktuar (e rrumbullakuar) para se të krijohet qielli, e pastaj e ka sheshuar pas krijimit të qiellit.

Kjo dëshmon se Allahu i Madhërishëm e ka krijuar tokën dhe ende nuk e ka sheshuar (rrafshuar), pastaj i është qasur diellit, deri sa ka qenë tym, dhe e ka krijuar qiellin dhe e ka ndërtuar, e pas kësaj tokën e ka sheshuar.

Allahu, gjatë rrafshimit të tokës e ka bë të gatshme që të jetohet në të, ashtu që nga toka të shpërthen ujë nëpërmjet burimeve.

Allahu, gjatë rrafshimit të tokës e ka bë të gatshme që të jetohet në të, ashtu që nga toka të shpërthen ujë nëpërmjet përroskave e lumenjve.

Pastaj ka bë të blegërohen fushat me barishte e me pemishte për kafshët.

Pastaj ka bë bimët për bijtë e Ademit, siç janë farërat dhe frytet.

Pastaj ka bë kodrat si shtylla të tokës, ashtu që banorët e saj të jetojnë në stabilitet.

Të gjitha këto begati, kuptohet se janë në të mirën e njerëzve dhe të kafshëve, kënaqen me to dhe në tokë.

Allahu, të gjitha këto i ka bë në dobi dhe për të mirën tuaj o ju njerëz, për ju dhe për kafshët e juaja të cilat i shfrytëzoni për transport të mallrave, transport të udhëtarëve, dhe që të konsumoni mishin e tyre, e ato janë: Devetë, lopët dhe bagëtia.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٣٤﴾ فَإِذَا جَاءَتِ الطَّامَةُ الْكُبْرَىٰ

يَوْمَ يَتَذَكَّرُ الْإِنْسَانُ مَا سَعَىٰ ﴿٣٥﴾

وَبُرُزَّتِ الْجَحِيمُ لِمَن يَرَىٰ ﴿٣٦﴾

“E kur të vijë vala e madhe (kijameti).

Atë ditë njeriu përkujton se çka ka punuar.

E Xhehennemi shfaqet sheshazi për atë që e sheh.” (En-Naziatë: 34-36)

Kur të ndodhë katastrofa e madhe e cila shkatërron çdo gjë, e ajo është dita e gjykimit, apo fryrja e dytë e surit, dhe kur njeriu harron çdo gjë që ka pranë vetes dhe i kujton veprat për të cilat i ka punuar në këtë botë.

Kur të ndodhë katastrofa e madhe e cila shkatërron çdo gjë, e ajo është dita e gjykimit, e ringjalljes nga varrezat, dhe kur njeriu harron çdo gjë që ka pranë vetes dhe i kujton veprat për të cilat është angazhuar në këtë botë.

Atëherë, merret vendimi përfundimtar i ndarjes në mes njerëzve ku Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٣٧﴾ فَأَمَّا مَن طَغَىٰ

وَأَثَرَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ﴿٣٨﴾

فَإِنَّ الْجَحِيمَ هِيَ الْمَأْوَىٰ ﴿٣٩﴾

“E për sa i përket atij që e ka tepruar.

Dhe i dha përparësi jetës së kësaj bote,

Xhehennemi do të jetë vendi i tij.” (En-Naziatë: 37-39)

Sa i përket kriminelit, i cili i ka tejkualuar kufijtë e vet dhe e mohon Zotin, dhe i jep përparësi vetëm kësaj bote dhe e anashkalon botën tjetër, dhe nuk përgatitet për botën tjetër, nuk punon për botën tjetër, vendstrehim është zjarri përvëlues dhe djegës.

Sa i përket atij i cili i ka tejkualuar kufijtë e vet dhe mëkaton dhe i jep përparësi vetëm kësaj bote dhe e anashkalon botën tjetër, dhe nuk përgatitet për botën tjetër, nuk punon për botën tjetër, vendbanim dhe vendqëndrim është zjarri përvëlues dhe djegës. Kjo nga shkakun se dashuria e kësaj bote është koka e çdo mëkati.

Sa i përket atij i cili rebelohet dhe tregohet kryeneç dhe i jep përparësi vetëm kësaj bote dhe e anashkalon botën tjetër, dhe nuk përgatitet për botën tjetër, nuk punon për botën tjetër, vendqëndrim është xhehenemi. Kjo nga shkakut se dashuria e kësaj bote është koka e çdo mëkati.

Besimtarë të nderuar!

Për besimtarët Zoti i madhërishëm thotë:

وَأَمَّا مَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِ وَنَهَى النَّفْسَ عَنِ الْهَوَىٰ ﴿٤٠﴾

فَإِنَّ الْجَنَّةَ هِيَ الْمَأْوَىٰ ﴿٤١﴾

“E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epshëve,

Xheneti është vendi i tij.” (En-Naziatë: 40, 41)

- Sa i përket atij i cili i frikësohet gjykimit të Allahut në ditën e gjykimit, i cili e ka kuptuar madhështinë e Allahut Famëlartë, dhe e largon veten nga epshet, dhe e largon nga mëkatet dhe ndalesat të cilat i lakmon, vend i përgatitur për të është xheneti, vendqëndrim dhe vendbanim është xheneti, e asnjë vend tjetër.

- Sa i përket atij i cili i frikësohet gjykimit të Allahut, e largon veten nga epshet dhe kthehet në devotshmëri ndaj Zotit të tij, vend i përgatitur për të është xheneti, vendqëndrim dhe vendbanim është xheneti, e asnjë vend tjetër.

- Sa i përket atij i cili i frikësohet dhe i cili e ka kuptuar madhështinë e Allahut Famëlartë, dhe e largon veten nga epshet, dhe e largon nga mëkatet dhe ndalesat të cilat i lakmon, dhe kthehet në devotshmëri ndaj Zotit të tij, vend i përgatitur për të është xheneti, vendqëndrim dhe vendbanim është xheneti, e asnjë vend tjetër.

- Sa i përket atij i cili i frikësohet gjykimit të Allahut, i cili kthehet në devotshmëri ndaj Zotit të tij, vend i përgatitur për të është xheneti, vendqëndrim dhe vendbanim është xheneti, e asnjë vend tjetër.

Vëllezër të nderuar!

Kurejshitët kanë pas filluar të hulumtojnë për momentin e ditës së gjykimit.

Sot shumë njerëz pabesimtarë e ateist hulumtojnë për kohën e ditës së gjykimit.

Për ditën të cilën ka informuar pejgamberi a.s., dhe i kishte paralajmëruar për atë ditë, dhe e kishte përmendur shpesh.

Aishja r.a. ka thënë: Pejgamberin a.s. e pyetnin për ditën e gjykimit, deri sa ka zbritur ajeti:

يَسْأَلُونَكَ عَنِ السَّاعَةِ أَيَّانَ مُرْسَاهَا ﴿٤٢﴾

فِيمَ أَنْتَ مِنْ ذِكْرَاهَا ﴿٤٣﴾

إِلَىٰ رَبِّكَ مُنْتَهَاهَا ﴿٤٤﴾

إِنَّمَا أَنْتَ مُنْذِرٌ مَّنْ يَخْشَاهَا ﴿٤٥﴾

“Ty të pyesin për kijametin: “Kur do të ndodhë ai?!”

Po, në çfarë gjendje je ti t’ua përkujtosh atë?

Vetëm te Zoti yt është dijenia për të.

Ti je vetëm qortues i atij që ia ka frikën Atij.” (En-Naziatë: 42-45)

Allahu i Madhërishëm e paraqet pyetjen ironike të idhujtarëve për kohën e kataklizmës.

O pejgamber, idhujtarët përgënjeshtres të pyesin për ringjalljen dhe për kohën e seancës apo të procesit të ditës së gjykimit, për momentin e ndodhjes së kataklizmës dhe të ditës së gjykimit: Kur do ta realizon atë proces Allahu?

Allahu i Madhërishëm e ka ndalur pejgamberin a.s. duke i thënë:

“Po, në çfarë gjendje je ti t’ua përkujtosh atë?”. (Naziatë: 43)

Pse ta përmendësh kohën dhe momentin e saj, kur ti nuk ke të bësh asgjë në caktimin e atij momenti?

Ti nuk di asgjë për atë moment dhe nuk është në interesin tënd ta sqarosh dhe ta tregosh atë moment.

Vetëm Allahu e di konkretisht atë moment.

Allahu të ka dërguar ty që t’i paralajmërosh njerëzit dhe t’ua tërheqësh vërejtjen nga dënimi prej Allahut, nga vështirësia e asaj dite.

Ata të cilët i frikësohen dënimit prej Allahut dhe të cilët të dëgjojnë dhe shpëtojnë.

Ata të cilët nuk e besojnë ditën e gjykimit dhe të kundërshtojnë, ata kanë dështuar dhe janë shkatërruar.

Mos u merr me çështjen për të cilën nuk ngarkohesh. Vepro atë për çka je urdhëruar dhe vetëm paralajmëro.

Përfundim

Zoti i Madhërishëm thotë:

كَانَهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَهَا لَمْ يَلْبُثُوا إِلَّا عَشِيَّةً أَوْ ضُحَاهَا ﴿٤٦﴾

“Ditën kur ta përjetojnë atë, atyre (idhujtarëve) do t’u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj.” (*En-Naziatë: 46*)

Ajo ditë për të cilën pyetesh, domosdoshmërisht do të ndodhë, thuaja se ata veç janë në atë ditë. Ata kur do të ringjallen nga varret dhe kur do të tubohen, dhe kur do të prezantojnë në ditën e gjykimit, e shkurtojnë kohën e qëndrimit në të thuaja se ajo është prezent brenda ditës, ose në mbrëmje të asaj dite.

Allahu i Madhërishëm e ka përafruar çështjen e ditës së gjykimit, duke e treguar se, njeriu kur do ta shoh atë ditë do të mendon se në dunja nuk ka jetuar më shumë se një natë apo më shumë se një ditë.

E ka mbështetur ditën në natë nga shkakut se dita dhe nata janë pjesë njësie e kalendarit ditor.

Qëllimi është të tregohet kohëzgjatja e shkurtë e kësaj bote në shpirtrat e tyre, atëherë kur do t’i shohin agonitë (trishtimet) e ditës së gjykimit.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e sures Naziatë.

SURETU ABESE (1)

Suretu Abese: 1-16

عَبَسَ وَتَوَلَّى ﴿١﴾ أَنْ جَاءَهُ الْأَعْمَى ﴿٢﴾ وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّهُ يَزَكِّي ﴿٣﴾ أَوْ يَذَّكَّرُ فَتَنْفَعَهُ الذِّكْرَى ﴿٤﴾ أَمَّا مَنْ اسْتَعْزَى ﴿٥﴾ فَأَنْتَ لَهُ تَصَدَّى ﴿٦﴾ وَمَا عَلَيْكَ أَلَّا يَزَكِّي ﴿٧﴾ وَأَمَّا مَنْ جَاءَكَ يَسْعَى ﴿٨﴾ وَهُوَ يَخْشَى ﴿٩﴾ فَأَنْتَ عَنْهُ تَلَهَّى ﴿١٠﴾ كَلَّا إِنَّهَا تَذْكِرَةٌ ﴿١١﴾ فَمَنْ شَاءَ ذَكَرْهُ ﴿١٢﴾ فِي صُحُفٍ مُكَرَّمَةٍ ﴿١٣﴾ مَرْفُوعَةٍ مُطَهَّرَةٍ ﴿١٤﴾ بِأَيْدِي سَفَرَةٍ ﴿١٥﴾ كِرَامٍ بَرَرَةٍ ﴿١٦﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Abese e ka specifikën e vet të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Abese që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Suretu Abese sqaron se Islami është fe e barazisë dhe e mosdiskriminimit.

Para se të lexojmë ajetet, t’i kthehemi rrethanave të para zbritjes së ajeteve të para të suretu Abese.

I verbri Abdullah Ibni Umi Mektumi ka shkuar te pejgamberi a.s. dhe i thoshte: O i dërguar i Allahut: Më këshillo.

Në atë çast pejgamberi a.s. ishte me njërin nga idhujtarët me famë Velid bin el Mugire dhe Ebu Xhehlin.

Në atë çast pejgamberi a.s. ishte i angazhuar me njerëz me pozitë të lartë të asaj kohe.

Pejgamberi a.s. kishte dëshirë të madhe që Islamin ta pranonin pjesëtarët eminent të tyre, dhe brengosej se nuk do ta pranonin thirrjen e tyre.

Pejgamberi a.s. është anuar nga Abdullah bin Mektumi dhe i afrohej tjetrit (idhujtarë) dhe i thotë: A nuk po e sheh se jam i nxënë. Ai i thotë: Jo!

Atëherë ka zbritur ajeti:

عَبَسَ وَتَوَلَّى ﴿١﴾

أَن جَاءَهُ الْأَعْمَى ﴿٢﴾

“U vërejt dhe ia ktheu shpinën nga shkaku se i shkoi i verbëri”. (Abese: 1-2).

O Muhamed, çka di ti, ndoshta ky i verbër pastrohet nga mëkatet dhe gabimet duke vepruar vepra të mira, nga ajo që mëson nga ti.

O Muhamed çka di ti, ndoshta ky i verbër merr mësim dhe i pranon këshillat dhe mësimet tua, e pastaj ato këshilla i bëjnë dobi:

وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّهُ يَزَكِّي ﴿٣﴾

أَوْ يَذْكُرُ فَتَنْفَعَهُ الذِّكْرَى ﴿٤﴾

“E ku mund ta dish ti, ndoshta ai do të pastrohet.

Apo do të këshillohet dhe këshilla do t'i bëjë dobi!” (Abese: 3, 4)

Vëllezër të nderuar!

Allahu i Madhërishëm e ka kritikuar haptazi pejgamberin a.s., ku i thotë:

أَمَّا مَنِ اسْتَغْنَى ﴿٥﴾

فَأَن تَ لَهُ تَصَدَّى ﴿٦﴾

وَمَا عَلَيْكَ أَلَّا يَزَكِّي ﴿٧﴾

“E ai që nuk ndien nevojë (për Zotin) pse ka pasuri,

Ti atij i vë veshin (i drejtohesh)!

Po ti nuk ke përgjegjësi, pse ai nuk pastrohet.” (Abese: 5-7)

Sa i përket atij i cili për shkak se është i pasur dhe nuk ndien nevojë ta dëgjon Kur'anin dhe mesazhin tënd, detyra jote është vetëm ta kumtosh shpalljen.

Besimtar i nderuar, kjo vlen edhe për ty. Sa i përket atij i cili për shkak se është i pasur dhe nuk ndien nevojë të dëgjon Kur'anin dhe mesazhin tënd, detyra jote është vetëm ta kumtosh shpalljen.

Sa i përket atij i cili nuk dëshiron të udhëzohet e të beson, ti i drejtohesh atij, ia kthen fytyrën atij, i flet atij, e këshillon, ndërsa nuk e ke për obligim ta bësh musliman, detyra jote është vetëm ta kumtosh shpalljen.

Sa i përket atij i cili ka famë dhe nuk ndien nevojë të dëgjon Kur'anin dhe mesazhin tënd, nuk dëshiron të udhëzohet e të beson, ti i drejtohesh atij, ia kthen fytyrën atij, i flet atij, e këshillon, ndërsa nuk e ke për obligim ta pastrosh prej mëkateve

Sa i përket atij i cili ka pozitë dhe nuk ndien nevojë të dëgjon mesazhin tënd, nuk dëshiron të udhëzohet, ti e këshillon, ndërsa nuk e ke për obligim ta bësh musliman, e ta pastrosh prej mëkateve, detyra jote është vetëm ta kumtosh shpalljen.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَأَمَّا مَنْ جَاءَكَ يَسْعَى ﴿٨﴾

وَهُوَ يَخْشَى ﴿٩﴾

فَأَنْتَ عَنْهُ تَلَهَّى ﴿١٠﴾

“Ndërsa ai që nxiton dhe vjen te ti,

Dhe meqë ai frikësohet,

E ti nuk e zë asgjë (dhe nuk ia vë veshin fjalës së tij)...” (Abese: 8-10)

Përderisa, ai i cili nxitonte te ti me vullnet, i cili kërkonte të udhëzohej me ajetet e Allahut, ai i cili frikësohej prej Allahut, ti ndaj ti shmangeshe.

Përderisa ai i cili nxitonte te ti me vullnet, i cili kërkonte këshilla për mirësi, i cili kërkonte të udhëzohej me ajetet e Allahut, ai i cili frikësohej prej Allahut, nuk i kushtojë vëmendje.

Ky është argument se është obligim që në këshilla të gjithë njerëzit të trajtohen barabartë, nuk ka dallim në mes të fortit dhe të dobët, në mes të gruas dhe burrit.

Përfundim

Në përfundim të këtyre ajeteve Zoti tregon për këshillën Kur'anore ku thotë:

كَلَّا إِنَّهَا تَذْكِرَةٌ ﴿١١﴾

فَمَنْ شَاءَ ذَكُرْهُ ﴿١٢﴾

فِي صُحُفٍ مُّكْرَمَةٍ ﴿١٣﴾

مَرْفُوعَةٍ مُّطَهَّرَةٍ ﴿١٤﴾

بِأَيْدِي سَفَرَةٍ ﴿١٥﴾

كِرَامٍ بَرَرَةٍ ﴿١٦﴾

“Jo ashtu! Në të vërtetë këto janë këshilla.

Kush do merr mësim nga kjo (nga Kur’ani).

Është këshillë në fletë të çmueshme.

Me vlerë të lartë e të ruajtur.

Në duar të udhëtuesve (engjëjve udhëtues mes All-llahut e njerëzve).

Të nderuar e të ruajtur.” (Abese: 11-16)

Allahu e kritikon atë të cilit i referohet.

Allahu i kritikon dhe i qorton të tjerët të cilët e kanë të njëjtën shprehje.

(O Muhamed) Mos vepro ngjashëm siç ke vepruar me Ibni Umi Mektumin, duke ua kthyer shpinën të varfërve, e duke ua drejtuar fytyrën të pasurve, të cilët thjesht nuk e kanë ndërmend të pastrohen moralisht.

O besimtarë, mos veproni ngjashëm siç është vepruar me Ibni Umi Mektumin, duke ua kthyer shpinën të varfërve, e duke ua drejtuar fytyrën të pasurve të cilët thjesht nuk e kanë ndërmend të pastrohen moralisht.

Ky ajet është këshillë dhe mësim, se si duhet të veproh në rastet e tilla.

Pas këtij rasti, pejgamberi a.s. kur e shihte Ibni Umi Mektumin i thoshte: “Mirë se të shohë dhe mirë se erdhe ti, për të cilin më ka qortuar Zoti im, Famëlartë, dhe e shtrinte dorën dhe e afronte në kraharorin e tij”.

Pejgamberi a.s. me të ka qëndruar dy herë në Medine.

Kjo këshillë është e dyanshme:

- Ajo është këshillë e qartë dhe e kristalizuar, këshillë e cila kuptohet.
- Kush e dëshiron atë këshillë, e pranon, e ruan në mendjen e tij dhe vepron me të.

Ajo këshillë është e konfirmuar dhe ekziston në fletushkat e ruajtura te Allahu i Madhërishëm nga shkakut se posedon dituri dhe urtësi.

Ajo këshillë është e arkivuar në Levhi Mahfudhë dhe te Zoti është e rëndësishme dhe ka vlerë të madhe.

Ajo këshillë është e sigurt, e arkivuar dhe nuk e prekin vetëm se të pastrit.

Ajo bartet nga duart e melaqeve, të cilat janë ndërmjetësuese në përcjelljen e shpalljes të pejgamberët për ta kumtuar të njerëzit, ata janë të nderuara te Zoti i tyre, nuk bëjnë mëkate, e dëgjojnë Zotin e tyre.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Abese.

SURETU ABESE (2)

Suretu Abese: 17-42

﴿١٧﴾ مِنْ أَيِّ شَيْءٍ خَلَقَهُ ﴿١٨﴾ مِنْ تُطْفَةِ خَلْقِهِ فَقَدَرَهُ ﴿١٩﴾ ثُمَّ
السَّبِيلَ يَسْرُهُ ﴿٢٠﴾ ثُمَّ أَمَاتَهُ فَأَقْبَرَهُ ﴿٢١﴾ ثُمَّ إِذَا شَاءَ أَنْشَرَهُ ﴿٢٢﴾ كَلَّا لَمَّا يَقْضِ مَا أَمَرَهُ
﴿٢٣﴾ فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ ﴿٢٤﴾ أَنَّا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا ﴿٢٥﴾ ثُمَّ شَقَقْنَا الْأَرْضَ شَقًّا
﴿٢٦﴾ فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا ﴿٢٧﴾ وَعَبَبْنَا وَقْضِيبًا ﴿٢٨﴾ وَزَيْتُونًا وَنَخْلًا ﴿٢٩﴾ وَحَدَائِقَ غُلْبًا ﴿٣٠﴾
وَفَاكِهَةً وَأَبًّا ﴿٣١﴾ مَتَاعًا لَكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ ﴿٣٢﴾ فَإِذَا جَاءَتِ الصَّاحَّةُ ﴿٣٣﴾ يَوْمَ يَقُرُّ الْمَرْءُ مِنْ
أَخِيهِ ﴿٣٤﴾ وَأُمِّهِ وَأَبِيهِ ﴿٣٥﴾ وَصَاحِبَتِهِ وَبَنِيهِ ﴿٣٦﴾ لِكُلِّ امْرِئٍ مِّنْهُمْ يَوْمَئِذٍ شَأْنٌ يُغْنِيهِ ﴿٣٧﴾
وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ مُّسْفِرَةٌ ﴿٣٨﴾ ضَاحِكَةٌ مُّسْتَبْشِرَةٌ ﴿٣٩﴾ وَوُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ عَلَيَّهَا غَبَرَةٌ ﴿٤٠﴾ تَرْهَقُهَا
فِتْرَةٌ ﴿٤١﴾ أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرَةُ الْفَجَرَةُ ﴿٤٢﴾

Vëllezër të nderuar!

Po vazhdojmë me Hutbe e dytë të suretu Abese.

Para se t'i lexojmë ajetet, po tregojmë ngjarjen e cila ka ndikuar në zbritjen e ajeteve të cilat do t'i sqarojmë.

Utbe bin Ebi Lehebi është Djali i Ebu Lehebit.

Një ditë prej ditëve ishte hidhëruar me babanë.

Shkon te pejgamberi a.s.

Pastaj është pajtuar me babanë.

Babai i jep pasuri Utbes, pra djalit të tij.

E përgatit të shkon në Siri.

Ebu Lehebi, pasi i jep pasuri, dhe Utbe para se të nisej për në Siri ka thënë:
“Unë e mohoj Zotin e yllit kur shkëlqen”.

Pejgamberi e ka mallkuar.

Përgjatë rrugës për në Siri, një luan e ka sulmuar Utbe bin Ebi Lehebin dhe e ka e ka shqyer, pra e ka ngrënë. Kështu që kanë zbritur ajetet:

قُتِلَ الْإِنْسَانُ مَا أَكْفَرَهُ ﴿١٧﴾

مِنْ أَيِّ شَيْءٍ خَلَقَهُ ﴿١٨﴾

مِنْ نُّطْفَةٍ خَلَقَهُ فَقَدَّرَهُ ﴿١٩﴾

ثُمَّ السَّبِيلَ يَسَّرَهُ ﴿٢٠﴾

ثُمَّ أَمَاتَهُ فَأَقْبَرَهُ ﴿٢١﴾

“Qoftë mallkuar njeriu, sa mohues i fortë është ai!

Po prej çkafi e krijoi Ai atë?

Atë e krijoi prej një pike uji dhe e përgatiti.

Pastaj atij ia lehtësoi rrugën.

Mandej atë e bëri të vdesë dhe atij i bëri varr (të varrosët).” (Abese: 17-21)

Nga cila gjë e fëlliqur, Allahu e ka krijuar këtë mohues të Zotit të vet? Nuk duhet që të bëhet megaloman dhe të mos e dëgjon Zotin.

Allahu i mallkon mohuesit e ringjalljes ku thotë: **“Mallkimi qoftë për njeriun, për çka mohon.”** (Naziatë: 17). Njeriu pabesimtar u vraftë, pra ai është i cili meriton të akuzohet për të.

Po çka e shtyri të mohon?

Çka e bëri pabesimtar?

Nga çka e ka krijuar Allahu këtë njeri, i cili e mohon Zotin?

Si është krijuar ky njeri i cili e mohon Zotin?

Pastaj Zoti sqaron se ia ka përcaktuar fazat dhe mënyrën e zhvillimit dhe formimit.

E ka zhvilluar në atë masë sa është në gjendje të punon për të mirën e vet.

E ka plotësuar dhe e ka kompletuar me të gjitha organet fizike, të cilat janë të përshtatshme përgjatë gjithë jetës.

E ka pajisur me mendje, me të kuptuar, me mjetet e kuptimit ashtuqë t'i shfrytëzon mirësitë e Allahut, e jo t'i shfrytëzon për ta fituar hidhërimin e Allahut.

Allahu, këtij njeriu ia ka lehtësuar rrugën për të dalë nga mitra dhe nga barku i nënës së vet.

Allahu, këtij njeriu ia ka mundësuar që të realizon edhe të mirat edhe të këqijat.

“Rrugë” është në mënyrë gjenerale si për rrugën e drejt dhe në rrugën e devijuar apo gabuar.

- Një popull drejtohet në këtë rrugë,
- Një popull tjetër drejtohet për atë rrugë.

Pas krijimit dhe jetës së tij, i merret shpirti dhe varroset në varr, pra i bëhet një varr.

Në këtë mënyrë nderohet dhe nuk hedhet sikurse hedhen kafshët.

Pas kësaj e tubon, pra e ringjallë përsëri pasi të ketë vdekur.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

ثُمَّ إِذَا شَاءَ أَنْشَرُهُ ﴿٢٢﴾

كَلَّا لَمَّا يَقْضِ مَا أَمَرُهُ ﴿٢٣﴾

“Pastaj kur të dojë Ai e ringjallë atë.

Jo, kurrsesi jo! Ai nuk zbatoi atë që urdhëroi Ai.” (Abese: 22, 23)

Pastaj kur të vjen koha ashtu siç ka dëshiruar, e ajo është dita e gjykimit.

Thënia e Allahut: **“Jo, kurrsesi jo”**. Kjo është për qortim për vet gjendjen e njeriut.

Njeriu vazhdimisht:

- ose ka qenë joserioz
- ose me devijim.
- ose me mëkat.
- ose duke mos vepruar të duhurën dhe atë çka është e vlefshme dhe çka i takon atij dhe vetëm pak vepron nga ato që ka urdhëruar Allahu.

Kjo është për t’u habitur me veprimet e njeriut!.

Vëllezër të nderuar!

Në vazhdim Zoti i madhërishëm tregon për begatitë e Tij për njeriun. Kjo, për të sqaruar fuqinë absolute të Tij:

- Në rend të parë i ka treguar begatitë për njerëzit.
- Në rend të dytë i ka përmendur argumentet në horizont.
- Në rend të tretë i ka numëruar mirësitë për të cilat njeriu ka nevojë për ta zhvilluar jetën.

I ka treguar këto mirësi se ndoshta këto mirësi i pranon dhe e di vlerën e tyre ashtu që të beson në Zotin.

I ka treguar këto mirësi se ndoshta këto mirësi i pranon dhe e di vlerën e tyre ashtu që të falënderon.

Në fund ia tërheqë vërejtjen se me çka do të ballafaqohet kur do të ndodhë kataklizma.

I tregon se çka e pret në botën tjetër.

Ia tregon gjërat të cilat e frikësojnë njeriun, ashtu që të jenë mjete për t'i analizuar ato dukuri.

Ia tregon gjërat të cilat e tmerrojnë njeriun, ashtu që të jenë mjete të besojnë në Krijuesin e universit.

Ia tregon gjërat të cilat e tmerrojnë njeriun, ashtu që të jenë mjete të largohen nga pabesimi dhe të bëhen të devotshëm.

Kjo vërehet në ajetet në vijim ku Zoti i Madhërishëm thotë:

فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ إِلَى طَعَامِهِ ﴿٢٤﴾

أَنَا صَبَبْنَا الْمَاءَ صَبًّا ﴿٢٥﴾

ثُمَّ شَقَقْنَا الْأَرْضَ شَقًّا ﴿٢٦﴾

فَأَنْبَتْنَا فِيهَا حَبًّا ﴿٢٧﴾

وَعِنَبًا وَقَضْبًا ﴿٢٨﴾

وَزَيْتُونًا وَنَخْلًا ﴿٢٩﴾

وَحَدَائِقَ غُلْبًا ﴿٣٠﴾

وَفَاكِهَةً وَأَبًّا ﴿٣١﴾

مَتَاعًا لَّكُمْ وَلِأَنْعَامِكُمْ ﴿٣٢﴾

“Njeriu le të shikojë ushqimin e vet.

Ne lëshuam shi të mjaftueshëm.

Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës,

Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra

Edhe rrush e perime,

Edhe ullinj e hurma,

Edhe kopshte të dendura,

Dhe pemë e kullosa,

Si mjete gjallërimi për ju dhe për bagëtinë tuaj.” (Abese: 24-32)

Njeriu le të analizojë se si Allahu ia ka krijuar ushqimin prej të cilit jeton.

Le të analizojë se si Allahu i ka krijuar për njeriun.

Le të analizojë begatitë të cilat Allahu ia ka dhënë njeriut.

Ato janë qindra begati të cilat përsëriten në natyrë.

Ato begati janë argument ashtu që ngjallja e bimëve prej dheut i ngjason ngjalljes së trupave pas kalbjes së saj.

Mënyra e sigurimit të ushqimit:

Zoti e zbret shiun nga qielli, apo nga retë në tokë me vrull dhe me ujë të bollshëm.

Pastaj, farërat e qajnë tokën dhe dalin mbi tokë, pastaj rriten dhe zhvillohen, kështu kemi siguruar bimë dhe drithëra të llojllojshme.

Zoti është ai i Cili në tokë ka siguruar drithëra dhe bimë me të cilat ushqehet njeriu si f.v.: gruri, elbi, misri, orizi.

Zoti është ai i Cili në tokë ka siguruar vreshta të llojllojshme.

Zoti është ai i Cili në tokë ka siguruar llojet e barishteve për kafshët.

Në këtë rast fjala “katb” është për prodhimet bimore siç janë pemët, perimet, e kështu me radhë.

Ky lloj ushqimi përbënë një pjesë të madhe të ushqimit njerëzor.

Po ashtu kemi parapa plantacione me pemë (trungje) të mëdha dhe me degë të dendura dhe trupa të shumtë.

Urtësia e zhvillimit të agronomisë siç thotë Zoti i madhërishtëm:

“O ju njerëz, Ne e kemi bërë atë (zhvillimin e agronomisë) mjet të sigurimit të ushqimit për ju dhe për kafshët e juaja”.

Vëllezër të nderuar!

Në ajetet në vijim sqarohet për tmerrin e kijametit ku Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٣٣﴾ فَإِذَا جَاءَتِ الصَّاحَّةُ

﴿٣٤﴾ يَوْمَ يَفِرُّ الْمَرْءُ مِنْ أَخِيهِ

﴿٣٥﴾ وَأُمِّهِ وَأَبِيهِ

﴿٣٦﴾ وَصَاحِبَتِهِ وَبَنِيهِ

﴿٣٧﴾ لِكُلِّ امْرِئٍ مِّنْهُمْ يَوْمَئِذٍ شَأْنٌ يُغْنِيهِ

“E kur të vijë ushtima (krisma e kijametit);

Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet,

Prej nënës dhe prej babait të vet,

Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet.

Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet.” (Abese: 33-37)

Atëherë kur të ndodhë kataklizma - “Sahatun”.

Atëherë është momenti kur do t’i fryhet surit i cili i shurdhon veshët nga ushtima e fortë.

Atëherë do të shohësh se si njeriu largohet nga më të afërtit e tij:

Atëherë do të shohësh se si njeriu largohet nga vëllai.

Atëherë do të shohësh se si njeriu largohet nga nëna.

Atëherë do të shohësh se si njeriu largohet nga babai.

Atëherë do të shohësh se si njeriu largohet nga bashkëshortja.

Atëherë do të shohësh se si njeriu largohet nga fëmijët.

Atëherë njeriu largohet nga të gjithë ata.

E gjithë kjo nga tmerri dhe trishtimi

E gjithë kjo të mos i kërkohet diçka.

Atëherë gjithsecili është i preokupuar për veten e tij, dhe nuk ka dëshirë të ballafaqohet me të afërmit dhe dëshiron që të mos e shohin se në çfarë gjendje është.

Pejgamberi a.s. ka thënë se atëherë njeriu do të thotë: **“Interesohem vetëm për veten time dhe për askënd tjetër”**. Atëherë njeriu nuk dëshiron të takohet me askënd.

Pejgamberi a.s. ka thënë: **“Në ditën e gjykimit nuk brengosesh a je i veshur me rroba, apo je lakuriq”.**

Vëllezër të nderuar!

Në ditën e gjykimit njerëzit do të jenë në dy grupe:

- Të lumtur dhe
- Të dëshpëruar.

Për grupin e parë, Zoti i madhërishëm thotë:

وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ مُّسْفِرَةٌ ﴿٣٨﴾

ضَاحِكَةٌ مُّسْتَبْشِرَةٌ ﴿٣٩﴾

**“Atë ditë do të ketë fytyra të shndritura,
Të buzëqeshura e të gëzuara.”** (Abese: 38, 39)

- Do të ketë fytyra të ndritura, ngazëlluese, të cilat shkëlqejnë si drita.

Këto fytyra janë fytyrat e besimtarëve.

Këto fytyra janë fytyrat e banorë të xhenetit.

Do të gëzohen besimtarët kur e kuptojnë se do të jenë të nderuar.

Do të gëzohen banorët e xhenetit kur e kuptojnë se do të jenë të respektuar.

Vëllezër të nderuar!

Në ditën e gjykimit njerëzit do të jenë në dy grupe,

- Të lumtur dhe
- Të dëshpëruar.

Për grupin e dytë, Zoti i madhërishëm thotë:

وَوُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ عَلَيْهَا غَبَرَةٌ ﴿٤٠﴾

تَرْهَقُهَا قَتَرَةٌ ﴿٤١﴾

أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرَةُ الْفَجَرَةُ ﴿٤٢﴾

**“Atë ditë do të ketë edhe fytyra të pluhuruara,
Që i ka mbuluar errësira e zezë,
E të tillët janë ata mohuesit, mëkatarët.”** (Abese: 40-42).

- Në ditën e gjykimit do të ketë fytyra të pluhurosura dhe të nxira.

Fytyrat do të nxihen kur të shohin se çfarë dënimi ka përgatitur Allahu për ata.

Ata i mbulon pluhuri i zi.

Ata përbuzen dhe poshtërohen.

Fytyra të pluhurosura janë fytyrat të cilët e kanë mohuar Zotin, të cilët nuk kanë besuar.

Fytyra e nxira janë fytyrat të cilët nuk u kanë besuar peygamberëve dhe shpalljes së tyre.

Ata janë të cilët kanë bërë mëkate dhe të këqija.

Ata janë të cilët kanë mohuar dhe kanë bërë mëkate.

Pabesimtarët të cilët kanë qenë në kohën e zbritjes së Kur'anit janë: kurejshitët dhe të ngjashmit me ta të së kaluarës dhe të tanishmes.

Përfundim

Ky përshkrim trishtues i ditës së gjykimit kërkon analizë të thuktë dhe meditim të thellë, para ballafaqimit me ato vështirësi prej të cilave nuk ka shërim më pastaj, dhe se nuk mund të ndryshohet ajo gjendje.

Rruga e shpëtimit nga ajo situatë e vështirë është:

- Besimi në Allahun e Madhërishëm,
- Besimi në melaqet e Tij,
- Besimi në librat e Tij,
- Besimi në peygamberët e Tij,
- Besimi në ditën e gjykimit,
- Besimi në kadanë dhe kaderin e Zotit.

Veprave të mira duhet t'i bashkëngjitet besimi, i cili është kushti bazë i pranimit të veprave tek Allahu i Madhërishëm.

Ai i cili i përmbushë këta dy elemente, ai ka shpëtuar, çështja e tij i lehtësohet dhe ka shpëtuar.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e sures Abese.

SURETU TEKVIRË (1)

Suretu Tekvirë: 1-14

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ﴿١﴾ وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ ﴿٢﴾ وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ ﴿٣﴾ وَإِذَا الْعِشَارُ
عُطِّلَتْ ﴿٤﴾ وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ ﴿٥﴾ وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ ﴿٦﴾ وَإِذَا النُّفُوسُ زُوِّجَتْ ﴿٧﴾
وَإِذَا الْمَوْءُودَةُ سُئِلَتْ ﴿٨﴾ بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ ﴿٩﴾ وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ﴿١٠﴾ وَإِذَا السَّمَاءُ
كُشِطَتْ ﴿١١﴾ وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِّرَتْ ﴿١٢﴾ وَإِذَا الْجَنَّةُ أُزْلِفَتْ ﴿١٣﴾ عَلِمَتْ نَفْسٌ مَّا
أَحْضَرَتْ ﴿١٤﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Tekvirë e ka specifikën e vet, të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Tekvirë që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Suret Mekase dallohen me atë se përbëhen prej ajeteve të shkurta.

Suret Mekase dallohen me atë se përshkruajnë ringjalljen dhe kataklizmën.

Sureja Nebeë përshkruan kataklizmën, përshkruan kijametin.

Fillimi i sures flet për ndërrimin e qiellit dhe të tokës në ditën e gjykimit ku thotë:

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ﴿١﴾

وَإِذَا النُّجُومُ انْكَدَرَتْ ﴿٢﴾

وَإِذَا الْجِبَالُ سُيِّرَتْ ﴿٣﴾

وَإِذَا الْعِشَارُ عُطِّلَتْ ﴿٤﴾

وَإِذَا الْوُحُوشُ حُشِرَتْ ﴿٥﴾

وَإِذَا الْبِحَارُ سُجِّرَتْ ﴿٦﴾

وَإِذَا النُّفُوسُ زُوِّجَتْ ﴿٧﴾

وَإِذَا الْمَوْءِدَةُ سُئِلَتْ ﴿٨﴾

بِأَيِّ ذَنْبٍ قُتِلَتْ ﴿٩﴾

**“Kur dielli të jetë mbështjellë (dhe errësohet),
Dhe kur yjet të kenë rënë (e shkapërderdhur),
Dhe kur kodrat të kenë udhëtuar (e bërë pluhur në ajër),
Dhe kur devetë e shtrenjta të lihen pa bari në fushë,
Dhe kur egërsirat të jenë bashkuar (tubuar).
Dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakëruar,
Dhe kur shpirtrat të jenë bashkuar.
Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla,
Për çfarë mëkati ato janë mbytur” (Et-Tekvirë: 1-9)**

Allahu i Madhërishëm e ka përshkruar ditën e kataklizmës me çështje të cilat tmerrojnë njeriun.

E ka përshkruar ditën e kataklizmës me çështje të cilat fusin frikën në palcë.

E ka përshkruar ditën e kataklizmës me çështje të cilat shkaktojnë mërzi dhe trishtim.

E ka përshkruar në atë mënyrë sa që ekzistenca ndryshon në tërësi dhe zëvendësohen qiejt dhe toka me qiej dhe toka bëhet tjetër tokë.

Njeriu befasohet me botën e re kur:

- Qielli, yjet dhe trupat qiellorë ndeshen në mes vete.
- Kodrat shkulen nga vendet e veta dhe bëhen copa dhe thërrime.
- Ujërat e deteve dhe oqeanëve vlojnë.
- Shpirtrat e të vdekurve kthehen në trupat e tyre.
- Shpërndahen regjistrat.
- Xhehenemi përcëllon dhe flakëron.
- Xheneti afrohet dhe shpaloset.

Atëherë secili njeri e di se çka ka vepruar, qoftë mirë, qoftë keq, siç sqarojnë ajetet në vijim të suretu Tekvirë.

Të gjitha këto janë ndodhi të kataklizmës. Dielli do të mblidhet dhe palohet, ashtu që sillet dhe shkon aty ku dëshiron Zoti.

Atëherë kur yjet do të bien dhe do të shpërndahen.

Atëherë kur kodrat do të shkulen nga vendet e tyre në tokë dhe do të fluturojnë në ajër sikurse fijet e leshit.

Fjala “Nuxhumun kederet” e ka kuptimin: Kur yjet i lëshojnë orbitat e tyre dhe ndeshen në mes vete.

Njeriu befasohet me botën e re:

Atëherë kur deveja barsë.

Atëherë kur do të tubohen egërsirat për t'u hakmarrë ndaj njëra-tjetrës. Kafsha shyte hakmerret ndaj kafshës me brirë.

Atëherë kur detet do të vlojnë nga vullkanet, nga tërmetet dhe dridhjet e tokës dhe për këtë arsye bëhet ujë valë me zjarr, pasi bashkohen njëra me tjetrën dhe bëhen njësi e përbashkët.

Atëherë kur do të bashkohen shpirtrat me trupat e tyre në formë tjetër.

Atëherë kur foshnja e gjinisë femërore e cila është varrosur për së gjalli, nga shkak i turpit ose nevojës, do të pyetet se çfarë gabimi ka bë që është vrarë!? Ky ka qenë kërcënim për ata të cilët i mbysnin foshnjat e tyre.

Atëherë kur pyetet i dëmtuari, po atëherë çka mendon dëmtuesi!?

Atëherë kur pyetet viktimja, atëherë çka mendon kriminelin!?

Kjo paraqitje është paraqitje në mënyrën e qortimit të veprës së arabëve në atë mënyrë. Pyetja e saj bëhet, për t'i pyetur vepërkryerësit.

Vëllezër të nderuar!

Në pjesën e dytë të suretu Tekvirë Zoti i madhërishëm thotë:

وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ ﴿١٠﴾

وَإِذَا السَّمَاءُ كُشِطَتْ ﴿١١﴾

“Dhe kur fletushkat të jenë shpaluar,

Dhe kur qielli të jetë hequr” (Et-Tekvirë: 10, 11)

- Atëherë kur veprat, regjistrat e veprave, paraqiten dhe shpërndahen për llogaridhënie, për të dalë në gjykim.

Çdo njeriut i jepet regjistri.

Regjistri ose i jepet në dorën e djathtë të tij, i cili shpëton.

Regjistri ose i jepet në dorën e majtë apo pas shpine, i cili do të shkatërrohet.

Atëherë kur qielli do të zhduket, ashtu siç hiqet lëkura e deles kur prehet.

“Palosja e qiellit” bëhet ashtu sikurse mbyllen faqet e librit dhe nuk mbetet asgjë jashtë.

“Palosja e qiellit” bëhet ashtu sikurse mbyllen fletët e librit dhe nuk mbetet asgjë jashtë.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَإِذَا الْجَحِيمُ سُعِّرَتْ ﴿١٢﴾

وَإِذَا الْجَنَّةُ أُزْلِفَتْ ﴿١٣﴾

“Dhe kur Xhehennemi të jetë ndezur fort,

Dhe kur Xheneti të jetë afruar” (Et-Tekvirë: 12, 13)

Atëherë kur do të ndizet zjarri për armiqtë e Zotit, do të ndizet fortë dhe zjarri i saj do të jetë i madh.

Atëherë kur xheneti do të paraqitet dhe do të afrohet pranë banorëve të saj, pranë besimtarëve të devotshëm që të hynë në të.

Përfundim

عَلِمْتُ نَفْسٌ مَّا أَحْضَرْتُ ﴿١٤﴾

“Atëbotë njeriu do të dijë se çka ka ofruar (të mirë ose të keqe).” (Et-Tekvirë: 14)

Përgjigja ndaj fjalës “Atëherë kur” për të gjitha çështjet e përmendura është: fjala e Allahut të Madhërishëm:

“Çdo njeri do ta ketë kuptuar çka ka punuar”. (Et-Tekvirë: 14)

Pra, realizohet qëllimi në bazë të asaj se kush çka prezanton:

- Ai i cili prezanton të këqija futet në xhehenem.
- Ai i cili prezanton të këqijat hynë në xhenet.

Fjala “Nefs” është për personat, individët, shpirtrat.

Në këtë rast, të gjitha ajetet që nga fillimi janë ajete kushtore, ndërsa përgjigja e tyre është: **“E ka kuptuar gjithsecili se çka ka prezantuar”** (Naziatë: 14).

Këto janë çështjet e para befasuese të ringjalljes.

Në sure tjetër Allahu i Madhërishëm ka thënë:

وَنُفِّخَ فِي الصُّورِ ذَٰلِكَ يَوْمَ الْوَعِيدِ ﴿٢٠﴾

“Dhe i fryhet surit, e ajo është dita e premtuar (për dënim)”. (Kaf: 20)

Në ajetet më pastaj, sqarohet në mënyrë të detajuar:

- Paraqitja e melaqeve të shoqëruara, të cilat janë të autorizuar për të gjykuarit.
- Paraqitet debat i nxehtë në mes të njeriut dhe shokut shejtan të tij.
- Paraqitet çështja e mohuesve pabesimtarë.
- Bashkohen të gjithë dhe hidhen në xhehenem.
- Xhehenemi kërkon më shumë banorë.

Thënia e Allahut: **“E ka kuptuar çdo njeri çka ka prezantuar”.** (Et-Tekvirë: 14) është shprehje globale e cila futë frikë dhe mërzë. Kjo sepse njeriu zakonisht harron se çka ka punuar në dunja, dhe befasohet kur në regjistrin e vet sheh veprat e tij në mënyrë të detajuar.

Thënia e Allahut: **“E ka kuptuar çdo njeri çka ka prezantuar”.** (Et-Tekvirë: 14) është shprehje globale e cila futë frikëtrishtim. Kjo sepse njeriu befasohet kur e kupton se nuk ka shpresë t'i tejkalon rreziqet, vetëm se nëse i peshojnë të mirat mbi të këqijat, ashtu që Allahu t'i përfshinë me mëshirën e Tij robërit të cilët kanë bërë lëshime.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Tekvirë.

SURETU TEKVIRË (2)

Suretu Tekvirë: 15-29

فَلَا أُقْسِمُ بِالْخُنَّسِ ﴿١٥﴾ الْجَوَارِ الْكُنَّسِ ﴿١٦﴾ وَاللَّيْلِ إِذَا عَسْعَسَ ﴿١٧﴾ وَالصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ ﴿١٨﴾ إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ﴿١٩﴾ ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ ﴿٢٠﴾ مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ ﴿٢١﴾ وَمَا صَاحِبُكُمْ بِمَجْنُونٍ ﴿٢٢﴾ وَلَقَدْ رَآهُ بِالْأَفُقِ الْمُبِينِ ﴿٢٣﴾ وَمَا هُوَ عَلَى الْغَيْبِ بِضَنِينٍ ﴿٢٤﴾ وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ ﴿٢٥﴾ فَأَيْنَ تَذْهَبُونَ ﴿٢٦﴾ إِنْ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ ﴿٢٧﴾ لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ ﴿٢٨﴾ وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٩﴾

Në pjesën e dytë të sures Tekvirë flitet:

- Për vërtetësinë e shpalljes dhe
- Për vërtetësinë e pejgamberisë së Muhamedit a.s., ku Zoti i Madhërishëm thotë:

فَلَا أُقْسِمُ بِالْخُنَّسِ ﴿١٥﴾

الْجَوَارِ الْكُنَّسِ ﴿١٦﴾

وَاللَّيْلِ إِذَا عَسْعَسَ ﴿١٧﴾

وَالصُّبْحِ إِذَا تَنَفَّسَ ﴿١٨﴾

**“Betohem fuqimisht në yjet që tërhiqen (ditën, e ndriçojnë natën),
Që udhëtojnë e fshihen (si dreri në strofkë),**

Qëllimi është për shtatë planetët (trupat) e sistemit diellorë: Diellin, Hëna, Marsi, Saturni, Venera, etj., - Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

Pasha natën kur ajo ia beh me errësirë.

Pasha agimin kur ia shkrep!” (Et-Tekvirë: 15-18)

Betohem në natën e cila paraqitet me errësirën e saj, pasi në të vërehet frikë.

Betohem në agimin i cili agon dhe vazhdimin e dritës deri në mesditë e cila ndriçon në pikën më të lartë të saj, në zenit.

Përgënjeshtrimi ndaj pejgamberit njëkohësisht nënkupton përgënjeshttrimin e shpalljes së Zotit dhe të Kur'anit të zbritur.

Përkundër asaj se Kur'ani është mrekulli mbinatyrore dhe se arabët e kishin të pamundur që ta mposhtnin, apo ta zhduknin, apo ta humbnin, gjë që dëshmon se Kur'ani është fjalë e Allahut Famëlartë të cilin e ka zbritur shpirti besnik Xhibrili a.s. në zemrën e Muhamedit a.s., kështu që Kur'ani është i zbritur nga Zoti i Plotfuqishëm, që të jetë paralajmërues në gjuhën e qartë arabe.

Këtu vërejmë anën tjetër të reagimit ndaj idesë së arabëve dhe pretendimeve të tyre me çështjen e Kur'anit. Allahu betohet në yjet dhe në trupat qiellorë të cilat qarkullojnë në orbitat e tyre.

Zoti betohet në natën dhe në agimin se Kur'ani është fjala e Allahut e shpallur nëpërmjet Xhibrilit a.s.

Zoti betohet në të gjithë yjet të cilët humben në hapësirën qiellore, pra humbin gjatë ditës nën dritën e diellit, dhe paraqiten gjatë natës në pozitat e tyre, ashtu siç del kaprolli nga strofulli i saj.

Arsyeja e betimit:

Zoti tregon arsyen e betimit ku thotë:

إِنَّهُ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ﴿١٩﴾

ذِي قُوَّةٍ عِنْدَ ذِي الْعَرْشِ مَكِينٍ ﴿٢٠﴾

مُطَاعٍ ثَمَّ أَمِينٍ ﴿٢١﴾

وَمَا صَاحِبُكُم بِمَجْنُونٍ ﴿٢٢﴾

“S’ka dyshim se ai (Kur’ani) është thënie e të dërguarit fisnik (që e pranoi prej Zotit).

Që është i fortë dhe që ka vend të lartë te Zoti i Arshit.

Që është i respektuar atje (në mesin e engjëjve) dhe besnik.

Nuk është i marrë shoku juaj (Muhamedi)!” (Et-Tekvirë: 19-22)

Përgjigjja apo arsyeja e betimit:

Ky Kur’an, është i bartur nga i dërguari fisnik i Allahut. E, ai është Xhibrili a.s.

Xhibrili i posedon këto attribute specifike:

- Është i fuqishëm për ta mbrojtur dhe për ta siguruar plotësisht dhe saktësisht dhe për ta përcjellë në mënyrë të sigurt.

- Ai është i ngritur lartë.

- Ai ka pozitë të veçantë te Allahu Famëlartë.

- I dëgjueshëm te melaqet, melaqet kthehen te ai dhe e dëgjojnë.

- Është besnik në përcjelljen e shpalljes dhe në zbatimin e urdhrave.

Xhibrili ka pozitë të lartë te Allahu i Madhërishëm.

Xhibrili ka pozitë të lartë dhe qëndron lartë.

Xhibrilit i pranohet fjala. Është i sigurt në atë që e thotë, besnik në atë që e dërgon, në përcjelljen e shpalljes dhe në zbatimin e urdhrave.

O ju banorë të Mekës, shoku i juaj Muhamedi nuk është i çmendur siç pretendoni. O ju banorë të tokës, shoku i juaj Muhamedi nuk është i çmendur siç pretendoni.

O ju ateistë, shoku i juaj Muhamedi nuk është i çmendur siç pretendoni.

Thënia e Allahut “Shoku juaj” është atribut se ata dinë për çështjen e tij, dhe se ai është më i mençuri dhe më i kompletuari.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

وَلَقَدْ رَآهُ بِالْأُفُقِ الْمُبِينِ ﴿٢٣﴾

وَمَا هُوَ عَلَى الْغَيْبِ بِضَنِينٍ ﴿٢٤﴾

“Dhe se ai e pat parë atë (Xhibrilin) në horizontin e qartë lindor.

Dhe ai nuk është që në të fshehtën (shpalljen) ka dyshim (ose ua lë mangu).” (Et-Tekvirë: 23, 24)

Për Zotin, Muhamedi a.s. e ka pa Xhibrilin në formën e tij të vërtetë, ai i ka gjashtëqind krahë.

E ka pa në lindje të diellit, apo kur dielli ka qenë në pjesën më të lartë pasi ka lindur dielli, ashtu që e ka kuptuar se është melaqja afër ashtu që të ishte i qetë dhe i sigurt se i zbriste shpalljen Xhibrili e jo shejtani i mallkuar.

Muhamedi a.s., në atë që i zbret shpallja dhe për çka informohet nuk është dembel dhe që neglizhon mësimin dhe kumtimin.

Përfundim

Atëherë kur Kurejshitët thoshin se Muhamedi është fallxhorë sikurse edhe sot që thonë se Muhamedi është vetëm fallxhorë.

Atëherë kur thoshin se Kur'ani është fjalë e shejtanit. Zoti ka reaguar dhe reagon duke thënë:

﴿٢٥﴾ وَمَا هُوَ بِقَوْلِ شَيْطَانٍ رَجِيمٍ

﴿٢٦﴾ فَأَيْنَ تَذْهَبُونَ

﴿٢٧﴾ إِنَّ هُوَ إِلَّا ذِكْرٌ لِلْعَالَمِينَ

﴿٢٨﴾ لِمَنْ شَاءَ مِنْكُمْ أَنْ يَسْتَقِيمَ

“Dhe ai (Kur’ani) nuk është thënie e djallit të mallkuar!

Pra, ku jeni, kah shkoni?

Ai (Kur’ani) s’është tjetër pos këshillë për njerëzit!

Për atë nga mesi juaj që dëshiron të gjendet në të vërtetën.” (Et-Tekvirë: 25-28)

Pra, Kur’ani nuk është fjalë e shejtanit i cili mundohet të përvjedhë fjalët, i cili (shejtani) është dëbuar dhe është gjuajtur me trupa qiellorë, është mallkuar, e kështu me radhë. Kjo nga shkakun se Kur’ani nuk është as poezi dhe as fall siç thonë kurejshitët.

Nuk është poezi as fall siç thonë ateistët.

Cilën rrugë e trasoni, kur nga të gjitha rrugët kjo është rruga më e qarta të cilën e kam qartësuar për ju!?

Po deri ku po shkojnë mendjet e juaja për të përgënjeshtuar këtë Kur’an, përderisa ju është sqaruar dhe ju është kristalizuar!?

Po deri ku po shkojnë mendjet e juaja për të përgënjeshtuar këtë Kur’an, përderisa ua kemi sqaruar se me të vërtetë është prej Allahut!?

Ky deklaram dhe ky qëndrim e ka kuptimin: Ku ka drejtim tjetër për ndokënd, përpos këtyre fakteve të ofruara?.

Ku ka cak tjetër për ndokënd, përpos këtyre fakteve të ofruara?.

Kur’ani është këshillë dhe mësim për gjithë njerëzimin.

Kur’ani është këshillë e cila ju bënë dobi dhe ju paralajmëron për atë që ju dëmton.

Ai njeri i cili dëshiron që të jetë në rrugë stabile, ai e gjen në këtë Kur’an.

Nuk ka udhëzim tjetër përpos Kur’anit.

Ai njeri i cili dëshiron besimin dhe devotshmërinë, ai e gjen në këtë Kur'an. Nuk ka udhëzim tjetër përpos Kur'anit.

Ai njeri i cili dëshiron të vërtetën, Ai i drejtohet Kur'anit dhe udhëzohet me të.

Nuk ka udhëzim tjetër përpos Kur'anit.

Në këtë rast fjala "Dhikr-këshillë" është infinitiv e që ka kuptimin e marrjes së këshillës prej Kur'anit.

Allahu i Madhërishëm e ka specifikuar çështjen e këshillës për atë i cili dëshiron, kjo për të nderuar, për t'i kushtuar vëmendje dhe për të sqaruar se përfiton ai i cili vepron me këshillat dhe është stabil.

Pastaj Zoti i madhërishëm thotë:

وَمَا تَشَاءُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٩﴾

"Po ju nuk mundeni, por vetëm nëse dëshiron All-llahu, Zoti i botëve!"
(Et-Tekvirë: 29)

Allahu i Madhërishëm sqaron për përfitimin e njeriut në mënyrë gjenerale, për përfitimin në rrugën e drejtë dhe për përfitimet tjera, të cilat janë krijesa (përfitime) prej krijesave të Allahut, dhe për vendosjen e besimit në gjoksin e njeriut dhe thotë: "Dhe nuk dëshirojnë...", pra nuk e dëshirojnë rrugën e drejtë, dhe nuk mund ta arrini atë përpos me vullnetin e Tij dhe me harmonizimin e Tij.

Vullneti Im nuk është imponim te ju. Atë që dëshiron Allahu e udhëzon, e kush dëshiron devijon, por e gjithë kjo është brenda kornizës së vullnetit të Allahut të Madhërishëm. Zotit të njerëzve dhe xhinëve dhe i gjithë botës.

Ne besojmë në Zotin me vullnetin e Tij.

Është transmetuar se kur ka zbritur ajeti **"Për atë i cili dëshiron nga ju drejtohet në rrugë të drejtë"**. (Et-Tekvirë: 28). Ebu Xhehli ka thënë: Kjo çështje është për ne, nëse dëshirojmë drejtohemi në rrugë të drejtë, nëse nuk dëshirojmë nuk drejtohemi në rrugë të drejtë, atëherë ka zbritur ajeti "Nuk dëshirojnë asgjë tjetër përpos asaj çka dëshiron Allahu".

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Tekvirë.

SURETU INFITARË

Suretu Infitarë

إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ ﴿١﴾ وَإِذَا الْكَوَاكِبُ انتَثَرَتْ ﴿٢﴾ وَإِذَا الْبِحَارُ فُجِّرَتْ ﴿٣﴾ وَإِذَا الْقُبُورُ
بُعْثِرَتْ ﴿٤﴾ عَلِمْتَ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ وَأَخَّرَتْ ﴿٥﴾ يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ مَا غَرَّكَ بِرَبِّكَ الْكَرِيمِ ﴿٦﴾
الَّذِي خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ فَعَدَلَكَ ﴿٧﴾ فِي أَيِّ صُورَةٍ مَّا شَاءَ رَكَّبَكَ ﴿٨﴾ كَلَّا بَلْ تُكَذِّبُونَ بِالذِّينِ
﴿٩﴾ وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ ﴿١٠﴾ كِرَامًا كَاتِبِينَ ﴿١١﴾ يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ ﴿١٢﴾ إِنَّ الْأَبْرَارَ
لَفِي نَعِيمٍ ﴿١٣﴾ وَإِنَّ الْفُجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ ﴿١٤﴾ يَصْلَوْنَهَا يَوْمَ الذِّينِ ﴿١٥﴾ وَمَا هُمْ عَنْهَا
بِعَائِبِينَ ﴿١٦﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الذِّينِ ﴿١٧﴾ ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الذِّينِ ﴿١٨﴾ يَوْمَ لَا تَمْلِكُ
نَفْسٌ لِّنَفْسٍ شَيْئًا وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ ﴿١٩﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِّيَذَكِّرَ بِآيَاتِهِ وَلِيَذَكِّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Infitarë e ka specifikën e vet. Të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Infitarë, që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Suret Mekase dallohen me atë se përbëhen prej ajeteve të shkurta.

Suret Mekase dallohen me atë se përshkruajnë ringjalljen dhe kataklizmën.

Sureja Nebeë përshkruan kataklizmën, përshkruan kijametin.

Sureja Infitarë sqaron për shenjat e kataklizmës:

﴿١﴾ إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ

﴿٢﴾ وَإِذَا الْكَوَاكِبُ انتَثَرَتْ

﴿٣﴾ وَإِذَا الْبِحَارُ فُجِّرَتْ

﴿٤﴾ وَإِذَا الْقُبُورُ بُعْثِرَتْ

“E kur të çahet qielli.

Dhe kur të shkapërderdhen yjet.

Dhe kur të përzihen detet.

Dhe kur të trazohen varret.” (*El-Infitarë: 1-4*)

Këto cilësi të ditës së gjykimit na i tregojnë Allahu dhe atë që prezanton njeriu të mirat apo të këqijat dhe për të cilat shpague.

Atëherë kur do të qahet qielli dhe do të ngrihet lartë.

Atëherë kur trupat qiellore bien e përplase dhe ndeshen.

Atëherë kur do të qahen brigjet (anët) e deteve dhe të gjitha bëhen një det (oqean). E, pastaj zjarri e përfshinë atë.

Këto janë shenjat e kataklizmës.

Ndërsa përgjigjja e kushtit është si në vijim:

﴿٥﴾ عَلِمَتْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ وَأَخَّرَتْ

“Atëbotë secili njeri e din se çka punuar dhe çka ka lënë prapa!” (*El-Infitarë: 5*)

Kur të ndodhin këto ngjarje, çdo njeri do ta kuptojë se çka ka vepruar, qoftë e mirë, qoftë keq.

Pasi të shpërndahen regjistrat. Atëherë njeriu do ta kuptojë edhe punët të cilat nuk i ka kryer për shkak të neglizhencës dhe të mosinteresimit për t'i kryer.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ مَا عَرَفَكَ رَبُّكَ الْكَرِيمُ ﴿٦﴾

“O ti njeri po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë?” (El-Infitarë: 6)

O ti njeri, i cili tani e kuptove përfundimin e botës, çka ishte ajo e cila të tradhtoi për ta kundërshtuar Zotin tënd?

O ti njeri, i cili tani e kuptove përfundimin e botës, çka ishte ajo e cila të tërhoqi për ta kundërshtuar Zotin tënd?

Çka të mashtroi për ta kundërshtuar Atë i Cili të ka krijuar me organet e shëndosha, të ka krijuar me pamje të bukur?

Çka të mashtroi për ta kundërshtuar Atë i Cili të ka krijuar me pamje të bukur?

Çka të mashtroi për ta kundërshtuar Atë i Cili të ka bërë të kompletuar, dhe çka i përshtatet natyrshmërisë tënde?

Nuk të ka munguar asgjë nga pjesët e trupit:

- të janë dhënë shqisat e dëgjimit dhe
- të është dhënë shqisa e shikimit,
- të është dhënë mendja (logjika), dituria dhe mundësia e të kuptuarit.

Shkaku i zbritjes së ajetit në “Çka të mashtroi?”.

Ka mendime se ka zbritur për Ubej bin Halefin.

Ka mendime se shkaku i zbritjes është për Velid bin Mugiren.

Pastaj Zoti i madhërishëm thotë:

الَّذِي خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ فَعَدَلَكَ ﴿٧﴾

فِي أَيِّ صُورَةٍ مَّا شَاءَ رَكَّبَكَ ﴿٨﴾

“I Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi.

Të formësoi në formën që Ai dëshiroi!” (El-Infitarë: 7, 8)

Allahu të ka strukturuar në formën siç ka dashur.

Allahu të ka krijuar në formën më të mirë dhe më të bukur.

Ti nuk e ke zgjedhur formën e vetes tënde.

Ti nuk e ke zgjedhur strukturën e vetes tënde.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

كَلَّا بَلْ تُكَذِّبُونَ بِالذِّينِ ﴿٩﴾

“Jo, nuk është ashtu. Ju përgënjeshtroi ditën e përgjegjesisë.” (*El-Infitarë: 9*)

Allahu reagon ndaj të gjitha thënieve të tyre, dhe i qorton duke ju thënë: Jo, kurrsesi, jo.

Pastaj e konfirmon përgënjeshttrimin e shpagimit.

Ky është referim gjeneral, por që ka kuptimin specifik për pabesimtarët.

O ju pabesimtarë, kthjelluni mos lejoni që të mashtroheni, kur dihet se Allahu është i Butë, Fisnik, mirëpo në fakt ju po e përgënjeshtroi ditën e kthimit te Zoti, ditën e llogaridhënies dhe ditën e shpagimit, sa që nuk brengoseni, nuk frikësoheni nga kjo ditë, ashtu që t'i zbatoni urdhëresat dhe të largoheni nga ndalesat.

Besimtarë të nderuar!

Pastaj, përsëri kërkon që ta lënë anash kokëfortësinë në mënyrën duke ju thënë: Të gjitha veprat e njerëzve janë të siguruara te melaqet.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَإِنَّ عَلَيْكُمْ لَحَافِظِينَ ﴿١٠﴾

كِرَامًا كَاتِبِينَ ﴿١١﴾

يَعْلَمُونَ مَا تَفْعَلُونَ ﴿١٢﴾

“Kurse ndaj jush janë përcjellësit!

Janë shkrues të ndershëm te All-llahu.

Ata e dinë se çka punoni.” (*El-Infitarë: 10-12*)

Për ju janë përcaktuar melaqet ruajtëse fisnike, mos i pritni me punë të këqija. Kjo nga shkakun se i shkruajnë dhe i regjistrojnë të gjitha veprat e juaja.

“Hafidhunë”: janë melaqet të cilat i shkruajnë dhe i regjistrojnë veprat e birit të Ademit.

Allahu i ka cilësuar me cilësinë fisnike e cila është e kundërta e cilësisë mallkuese.

Fjala: “E dinë se çka veproni” ka kuptimin se prezantojnë dhe e shohin gjendjen e njeriut.

Besimtarë të nderuar!

Njerëzit do të ndahen në dy kategori:

- Njerëz të mirë dhe
- Njerëz të këqij.

Sa i përket njerëzve të mirë Zoti Famëlartë thotë:

إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ﴿١٣﴾

“E s’ka dyshim se të mirët janë në kënaqësinë e përjetimeve (në Xhennet).” (*El-Infitarë: 13*)

Në ditën e gjykimit, si rezultat i shkrimit të veprave nga melaqet të veprave të njerëzve, njerëzit ndahen në dy grupe:

- Të mirët: janë ata të cilët e kanë respektuar Allahun Famëlartë, të cilët nuk kanë bërë mëkate do të shkojnë në vendin e begative në xhenet.

Sa i përket njerëzve të këqij Zoti Famëlartë thotë:

وَإِنَّ الْفُجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ ﴿١٤﴾

يَصْلَوْنَهَا يَوْمَ الدِّينِ ﴿١٥﴾

“Dhe se mëkatarët janë në Xhehenem.

Aty futen ata ditën e gjykimit (të cilën nuk e besonin).” (*El-Infitarë: 14, 15*)

- Të këqijtë: janë ata të cilët e kanë mohuar Allahun dhe të dërguarin e Tij, kanë bërë mëkate ndaj Zotit të tyre, ata do të hedhen në xhehenem, ku djeg zjarri, ku do të digjen në ditën e shpagimit dhe llogaridhënies, të cilën ditë e kanë përgënjeshtruar.

“Dhe nuk kanë të larguar prej tij.

Nuk largohen nga xhehenemi.

Nuk mungojnë asnjë çast nga dënimi i xhehenemit.

Nuk ju lehtësohet dënimi në xhehenem.

Ata do të qëndrojnë në të përgjithmonë”, siç figuron në ajetin tjetër

وَمَا هُمْ بِخَارِجِينَ مِنَ النَّارِ

“Nuk dalin nga aty”. (*El-Bekare: 167*)

Përfundim

Pjesa e dytë sqaron se në ditën e gjykimit askush askujt nuk mund t'i ndihmon.

وَمَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ﴿١٧﴾

ثُمَّ مَا أَدْرَاكَ مَا يَوْمَ الدِّينِ ﴿١٨﴾

يَوْمَ لَا تَمْلِكُ نَفْسٌ لِّنَفْسٍ شَيْئًا ۚ وَالْأَمْرُ يَوْمَئِذٍ لِلَّهِ ﴿١٩﴾

“E ç’të mësoi ty se ç’është dita e gjykimit?

Përsëri, ç’të mësoi ty se ç’është dita e gjykimit?

Është dita kur askush, askujt nuk do të mund t'i ndihmojë asgjë; atë ditë e tërë çështja i takon vetëm All-llahut!” (*El-Infitarë: 17-19*)

Allahu i Madhërishëm e përshkruan ditën e gjykimit tepër të tmerrshme duke rikonfirmuar dy herë ku thotë: **“Po çka di ti për ditën e gjykimit”**. Pra, kush ta ka mësuar se çka është dita e shpagimit dhe e llogaridhënies.

Fjalja është përsëritur për të treguar rëndësinë e ditës së gjykimit.

Fjalja është përsëritur për të treguar madhësitinë e çështjes së saj, gjë që duhet kushtuar kujdes dhe vëmendje.

Allahu i Madhërishëm, merr vendim të prerë në çështjen e njeriut në ditën e gjykimit ku thotë: **“Dita kur njeriu nuk posedon asgjë”**.

Është dita kur askush nuk mund të bëjë asgjë kushdo qoftë, nuk mund të bënë dobi askush.

Nuk mund të shpëton askush prej aty, përpos me lejen e Allahut për atë me të cilën dëshiron dhe është i kënaqur.

Askush nuk mund të bënë asgjë përpos Allahut Zotit të gjithë botëve.

Allahu është i Vetmi Sundimtarë dhe Gjykatës. Në dorën dhe në kompetencën e Tij është çdo gjë. Çdo gjë kthehet tek Ai.

Çështja se ajo ditë është dita e Allahut ngase atë ditë askush nuk mund të ndërhyjë për asgjë. Askush nuk mund të bën asgjë, ashtu siç ka vepruar në këtë botë.

Kjo informatë e Allahut tregon për dobësinë e njerëzve në atë ditë dhe se askush nuk është i varur për askënd dhe se çështja i takon vetëm Allahut.

Kjo është kundërpërgjigje ndaj atyre të cilët pretendojnë se: ndonjëri prej pejgamberëve e merr përsipër çështjen e llogaridhënies dhe të gjykimit, dhe ai pejgamber cilin do e vendos në xhenet, cilin do në xhehenem.

Ky pretendim është ekstrem naiv e cila është në kundërshtim me realitetin dhe me logjikën.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Infitarë.

SURETU MUTAFFIFINË (1)

Suretu Mutaaffifinë: 1-17

وَيْلٌ لِّلْمُطَفِّفِينَ ﴿١﴾ الَّذِينَ إِذَا اكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ ﴿٢﴾ وَإِذَا كَالُوهُمْ أَوْ وَزَنُوهُمْ يُخْسِرُونَ ﴿٣﴾ أَلَا يَظُنُّ أُولَئِكَ أَنَّهُمْ مَبْعُوثُونَ ﴿٤﴾ لِيَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿٥﴾ يَوْمَ يَقُومُ النَّاسُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٦﴾ كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْفُجَارِ لَفِي سِجِّينٍ ﴿٧﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا سِجِّينٌ ﴿٨﴾ كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ﴿٩﴾ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ ﴿١٠﴾ الَّذِينَ يُكَذِّبُونَ يَوْمَ الدِّينِ ﴿١١﴾ وَمَا يُكَذِّبُ بِهِ إِلَّا كُلُّ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ ﴿١٢﴾ إِذَا تُتْلَى عَلَيْهِ آيَاتُنَا قَالَ أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿١٣﴾ كَلَّا بَلْ رَانَ عَلَى قُلُوبِهِمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿١٤﴾ كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَمَحْجُوبُونَ ﴿١٥﴾ ثُمَّ إِنَّهُمْ لَصَالُو الْجَحِيمِ ﴿١٦﴾ ثُمَّ يُقَالُ هَذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ تُكَذِّبُونَ ﴿١٧﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِّيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Mutaaffifinë e ka specifikën e vet, të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Mutaaffifinë, që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Besimtarë të nderuar!

Kur ka shkuar peygamberi a.s. në Medine ka vërejtur se tregtarët bënin matje të mëngët ashtu sikurse sot tregtarët bëjnë mashtrime në tregti.

Kur ka shkuar peygamberi a.s. në Medine, ka vërejtur se tregtarët mashtronin gjatë tregtisë ashtu sikurse sot kompanitë tregtare bëjnë mashtrime në tregti, atëherë, Allahu i ka zbritur ajetet:

وَيْلٌ لِّلْمُطَفِّفِينَ ﴿١﴾

الَّذِينَ إِذَا أَكْتَالُوا عَلَى النَّاسِ يَسْتَوْفُونَ ﴿٢﴾

وَإِذَا كَالُوهُمْ أَوْ وَزَنُوهُمْ يُخْسِرُونَ ﴿٣﴾

“Të mjerët ata që masin e peshojnë.

Ata që kur matin prej njerëzve prej njerëzve, për vete e plotësojnë,

E kur u matin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangu.” (El-Mutaffifin: 1-3)

Pastaj kanë filluar të zhvillonin tregti të drejtë dhe të sinqertë.

“Mjerë për tregtarët (dhe klientët) mashtrues”.

U shkatërrofshin, u dënoshin, qofshin fatkeq dhe gjithmonë të pikëlluar.

“Mutaffifinët” të cilët pakësojnë, kur duhet të jenë të drejtë, por edhe kur ana e kundërt kërkon me ngulm më shumë kur nuk e ka atë të drejtë.

Ata të cilët për vete e realizojnë të drejtën e plotë, ndërsa të tjerëve ua shkelin të drejtën.

- kur është në pyetje matja për veten e tyre, e realizojnë matjen e saktë. Ose kur masin për të tjerët e pakësojnë masën dhe vagën.

- kur masin për të tjerët, ata marrin për vete më shumë.

Kjo është në kundërshtim me drejtësinë dhe me barazinë.

Allahu i Madhërishëm ka urdhëruar që të nivelizohet matja në vagë.

Allahu i Madhërishëm ka urdhëruar që të nivelizohet matja në masë.

Kjo nga shkaku se të vepruarit me drejtësi dhe të përmbushjes së premtimit, pa shtuar diçka dhe pa pakësuar diçka është drejtësi, ndërsa

me të vepruarin e kundërt është shkelje e të drejtës së të tjerëve.

Kush vepron ashtu duhet bë pendim të menjëhershëm.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

أَلَا يَظُنُّ أُولَٰئِكَ أَنَّهُمْ مَبْعُوثُونَ ﴿٤﴾

لِيَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿٥﴾

يَوْمَ يَقُومُ النَّاسُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٦﴾

“A nuk e dinë të tillët se kanë për t’u ringjallur?

Në një ditë të madhe.

Në ditën kur njerëzit ngrihen (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve.” (El-Mutaffifinë: 4-6)

Allahu i paralajmëron mutaffifinët, ashtu që thotë: Ata “Mutaffifinë” a nuk po e dinë se do të ringjalljen në ditën e tmerrit, e ajo ditë është dita ku do të pyeten për atë që kanë vepruar?

Ata “Mutaffifinë” a nuk po e dinë se do të ringjalljen në ditën e frikës, e ajo ditë është dita e gjykimit, ku do të pyeten për atë që kanë vepruar.

Ata “Mutaffifinë” a nuk po e dinë se do të ringjalljen në ditën e trishtimit, e ajo ditë është dita e gjykimit, ku do të pyeten për atë që kanë vepruar.

Është dita kur njerëzit do të ngrihen nga varret të gjallë, e pastaj do të qëndrojnë para Zotit të tyre për t’u gjykuar dhe për të marrë shpagimin e tyre.

Njerëzit do të konfrontohen në bazë të pozitave të tyre.

Kohëzgjatja e konfrontimit do të jetë nga:

- 40 vite deri në 100 vite,
- ose 40 vite deri në 300 vite,
- ose 40 vite deri në 50.000 vite, e kështu me radhë.

Secili njeri do të qëndron varësisht prej gjendjes së tij dhe vështirësisë së çështjes së tij.

Sa i përket besimtarit:

Ai do të qëndron: aq sa është perioda kohore në mes drekës dhe të ikindisë.

Për disa njerëz sa zgjatë falja e namazit farz.

Po ashtu, sa i përket djersitjes së tyre, ndryshon varësisht prej gjendjes së njeriut:

- Ndonjëri zhytet i tëri në djersët e tij;
- Ndonjëri deri në gjunjë;
- Ndonjëri deri mbi gjunjë;

- Ndonjëri deri nën gjunjë.

Besimtarë të nderuar!

Në vazhdim Zoti i Madhërishëm thotë:

“Jo, kurrsesi, jo”, kjo është shprehje paraqet poshtërim.

Kjo shprehje paraqet gjendjen për veprimet e mashtrimit në tregti dhe për përgënjeshttrimin. E që nuk duhet të jetë ashtu.

Në vazhdim Zoti i Madhërishëm tregon për regjistrin e të këqijve ku thotë:

﴿٧﴾ كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْفُجَّارِ لَفِي سِجِّينَ

﴿٨﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا سِجِّينَ

﴿٩﴾ كِتَابٌ مَرْقُومٌ

﴿١٠﴾ وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِلْمُكَذِّبِينَ

﴿١١﴾ الَّذِينَ يُكَذِّبُونَ يَوْمَ الدِّينِ

“Jo, të mos rrinë gafil! Se shënimet e veprave të mëkatarëve janë në Sixhin.

E, ku e di ti se ç’është sixhini?

Ai është një libër i qëndisur.

Atë ditë është shkatërrimi për gënjeshtarët.

Të cilët nuk e besojnë ditën e përgjegjësisë.” (El-Mutaffifinë: 7-11)

O ju mizorë hiqni dorë nga mashtrimi tregtarë dhe nga indiferenca për ringjallje.

O ju të padrejtë, hiqni dorë nga mashtrimi tregtarë dhe nga indiferenca për llogaridhënie.

Kjo sepse disa prej të padrejtëve mashtrues tregtarë, veprat e tyre i kanë të regjistruara në regjistrat e përcaktuara për të keqen, e ato regjistra quhen: Sixhinë, me fjalë tjera: Dosja e mbyllur.

Kjo sepse disa prej të padrejtëve mashtrues tregtarë, veprat e tyre i kanë të regjistruara në regjistrat e banorëve të xhehenemit, e ato regjistra quhen: Sixhinë, me fjalë tjera: Dosja e mbyllur.

Sixhini është libri i cili i ka të regjistruar emrat e tyre.

Sixhini është libër i cili ka të shkruar shkresat e të gjitha veprave të këqija.

Sixhini është libër i cili ka të shkruar veprat e rezultuara nga shejtanët, pabesimtarët dhe mëkatarët.

Ky regjistër është i madh, apo libri kryesor i cili ka të regjistruara të gjitha fletushkat e secilit mëkatarë.

Në vazhdim Zoti i Madhërishëm thotë:

وَمَا يُكَذِّبُ بِهِ إِلَّا كُلُّ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ ﴿١٢﴾

إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِ آيَاتُنَا قَالَ أَسَاطِيرُ الْأَوَّلِينَ ﴿١٣﴾

“E atë ditë nuk e mohon kush, përveç atij që ka sharruar tepër në mosbesim e në punë të këqija.

E që kur i lexohen atij argumentet Tona, thonë: “Legjenda të të parëve!” (*El-Mutaffifinë: 12, 13*)

Në ditën e gjykimit do të jetë dënim i ashpër për ata të cilët e përgënjeshtrojnë ringjalljen, apo shpagimin pas ringjalljes dhe të cilët përgënjeshtrojnë mesazhet e peygamberëve. Ata përgënjeshtrojnë nuk besojnë se do të ndodhë shpagimi, nuk besojnë në ditën e gjykimit, një ngjarje të tillë e konsiderojnë absurditet.

Përgënjeshtroresit e ditës së gjykimit i posedojnë tri cilësi:

- Ata janë sulmues, kriminelë që i tejkalojnë kufijtë e rrugës së drejtë.
- Ata bëjnë shumë mëkate, ata janë insistues të veprave që çojnë në mëkate.
- Kur u lexohet atyre Kur’ani thonë: këto janë anekdota, legjenda të popujve të mëhershëm dhe përralla të shpikura prej tyre, e që Muhamedi i ka përvetësuar dhe i ka marrë prej atyre të gatshme.

Pastaj Zoti i madhërishëm thotë:

كَلَّا بَلْ رَانَ عَلَىٰ قُلُوبِهِم مَّا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿١٤﴾

كَلَّا إِنَّهُمْ عَنْ رَبِّهِمْ يَوْمَئِذٍ لَّمَّحْجُوبُونَ ﴿١٥﴾

ثُمَّ إِنَّهُمْ لَصَالُوا الْجَحِيمِ ﴿١٦﴾

ثُمَّ يُقَالُ هَذَا الَّذِي كُنْتُمْ بِهِ تُكَذِّبُونَ ﴿١٧﴾

“Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që i punuan, zemrat e tyre ua mbuluan.

Jo dhe Jo! Atë ditë do të jenë të penguar prej (ta shohin) Zotit të tyre. Pastaj ata do të hyjnë në Xhehennem.

Dhe do t'u thuhet: “Ky është ai të cilin e keni përgënjeshtruar!” (*El-Mutaffifin: 14-17*)

Shkaku se kanë shpifur për Kur'anin ka qenë dashur të përdoret shprehja mohuese qortuese: “Jo, kurrësi jo”, që nënkupton: Hiqni dorë, tërhiquni nga kjo shprehje, sepse nuk është çështja siç mendoni o ju mëkatarë të cilët keni kaluar çdo kufij. Nuk është ashtu siç thoni ju, por është fjalë e Allahut, shpallje e Tij e cila i është zbritur pejgamberit fisnik.

Shkak i shpifjeve të tyre është se:

- ata kanë bërë mëkate dhe gabime të cilat ua kanë mbyllur zemrat për të mos besuar në Zot dhe Kur'an.

Zemrat e tyre janë mbyllur prej Allahut, ata janë të penguar që ta veprojnë të drejtën, të vërtetën dhe të veprojnë me dritën e Allahut.

Ata janë të verbër, nuk e shohin të vërtetën.

Përpos kësaj, ata do të jenë të mbuluar për të mos e parë Allahun e Madhërishëm në ditën e gjykimit.

Nuk mund ta shohin ashtu siç e shohin besimtarët.

Në mënyrë përbuzëse nëpërmjet rojeve të xhehenemit do të ju thuhet: Ky është ai dënim të cilin e keni përgënjeshtruar në dunja, andaj shiheni dhe vuajeni.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Mutaffifinë.

SURETU MUTAFFIFINË (2)

Suretu Mutaaffifinë: 18-36

كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْأَبْرَارِ لَفِي عِلِّيْنَ ﴿١٨﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا عِلِّيُونَ ﴿١٩﴾ كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ﴿٢٠﴾ يَشْهَدُهُ الْمُقَرَّبُونَ ﴿٢١﴾ إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ﴿٢٢﴾ عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ ﴿٢٣﴾ تَعْرِفُ فِي وُجُوهِهِمْ نَضْرَةَ النَّعِيمِ ﴿٢٤﴾ يُسْقَوْنَ مِنْ رَحِيقٍ مَخْتُومٍ ﴿٢٥﴾ خِتَامُهُ مِسْكٌ ﴿٢٦﴾ فِي ذَلِكَ فَلْيَتَنَافَسِ الْمُتَنَافِسُونَ ﴿٢٧﴾ وَمِزَاجُهُ مِنَ التَّسْنِيمِ ﴿٢٨﴾ عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا الْمُقَرَّبُونَ ﴿٢٩﴾ إِنَّ الَّذِينَ أَجْرَمُوا كَانُوا مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا يَضْحَكُونَ ﴿٣٠﴾ وَإِذَا مَرُّوا بِهِمْ يَتَغَامَزُونَ ﴿٣١﴾ وَإِذَا انْقَلَبُوا إِلَى أَهْلِهِمْ انْقَلَبُوا فَكِهِينَ ﴿٣٢﴾ وَإِذَا رَأَوْهُمْ قَالُوا إِنَّ هَؤُلَاءِ لَضَالُونَ ﴿٣٣﴾ وَمَا أُرْسِلُوا عَلَيْهِمْ حَافِظِينَ ﴿٣٤﴾ فَالْيَوْمَ الَّذِينَ آمَنُوا مِنَ الْكُفَّارِ يَضْحَكُونَ ﴿٣٥﴾ عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ ﴿٣٦﴾ هَلْ نُؤَبِّئُ الْكُفَّارَ مَا كَانَوْا يَفْعَلُونَ ﴿٣٧﴾

Zoti i Madhërishëm në këtë pjesë të sures Mutaaffifinë tregon për suksesin dhe shpëtimin e të mirëve.

Zoti i Madhërishëm në këtë pjesë të sures Mutaaffifinë tregon për regjistrin e të mirave.

Ai regjistër është i madh, në të janë të regjistruar veprat e të mirëve dhe të ndershmëve.

Pjesëtarët e veprave të mira janë në xhenet, i përjetojnë llojet e kënaqësive materiale dhe shpirtërore.

Kjo vërehet qartë në ajetet në vijim:

كَلَّا إِنَّ كِتَابَ الْأَبْرَارِ لَفِي عِلِّيْنَ ﴿١٨﴾

وَمَا أَدْرَاكَ مَا عِلِّيُونَ ﴿١٩﴾

كِتَابٌ مَّرْقُومٌ ﴿٢٠﴾

يَشْهَدُهُ الْمُقَرَّبُونَ ﴿٢١﴾

“Jo, nuk janë të njëjtë! Se libri i të mirave gjendet në Il-lijinë!

E ku e di ti se çka është Iljunë?

Është një libër i qëndisur qartë.

Të cilin e dëshmojnë engjëjt që janë më të afërmit.” (*El-Mutaffifinë: 18-21*)

Besimtarët e veprave të mira në botën tjetër do të hakmerren duke u tallur me pabesimtarët të cilët janë tallur me ta në botën e dunjasë.

O ju pabesimtarë, nuk keni çka t'i shikoni të mirët. Regjistri i të mirëve - ata janë besimtarët e sinqertë të cilët kanë vepruar vepra të mira - veprat e të cilëve janë në regjistrin e madh të destinuar për ta, i cili gjendet në një vend të lartë.

O Muhamed, çka di ti për çështjen “ilijun”?

(Përgjigja:)

Ajo është çështje madhështore.

Ai është libri i regjistrit.

Në atë libër, në atë regjistër janë të regjistruara emrat e tyre dhe të veprave të tyre.

Ai libër është regjistër i madh, të cilin e kanë arkivuar dhe të cilën e prezantojnë melaqet, ashtu siç ruhen në Levhi Mahfudhë.

Ai libër është regjistër i madh, të cilin e kanë siguruar në Levhi Mahfudhë.

Vëllezër të nderuar!

Në vazhdim Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ ﴿٢٢﴾

عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ ﴿٢٣﴾

تَعْرِفُ فِي وُجُوهِهِمْ نَضْرَةَ النَّعِيمِ ﴿٢٤﴾

“E s’ka dyshim se vepërmirët janë në përjetime e kënaqësi (Xhennet).

Të mbështetur në kolltukë vështrojnë.

Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë e përjetimeve.” (*El-Mutaffifinë: 22-24*)

Në ditën e gjykimit, të dëgjueshmit dhe besimtarët do të përjetojnë kënaqësi të mëdha.

Ata do të banojnë në xhenetet e përgjithmonshme, do të jenë të edukuar dhe të kujdesshëm dhe të lumtur shohin atë që Allahu ka përgatitur për ta, nga llojet e të mirave në xhenet, dhe për përjetimin e kënaqësive të tyre materiale dhe shpirtërore.

Po t'i shihje ata, do t'i identifikojë nga gjurmët e mirësive dhe të komoditetit, nga lumturia e tyre nga fytyrat e tyre të cilat shkëlqejnë me dritën e tyre, me mirësinë e tyre dhe me bardhësinë e tyre.

Vëllezër të nderuar!

Në ditën e gjykimit, të dëgjueshmit dhe besimtarët do të përjetojnë kënaqësi të mëdha ku Zoti i madhërishëm thotë:

يُسْقَوْنَ مِنْ رَحِيقٍ مَخْتُومٍ ﴿٢٥﴾

حَتَّامُهُ مِسْكَ ۚ وَفِي ذَلِكَ فَلْيَتَنَافَسِ الْمُتَنَافِسُونَ ﴿٢٦﴾

وَمَزَاجُهُ مِنْ تَسْنِيمٍ ﴿٢٧﴾

عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا الْمُقَرَّبُونَ ﴿٢٨﴾

“U jepet të pinë pije në enë të mbyllura.

Pije që në fund asaj i vjen era misk! E për shpërblim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën.

Dhe përzierja e asaj pije është në tensim (uji më i mirë).

Krua nga i cili do të pinë më të afërmit e Zotit.” (*El-Mutaffifinë: 25-28*)

Shërbehen me pije alkoolike, e cila pije nuk ndikon në humbje vetëdije apo shkaktim trazire.

Enët dhe gotat janë të mbyllura me aromën e miskut,

i përdorin vetëm të mirët,

në fund të ushqimit ndihet erë misku.

Këtë duhet lakmuar çdo njeri, për këtë duhet garuar pra për devotshmëri ndaj Allahut duke i zbatuar urdhrat dhe duke u larguar nga ndalesat.

Ato pije përzihen me ujin i cili quhet “Tesnimë”, i cili ka vlerë të madhe dhe i vendosur në vend të çmuar. Atë e konsumojnë të mirët e afërt me Allahun, përgatitet posaçërisht për ata të cilët i marrin librat në anën e djathtë.

“Të afërmit”: janë melaqet të cilat janë afër Allahut, dhe banorët e secilit qiell.

Vëllezër të nderuar!

Allahu i Madhërishëm i ka cilësuar idhujtarët me katër cilësi, e ata janë idhujtarët si Ebi Xhehli, Velid bin el Mugire...

Idhujtarët talleshin me Amarin, Suhejbin, Bilallin dhe me muslimanët e varfër të tjerë.

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ الَّذِينَ أَجْرَمُوا كَانُوا مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا يَضْحَكُونَ ﴿٢٩﴾

وَإِذَا مَرُّوا بِهِمْ يَتَغَامَزُونَ ﴿٣٠﴾

“Mëkatarët ishin ata të cilët i përqeshnin ata që besuan.

Dhe kur kalonin (besimtarët) pranë (idhujtarëve), ata ia bënin me sy njëri-tjetrit.” (El-Mutaffifinë: 29, 30)

Ato cilësi janë:

Idhujtarët kurejshit talleshin me besimtarët,

Pabesimtarët i nënçmonin dhe i merrnin besimtarët si objekt talljeje.

Pabesimtarët kur kalonin pranë besimtarëve i përqeshnin, i etiketonin me Islamin dhe ua bënin me sy për të keq, i ofendonin.

Shkaku i zbritjes së ajeteve:

Kjo ngjarje ka zbritur për një tufë kurejshitësh, dhe për të dobëtit muslimanë.

Ose, Kjo ngjarje ka zbritur për Alijun dhe të një pjese të besimtarëve të cilët kur kishin kaluar pranë pabesimtarëve Mekas, atëherë pabesimtarët i kanë përqeshë besimtarët, i ofendonin me pretendimin e tyre se janë të cekët në mendje. Për këtë shkak ka zbritur ky ajet.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَإِذَا انْقَلَبُوا إِلَىٰ أَهْلِهِمْ انْقَلَبُوا فَكِهِينَ ﴿٣١﴾

وَإِذَا رَأَوْهُمْ قَالُوا إِنَّ هَٰؤُلَاءِ لَضَالُّونَ ﴿٣٢﴾

وَمَا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ حَافِظِينَ ﴿٣٣﴾

“E kur ktheheshin te familjet e veta, ktheheshin të kënaqur.

Dhe kur i shihnin ata (besimtarët) janë të humbur!”

Po Ne, nuk i caktuam ata (idhujtarët) si rojë të atyre (besimtarëve).”

(El-Mutaffifinë: 31-33)

Kështu pra prej cilësive të tyre janë se:

- Pabesimtarët kur ktheheshin në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre, nga qëndrimi i tyre në treg, ktheheshin të habitur me gjendjen e tyre, tregonin se si i kanë ofenduar dhe si janë tallur me ta.

- Pabesimtarët kur ktheheshin në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre, nga qëndrimi i tyre në treg, ktheheshin, tregonin se si i kanë ngacmuar besimtarët, se si janë tallur me ta.

- Pabesimtarët kur kthehen në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre, nga qëndrimi i tyre në treg, tregonin se si i kanë ngacmuar besimtarët, se si i kanë ofenduar dhe si janë tallur me ta.

- Idhujtarët, kur i shihnin besimtarët, i cilësonin si të devijuar. Kjo nga shkak se nuk ishin në fenë e tyre dhe në besimin e tyre të trashëguar dhe për shkak se e pasonin Muhamedin, dhe se i përmbaheshin mesazhit të tij, dhe për shkak të kërimit të shpërblimeve largoheshin nga shumë dëfrime ndërsa nuk dihej se a ka zot apo jo (kjo është ideja e tyre).

Për këtë arsye Allahu i Madhërishëm u është kundërpërgjigjur qëndrimeve të tyre se: Allahu nuk i ka dërguar ata kriminelë për të qenë monitorues për besimtarët, ashtu që t'i shikojnë gjendjet e tyre dhe t'i ruajnë fjalët dhe veprat e tyre.

Allahu i Madhërishëm u është kundërpërgjigjur qëndrimeve të tyre se: Ata nuk ishin të ngarkuar t'i përcillnin besimtarët. Por janë të obliguar t'i shikojnë çështjet e vetes së tyre.

Në vazhdim Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٣٤﴾ فَالْيَوْمَ الَّذِينَ آمَنُوا مِنَ الْكُفَّارِ يَضْحَكُونَ

“E sot, (në ditën e gjykimit), ata që besuan do të tallen me jobesimtarët.” (El-Mutaffifinë: 34)

Për t’u realizuar hakmarrja e të vepruarit me ta në të njëjtën mënyrë atëherë në ditën e gjykimit, besimtarët do të qeshin apo do të tallen kur t’i shohin pabesimtarët të poshtëruar dhe të përbuzur.

Kur të shohin se janë dënuar. Do të qeshin me ta në botën tjetër ashtu siç kanë qeshur ata në dunja. Saktësisht zbatohet parimi i reciprocitetit.

Në anën tjetër sqarohet se, pabesimtarët mohues janë mendjelehtë, të cilët e kanë humbur këtë botë dhe botën tjetër.

Në anën tjetër sqarohet se, pabesimtarët mohues janë iluzionista, të cilët e kanë humbur këtë botë dhe botën tjetër.

Përfundim

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

﴿٣٥﴾ عَلَى الْأَرَائِكِ يَنْظُرُونَ

﴿٣٦﴾ هَلْ تُؤْتِبُ الْكُفَّارُ مَا كَانُوا يَفْعَلُونَ

“Duke qëndruar të mbështetur (besimtarët) në kolltukë e duke shikuar.

A thua a u shpërblyen jobesimtarët për atë që punuan? (Po.)” (El-Mutaffifinë: 35, 36)

Besimtarët i shohin armiqtë e Allahut derisa ata dënohen me zjarr.

Besimtarët kënaqen në kolltukë, dhe ajo gjendje do të zgjatë përgjithmonë. Nuk krahasohet asgjë me këtë botë të përkohshme.

Parashtrohet pyetja:

Pabesimtarët a e kanë marrë trajtimin e njëjtë siç i trajtonin besimtarët apo jo?

Pabesimtarët a e kanë marrë trajtimin ashtu siç talleshin apo jo?

Pabesimtarët a e kanë marrë trajtimin, siç i ofendonin, apo jo?

(Përgjigjja) Natyrisht se po.

Pabesimtarët e kanë marrë dënimin e merituar, sepse atë që e kanë vepruar në dunja me besimtarët, duke u tallë me ta në dunja, ashtu ju ka ndodhur atyre në botën tjetër.

Kjo është deklaratë e Muhamedit a.s. dhe i umetit të tij.

Ky është qëndrimi i Muhamedit a.s. dhe i umetit të tij.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Mutaffifinë.

SURETU INSHIKAKË (1)

Suretu Inshikakë: 1-15

إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ ﴿١﴾ وَأَذْنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ﴿٢﴾ وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ ﴿٣﴾ وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ ﴿٤﴾ وَأَذْنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ﴿٥﴾ يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ كَدْحًا فَمُلَاقِيهِ ﴿٦﴾ فَأَمَّا مَنْ أُوْتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ ﴿٧﴾ فَسَوْفَ يُحَاسَبُ حِسَابًا يَسِيرًا ﴿٨﴾ وَنِقْلِبُ إِلَىٰ أَهْلِهِ مَسْرُورًا ﴿٩﴾ وَأَمَّا مَنْ أُوْتِيَ كِتَابَهُ وَرَاءَ ظَهْرِهِ ﴿١٠﴾ فَسَوْفَ يَدْعُو ثُبُورًا ﴿١١﴾ وَيَصْلَىٰ سَعِيرًا ﴿١٢﴾ إِنَّهُ كَانَ فِي أَهْلِهِ مَسْرُورًا ﴿١٣﴾ إِنَّهُ ظَنَّ أَن لَّنْ يَحُورَ ﴿١٤﴾ بَلَىٰ إِنَّ رَبَّهُ كَانَ بِهِ بَصِيرًا ﴿١٥﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِّيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Inshikakë e ka specifikën e vet, të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Inshikakë që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Suret Mekase dallohen me atë se përbëhen prej ajeteve të shkurta.

Suret Mekase dallohen me atë se përshkruajnë ringjalljen dhe kataklizmën.

Sureja Nebeë përshkruan kataklizmën, përshkruan kijametin.

Surja Inshikakë:

- Tregon për kataklizmën.
- Tregon për gjendjen e njerëzve në atë ditë.

Në atë ditë njerëzit ndahen në dy grupe:

- Pjesëtarët e të djathtës dhe
- Pjesëtarët e të majtës.

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِذَا السَّمَاءُ انشَقَّتْ ﴿١﴾

وَأُذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ﴿٢﴾

“Kur të pëlçet qielli.

T’i bindet urdhrit të Zotit të vet, ashtu si takoi.” (El-Inshikakë: 1, 2)

Agonitë e kataklizmës shkaktojnë frikë dhe trishtim.

Atëherë kur qielli do të ngrihet dhe do të qahet.

Do të qahet qielli kur do t’i jepet leja për t’u shkatërruar bota.

Qielli e dëgjon Zotin e saj.

Qielli e zbaton atë që i urdhërohet dhe atë që i ndalohet.

Obligim i saj është të dëgjon urdhrat e Zotit të saj, të dëgjon dhe të bindet.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَإِذَا الْأَرْضُ مُدَّتْ ﴿٣﴾

“Dhe kur toka të shtrihet në gjerësinë e saj.” (El-Inshikakë: 3)

- Atëherë kur toka të rrafshohet dhe të nivelizohet dhe zgjerohet pasi t’u hiqen malet dhe kodrat,

وَأَلْقَتْ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتْ ﴿٤﴾

“E të nxjerr çka ka brenda e të çlirohet,” (El-Inshikakë: 4)

kur flet

kur i nxjerrë nga brendia e saj të vdekurit,

kur i nxjerrë stolitë,

kur i qet të gjitha çka ka mbi sipërfaqe,

kur çlirohet në tërësi nga brendia, dhe nuk mbetet asgjë nën brendinë e saj.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَأُذِنَتْ لِرَبِّهَا وَحُقَّتْ ﴿٥﴾

“Dhe t’i bindet Zotit të saj, ashtu si takoi.” (El-Inshikakë: 5)

Toka i ka dëgjuar dhe i ka zbatuar urdhrat dhe ndalesat.

Obligim i tokës është që të dëgjon dhe të kryen detyrën që Allahu dëshiron prej saj. Kjo ngase ajo është nën fuqinë e Zotit.

Kështu që përcaktohet:

“Kur të ndodhë ajo çka ka ndodhë do t’i shihni veprat e juaja, qofshin të mira, qofshin të këqija”.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ كَدْحًا فَمُلَاقِيهِ ﴿٦﴾

“O ti njeri, vërtet t’i përpiqesh me një përpjekje të madhe që çon te Zoti yt, e atë (përpjekje) do ta gjesh.” (El-Inshikakë: 6)

Ajetet tregojnë dobësinë e njeriut,

paaftësinë e njeriut për t’u ballafaquar me rreziqet e asaj dite.

Në atë ditë nuk bënë dobi asgjë përpos besimit dhe veprave të mira.

Në njërën anë:

- Të dëgjueshmit i sheh në gëzimin më të madh.
- Të devotshmit i sheh në lumturinë më të madhe.
- Besimtarët i sheh në kënaqësinë më të madhe.

Në anën tjetër:

- Të padëgjueshmit i sheh në gjendje të mjerueshme, në gjendje katastrofike duke pritur dënimin e vazhdueshëm,

- pabesimtarët i sheh në gjendje të mjerueshme, duke pritur dënimin e vazhdueshëm.

- Mëkatarët i sheh në një gjendje katastrofike duke e pritur dënimin e vazhdueshëm.

Kështu pra,

O njeri, në këtë botë ti angazhohesh dhe e punon me zell punën tënde, punon me seriozitet dhe me forcë, që ta takosh Zotin tënd dhe të takohesh me veprat e tua qofshin të mira, qofshin të këqija.

O njeri, në këtë botë ti vepron, angazhohesh me seriozitet dhe me forcë, që ta takosh Zotin tënd dhe të takohesh me veprat e tua qofshin të mira, qofshin të këqija.

O njeri, në këtë botë ti e punon me zell punën tënde, punon me seriozitet dhe me forcë, që ta takosh Zotin tënd dhe të takohesh me veprat e tua qofshin të mira, qofshin të këqija.

Fjala “Do ta takosh Atë”: Do ta takosh Allahun Famëlartë.

Besimtarë të nderuar!

Në pjesën e dytë sureja Inshikak tregon për gjendjen e njerëzve në atë ditë. Allahu i Madhërishëm tregon për gjendjen e njerëzve në ditën e gjykimit

﴿فَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ بِيَمِينِهِ﴾ ﴿٧﴾

﴿فَسَوْفَ يُحَاسَبُ حِسَابًا يَسِيرًا﴾ ﴿٨﴾

“E përsa i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta,

Ai do të llogaritet me një llogari të lehtë,” (El-Inshikakë: 7, 8)

Allahu i Madhërishëm tregon për gjendjen e njerëzve në ditën e gjykimit dhe ndarjen e tyre në dy grupe:

Grupi i parë: Grupi i besimtarëve.

Grupi i dytë: Grupi i pabesimtarëve.

Grupi i parë: Besimtarëve të cilit u jepet libri i veprave në dorën e djathtë, ata janë besimtarët, ata do të gjykojnë lehtësisht.

Ashtu që i paraqiten të këqijat e tij, pastaj i falen dhe i fshihen pa hy thellë në llogaridhënie. Kjo është: llogaridhënia e lehtë.

Kjo duke u bazuar në thënien e Pejgamberit a.s.: **“Kujt i kërkohet llogaridhënia do të dënohet”**.

Pastaj Aishja e ka pyetur pejgamberin a.s.: “Po, a nuk ka thënë Allahu”. **“Atij do t’i kërkohet llogaria, dhe do të jep llogaridhënie të lehtë”**. (El-Inshikakë: 8)

Pejgamberi a.s. i ka thënë: **“Ajo nuk është kërkim llogaridhënie, mirëpo, ajo është vetëm paraqitje për llogaridhënie”**, ndërsa në ditën e gjykimit kur i kërkohet të sqarohet për veprat, ai do të dënohet.

Zoti i madhërishëm thotë:

﴿وَيُنْقَلِبُ إِلَىٰ أَهْلِهِ مَسْرُورًا﴾ ﴿٩﴾

“Do të kthehet te familja e vet i gëzuar.” (El-Inshikakë: 9)

Kjo është ajo që quhet llogaridhënia e lehtë, pra vetëm paraqitje për llogaridhënie dhe pastaj kthehet te familja dhe te farefisi në xhenet.

Kthehet te familja i gëzuar, nga ajo që i ka dhënë Allahu.

Kthehet te farefisi i lumtur për të mirat që ia ka dhënë Allahu.

Kthehet i gëzuar dhe i lumtur për shkak të nderimit që ia ka bërë Allahu.

Besimtarë të nderuar!

Allahu i Madhërishëm tregon për gjendjen e njerëzve në ditën e gjykimit dhe ndarjen e tyre në dy grupe:

Grupi i parë: Grupi i besimtarëve.

Grupi i dytë: Grupi i pabesimtarëve.

Allahu i Madhërishëm tregon për gjendjen e njerëzve në ditën e gjykimit ku thotë:

وَأَمَّا مَنْ أُوتِيَ كِتَابَهُ وَرَاءَ ظَهْرِهِ ﴿١٠﴾

فَسَوْفَ يَدْعُو ثُبُورًا ﴿١١﴾

وَيَصْلَىٰ سَعِيرًا ﴿١٢﴾

“E përsa i përket atij që libri i vet i jepet pas shpinës,

Ai do t’i ndjellë vetes shkatërrim,

Dhe do të hyjë në zjarr të ndezur fort.” (*El-Inshikakë: 10-12*)

Grupi i dytë: janë pabesimtarët të cilët e marrin librin apo fletushkën e veprave në dorën e majtë ose pas shpine ashtu që duhet ta zgjasin dorën pas shpine dhe e marrin librin, ndërsa dorën e djathtë e kanë ndërlidhur në qafë, e kur ta lexojnë librin thërrasin: “O, u shkatërruam! Dështuam!” Pastaj futen në xhehenem, dhe i djeg zjarri me forcën e saj.

Nga kjo kuptohet se pabesimtarit, librit i jepet nga shpina. Kjo nga shkakun se duart i ka të lidhura në qafë. Ka transmetime se dora depërton nëpërmjet gjoksit dhe i del pas shpine dhe e merr librin.

Përfundim

Ebi Selmete bin Abdul Esed e kishte vëlla Esvedin.

Ebu Selmete ka qenë prej muslimanëve më të mirë, ndërsa

Vëllai i Ebu Selmetes, Esvedi ka qenë prej pabesimtarëve më të këqij:
“Thërret, ofshanë dhe kërkon vetmallkim”.

Bërtet me zë: O i mjeri unë. O çka më gjet e kështu të ngjashme.

إِنَّهُ كَانَ فِي أَهْلِهِ مَسْرُورًا ﴿١٣﴾

إِنَّهُ ظَنَّ أَنْ لَنْ يَحُورَ ﴿١٤﴾

بَلَىٰ إِنَّ رَبَّهُ كَانَ بِهِ بَصِيرًا ﴿١٥﴾

“Ai ka qenë i gëzuar në familjen e vet,

Dhe ka menduar se nuk ka për t’u kthyer.

Po, se, vërtet Zoti i tij gjithnjë e ka parë atë.” (*El-Inshikakë: 13-15*)

Allahu i Madhërishëm tregon për dy arsye se pse dënohet pabesimtari, e ato janë:

- Në këtë botë ka qenë rebel, arrogant, nuk është kujdesur për pasojat.
- Nuk është frikësuar në atë çka ka pasur para.
- Arsyeja e atij dëfrimi dhe arrogance:

Ka menduar se nuk do të kthehet te Allahu, dhe se nuk do të ringjallet për të dhënë llogari dhe për t’u dënuar, dhe se pas vdekjes nuk ka jetë tjetër.

Allahu i Madhërishëm, idesë së tij i është përgjigjur: Po gjithsesi, do të kthehet te Allahu, dhe se do të ringjallet para Tij, ashtu siç e ka krijuar herën e parë dhe se do ta shpague në bazë të veprave, qofshin të mira qofshin të këqija. Zoti i tij ka qenë i informuar saktësisht për veprat e tij. Atij nuk ka mundur ti fshihet asgjë.

Vërtetim

Vërtetohet se është e domosdoshme bota e llogaridhënies, e jo bota e të vepruarit. Kjo ngase harmonizohet me diturinë e saktë, me fuqinë gjithëpërfshirëse dhe urtësisë madhështore.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Inshikakë.

SURETU INSHIKAKË (2)

Suretu Inshikakë: 16-25

فَلَا أُقْسِمُ بِالشَّفَقِ ﴿١٦﴾ وَاللَّيْلِ وَمَا وَسَقَ ﴿١٧﴾ وَالْقَمَرِ إِذَا اتَّسَقَ ﴿١٨﴾ لَتَرْكَبُنَّ طَبَقًا عَن طَبَقٍ ﴿١٩﴾ فَمَا لَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٢٠﴾ وَإِذَا قُرِئَ عَلَيْهِمُ الْقُرْآنُ لَا يَسْجُدُونَ ۖ ﴿٢١﴾ بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا يُكْذِبُونَ ﴿٢٢﴾ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُوعُونَ ﴿٢٣﴾ فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٢٤﴾ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ﴿٢٥﴾

Allahu i Madhërishëm, për të mbjellë besimin për kataklizmën dhe për proceset pas saj - e konfirmon në raste të ndryshme.

Allahu i Madhërishëm, për të mbjellë besimin në ringjallje dhe për gjërat proceset pas saj - e konfirmon në raste të ndryshme, prej tyre:

- Është betuar në dukuritë natyrore e prej tyre:

Është betuar në skuqjen e qiellit pas perëndimit të diellit.

- Është betuar në hënën.

Betimi në këto çështje është bë për të dëshmuar se dita e gjykimit është e patjetërsueshme, dhe se njerëzit do të ballafaqohen me rreziqe të mëdha.

Mirëpo, disa njerëz nuk besojnë në Kur'anin, në ditën e gjykimit dhe nuk i besojnë ajeteve Kur'anore për këtë ngjarje.

Ata nuk besojnë në ringjallje për shkak të kryeneçësisë së tyre.

Ata nuk besojnë në ringjallje për shkak të mendjemadhësisë, kështu që do të dënohen ashpër, pos nëse pendohen dhe veprojnë punë të mira, atëherë shpërblehen me shpërblim të përgjithmonshëm të pandërprerë. Këtë e sqarojnë ajetet në vijim ku Zoti i Madhërishëm thotë:

فَلَا أُقْسِمُ بِالشَّفَقِ ﴿١٦﴾

وَاللَّيْلِ وَمَا وَسَقَ ﴿١٧﴾

وَالْقَمَرِ إِذَا اتَّسَقَ ﴿١٨﴾

“Betohem në kuqërrimin e horizontit pas perëndimit,

Dhe në natën dhe çka ajo tubon,

Dhe në hënën kur ajo është e plotë.” (El-Inshikakë: 16-18)

Zoti është betuar në “Skuqjen”. Pra, në ngjyrën e kuqe e cila paraqitet pas perëndimit të diellit deri në kohën e jacisë.

Zoti është betuar në errësirën e natës dhe atë që mbliidhet dhe bashkohet, dhe fshihet ajo çka ka qenë e shpërndarë gjatë ditës.

Zoti është betuar në hënën kur bëhet e plotë, në mes të çdo muajit të kalendarit hënorë.

Betimi në këto çështje tregon për vlerën e krijimit të atyre çështjeve.

Betimi në këto çështje tregon për madhështinë e atyre çështjeve.

Betimi në këto çështje tregon për rëndësinë e krijimit të atyre çështjeve.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

لَتَرْكَبُنَّ طَبَقًا عَنْ طَبَقٍ ﴿١٩﴾

“Ju patjetër do të përjetoni gjendje pas gjendjeje.” (El-Inshikakë: 19)

Arsyeja e betimit:

Përgjigja e betimit: “Do të transferoheni situatë pas situatë”. Pra do të bëheni bashkë, prej një gjendje në një gjendje tjetër.

Ato faza janë fazat e rrezikut, disa faza janë më të rënda se tjerat.

E, ajo është vdekja dhe proceset të cilat procesohen më pas në ditën e gjykimit dhe vështirësitë pas saj.

E, pastaj vjen faza përfundimtare, e ajo:

- ose përgjithmonë në xhenet.

- ose përgjithmonë në xhehenem.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

فَمَا لَهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿٢٠﴾

“E, çka kanë ata që nuk besojnë?” (El-Inshikakë, 20)

Allahu i Madhërishëm i qorton idhujtarët në atë se pse e mohojnë ringjalljen.

Allahu i Madhërishëm qorton pabesimtarët në atë se pse nuk e besojnë ringjalljen, ku thotë: **“Çka është me ju, pse nuk po besoni?”** (El-Inshikakë: 20).

Pra,

Çka është ajo që ju pengon të besoni në ringjalljen?

Çka është ajo që ju pengon të besoni në ditën e gjykimit?

Çka është ajo që ju pengon të besoni në Muhamedin a.s. dhe në Kur'anin?

Edhe pse ekzistojnë premiset për të besuar në to, duke filluar nga argumentet kozmike të prera të cilat dëshmojnë për plotfuqinë e Allahut në çdo gjë dhe në mrekullitë e qarta të cilat dëshmojnë për vërtetësinë e pejgamberisë së Muhamedit a.s., dhe për vërtetësinë e shpalljes Kur'anore e cila i ka zbritur atij.

وَإِذَا قُرِئَ عَلَيْهِمُ الْقُرْآنُ لَا يَسْجُدُونَ ﴿٢١﴾

“Dhe kur u lexohet atyre Kur’ani, nuk përulen (nuk bien në sexhde)?”

(El-Inshikakë: 21)

Çfarë pengese ju pengon që të mos bien në sexhde për të ju përulë Allahut të Madhërishëm atëherë kur e lexoni Kur'anin e cila është mrekulli mbinatyrore e zbritur nga Allahu i Madhërishëm.

Sexhdeja e tyre do të ishte nderim për Kur'anin dhe për Atë i Cili e ka zbritur atë, pasi ta kenë kuptuar mrekullinë e saj, pasi e dinë gjuhën e kulluar arabe, e kuptojnë retorikën dhe semantikën e saj.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا يَكْذِبُونَ ﴿٢٢﴾

“Përkundrazi, ata që nuk besuan edhe përgënjeshtrojnë?” *(El-Inshikakë: 22)*

E vërteta është se pabesimtarët e përgënjeshtrojnë librin i cili përmban çështjen e vërtetimit të monoteizmit.

E vërteta është se pabesimtarët përgënjeshtrojnë librin i cili përmban çështjen e vërtetimit të ringjalljes.

E vërteta është se ateistët e përgënjeshtrojnë librin i cili përmban çështjen e vërtetimit të shpërblimit dhe të dënimit:

- ose për shkak të urrejtjes
- ose për shkak të humbjes së pozitës
- ose për shkak të interesave personale, e kështu me radhë.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا يُوعُونَ ﴿٢٣﴾

“E All-llahu e di më së miri se çka mbajnë fshehtë ata!” (*El-Inshikakë: 23*)

Allahu është më i Dituri për të gjitha krijesat, di çka fshehin në zemrat e tyre se pse përgënjeshtrojnë.

Allahu e di pse insistoni në idhujtari.

Allahu e di pse insistoni në devijim.

Allahu i tubon veprat e mira dhe të këqija.

Allahu e di sëmundjen e zemrave duke filluar nga zilia, urrejtja e kryelartësia.

Thënia e Allahut: “Juunë” ka kuptimin, i përmbledhin veprat - siç janë përgënjeshtrimi dhe devijimi - sikurse kur i mbajnë në çantë.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٢٤﴾

إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ﴿٢٥﴾

“Lajmëroji, pra me një dënim të dhembshëm.

Me përjashtim të atyre që besuan e bënë vepra të mira, të cilët kanë shpërblim të vazhdueshëm!” (*El-Inshikakë: 24, 25*)

O pejgamber, tregoj atyre se çka ka përgatitur Allahu për ta. Tregoji se ka përgatitur dënim të dhembshëm.

Allahu i Madhërishëm nga pabesimtarët kurejshit i ka nda ata të cilët i kanë besuar, pasi më herët nuk kanë qenë besimtarë ku ka thënë se: ata të cilët kanë besuar në Allahun, në të dërguarin e Tij dhe në ditën e gjykimit, e kanë besuar Kur’anin fisnik, i janë përmbajtur Kur’anit, kanë vepruar punë të mira, në botën tjetër do të shpërblehen me shpërblime të përhershme dhe nuk do të ju ndërpriten kurrë.

Sic figuron në ajetin tjetër:

﴿وَأَمَّا الَّذِينَ سُعِدُوا فَفِي الْجَنَّةِ خَالِدِينَ فِيهَا مَا دَامَتِ السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ إِلَّا مَا شَاءَ

رَبُّكَ ۖ عَطَاءٌ غَيْرَ مَجْذُودٍ﴾ ﴿١٠٨﴾

“E për sa u përket atyre fatmirëve, ata janë në Xhennet përgjithmonë sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt (All-llahu ju dhuron) shpërblim të pakëputur.” (Hudë: 108)

Shumica e komentuesve mendojnë se kuptimi është: përpos atij i cili prej tyre pendohet dhe vepron punë të mira, për të janë caktuar shpërblime madhështore. Në këtë vërejmë motivimin për të besuar dhe për të qenë i devotshëm dhe qortimin për devijim dhe mëkatim.

Përfundim

Ajetet dëshmojnë se Ai i Cili ka mundësi t'i ndryshon trupat qiellorë prej një gjendje në një gjendje tjetër ka mundësi ta ringjallë njeriun pas vdekjes së njeriut.

Argumentet natyrore, të gjitha këto flasin se Allahu ka mundësi për të, vetëm se pabesimtarët përgënjeshtrojnë pa fakte dhe pa argumente.

Kështu ata meritojnë të dënohen me dënim të dhembshëm.

Dënimi i tyre është i drejtë dhe meritore, kjo nga shkakut se nuk është e logjikshme që të barazohet besimtari i devotshëm me pabesimtarin mëkatarë.

Nuk ka gjë më të mirë kur Allahu i Madhërishëm e tregon mëshirën e Tij atëherë kur njeriu e sheh mëshirën pasi të tregohet dënimi, kërcënim i dhe paralajmërimi mbjell shpresën e mëshirës.

Metodologjia e Kur'anit ka qenë në piedestalin më të lartë të sqarimit dhe shpjegimit, atëherë kur bënë krahasimin e temës së dënimit me temën e mirësisë.

Metodologjia e Kur'anit e bën krahasimin e temës së mëshirës dhe bamirësisë, dhe atë:

- ose para tregimit për dënim,
- ose pas tregimit të dënimit.

Kjo që të qetësohen shpirtat dhe kënaqet zemra; që të hapen dyert e shpresës në mendjen e njeriut dhe e mëson se është e patjetërsueshme kthimi në rrugën e drejtë, në rrugën e besimit, dhe në fushën e veprimit të veprave të mira.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Inshikakë.

SURETU BURUXHË

Suretu Buruxhë

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ ﴿١﴾ وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ ﴿٢﴾ وَشَهِدِ وَمَشْهُودِ ﴿٣﴾ قَتَلَ أَصْحَابِ الْأُخْدُودِ
﴿٤﴾ النَّارِ ذَاتِ الْوَقُودِ ﴿٥﴾ إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ ﴿٦﴾ وَهُمْ عَلَى مَا يَفْعَلُونَ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ﴿٧﴾
وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَنْ يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ﴿٨﴾ الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۖ وَاللَّهُ
عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٩﴾ إِنَّ الَّذِينَ فَتَنُوا الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَتُوبُوا فَلَهُمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ
وَلَهُمْ عَذَابُ الْحَرِيقِ ﴿١٠﴾ إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا
الْأَنْهَارُ ۚ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْكَبِيرُ ﴿١١﴾ إِنَّ بَطْشَ رَبِّكَ لَشَدِيدٌ ﴿١٢﴾ إِنَّهُ هُوَ يُبْدِئُ وَيُعِيدُ ﴿١٣﴾
وَهُوَ الْغَفُورُ الْودُودُ ﴿١٤﴾ ذُو الْعَرْشِ الْمَجِيدُ ﴿١٥﴾ فَعَالٌ لَمَّا يُرِيدُ ﴿١٦﴾ هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ
الْجُنُودِ ﴿١٧﴾ فِرْعَوْنَ وَثَمُودَ ﴿١٨﴾ بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي تَكْذِيبٍ ﴿١٩﴾ وَاللَّهُ مِنْ وَرَائِهِمْ مُحِيطٌ
﴿٢٠﴾ بَلْ هُوَ قُرْآنٌ مَجِيدٌ ﴿٢١﴾ فِي لَوْحٍ مَحْفُوظٍ ﴿٢٢﴾

Çdo herë kur lexohet dhe studiohet Kur'ani ndikon në zemrën e njeriut.

Çdo herë kur lexohet dhe analizohet Kur'ani ndikon në ndërgjegjen e njeriut.

Çdo herë kur lexohet dhe studiohet Kur'ani e forcon moralin e njeriut.

Çdo herë kur lexohet dhe studiohet Kur'ani forcohet edukata e njeriut.

Pejgamberi a.s. ka qenë edukata Kur'anore.

Pejgamberi a.s. ka pasqyruar programin e jetës duke e vënë në praktikë Kur'anin.

Kur'ani është shërim i zemrave dhe ushqim i mendjes.

Pejgamberi a.s. ka kaluar sprovat të ndryshme.

Kur'ani ka zbritur për ta forcuar zemrën e Muhamedit a.s.

Kur'ani ka zbritur për ta forcuar zemrën e besimtarëve në përgjithësi.

Kur'ani ka zbritur për ta forcuar zemrën tënde siç thotë Zoti i Madhërishëm:

وَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْلَا نُزِّلَ عَلَيْهِ الْقُرْآنُ جُمْلَةً وَاحِدَةً كَذَلِكَ لِنُثَبِّتَ بِهِ فُؤَادَكَ وَرَتَّلْنَاهُ

تَرْتِيلًا ﴿٣٢﴾

“Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë) që me të të forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajetit (dalëngadalë).” (Furkan, 32).

Kur’ani sqaron se pse janë sprovuar besimtarët, si kanë fituar besimtarët dhe si janë ndëshkuar armiqtë e besimit.

Kur’ani sqaron të dënuarit në çdo kohë dhe në çdo vend dhe përgëzimin për fitore.

Besimtarë të nderuar!

Surja Buruxhë flet për personat e të dënuarve në hendek.

Konfrontimi në mes të së drejtës dhe të padrejtës, është i lashtë dhe i thellë, mirëpo në fund dështojnë të padrejtët.

Konfrontimi në mes të besimit dhe pabesimit është i rrezikshëm, ashtu që ti mund të hasësh se të padrejtët kanë bërë krime të mëdha për të mbrojtur të padrejtën e tyre, mirëpo në fund humbin dhe shkatërrohen.

Në fund triumfon e drejta dhe të drejtët, ndërsa e padrejta dhe ushtria e së padrejtës pësojnë disfatë.

Këto janë fakte historike të mrekullueshme. Shembull të rrallë të banorëve të Uhdudit.

Po fillojmë me ajetin e parë të suretu Buruxhë ku Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الْبُرُوجِ ﴿١﴾

“Pasha qiellin me plot yje,” (*El-Buruxhë: 1*)

Allahu i Madhërishëm është betuar në qiellin dhe orbitat e saj: Orbitat janë rrugët e trupave qiellor ose të yjeve të mëdhenj.

Ato janë dymbëdhjetë orbita të dymbëdhjetë yjeve. Me renditje dhe të sistemuar.

Ky betim për këtë çështje tregon për vlerën madhështore të saj.

Ky betim për këtë çështje tregon për rëndësinë madhështore të saj.

Kjo e tregon Madhëstësinë e Zotit.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالْيَوْمِ الْمَوْعُودِ ﴿٢﴾

“Pasha ditën e premtuar,” (*El-Buruxhë, 2*)

Është betuar në ditën e premtuar e cila i pret pabesimtarët në atë ditë në të cilën ditë i pret shpagimdhënimi.

Është betuar në ditën e premtuar për besimtarët në të cilën shpërblehen për besimin e tyre.

Është betuar në ditën e premtuar për durimtarët, në të cilën ditë shpërblehen për durimin e tyre siç thotë Zoti i Madhërishëm:

إِنَّمَا يُوفَّى الصَّابِرُونَ أَجْرَهُمْ بِغَيْرِ حِسَابٍ

“të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!” (*Zumer, 10*).

Mjerë për pabesimtarët për atë ditë.
O ju besimtarë, priteni atë ditë kur do të gëzoheni.
O ju besimtarë, priteni atë ditë kur do të jeni të lumtur dhe të kënaqur.
Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَشَٰهِدٍ وَمَشْهُودٍ ﴿٣﴾

“Pasha atë që dëshmon dhe atë që dëshmohet!” (*El-Buruxhë: 3*)

Pasi është betuar për ditën e premtuar të gjykimit, është betuar për ata të cilët e dëshmojnë këtë ditë,

Është betuar për të dëshmuarit, dhe për ndodhitë apo për krimet e bëra, si f.v.: Është betuar për pjesëtarët e Uhdudit.

Është betuar për të torturuarit e hendekut.

Është betuar për të persekutuarit e hendekut.

Dëshmitarë: janë melekët mbrojtëse dhe melekët tjerë.

Të dëshmuarit: janë njerëzit.

Besimtarë të nderuar!

Pas betimit vjen edhe arsyeja e betimit,e, arsyeja e betimit është:

﴿٤﴾ قُتِلَ أَصْحَابُ الْأُخْدُودِ

النَّارِ ذَاتِ الْوُقُودِ ﴿٥﴾

إِذْ هُمْ عَلَيْهَا قُعُودٌ ﴿٦﴾

وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعُلُونَ بِالْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ﴿٧﴾

وَمَا نَقَمُوا مِنْهُمْ إِلَّا أَن يُؤْمِنُوا بِاللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ ﴿٨﴾

الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٩﴾

“Mallkuar qofshin ata të zotët e hendeqeve,

Të zjarrit më plot lëndë djegëse,

Kur ata rrinin ulur rreth tij,

Dhe dëshmonin atë që bënin me besimtarët.

E nuk patën pse t'i urrejë, përveç që e besuan All-llahun, ngadhënjyesin, të lavdëruarin,

Të cilit i takon sundimi i qiejve e i tokës, e All-llahu është dëshmitar i çdo sendi.” (*El-Buruxhë: 4-9*)

Mallkuar qofshin pjesëtarët e hendekut të cilët e kanë mbushur hendekun me dru dhe pastaj kanë ndezur zjarr të madh në të.

Ata ishin komunitet pabesimtarë i vendit Nexhranë në Jemen.

Kanë kërkuar nga besimtarët në Zot të largohen nga feja, pra nga feja monoteiste, mirëpo besimtarët kanë refuzuar.

Atëherë e kanë hapur një hendek të gjatë, e kanë ndezur një zjarr në atë hendek, i kanë dërguar besimtarët pranë hendekut që të ktheheshin nga feja e tyre, mirëpo besimtarët kanë refuzuar, dhe kështu ata i kanë hedhur në të.

Thënia e Allahut të Madhërishëm: **“Mallkuar qoftë për hapësit e hendekut”** (*El-Buruxhë: 4*). Është përgjigje e betimit që do të thotë: Janë mallkuar dhe janë dëbuar nga mëshira e Allahut.

Thënia e Allahut: “Zjarrin të cilin e kanë ndezur”. Zjarri: është zëvendësim i ndezjes (së zjarrit) nga fjala paraprake “hapësit e hendekut”.

Besimtarë të nderuar!

Cila është historia e pronarëve të hendekut?

Pabesimtarët në rend të parë kanë çelë hendek.

Pastaj janë ulur përreth hendekut.

I kanë tubuar besimtarët dhe ua kanë ofruar opsionin për të hy në pabesim, kush refuzonte, e hidhnin në hendek dhe digjej në zjarr.

Ekzistojnë transmetime se në zjarr janë hedhur 20.000 persona.

Janë mallkuar ata pabesimtarë të cilët i kanë dënuar besimtarët me zjarr.

I kanë hedhur në hendek të digjeshin, ndërsa ata qëndronin ulur nëpër kolltukë rreth hendekut, e ata ishin: Mbreti dhe paria e tij.

Ata i shihnin se si veprohej me besimtarët të cilët ishin të ulur në zjarr me tentativën për t'i kthyer ata në fenë idhujtare.

Kështu ata do të dëshmojnë se çka kanë vepruar në ditën e gjykimit, ashtu që gjuhët e tyre, këmbët e tyre dhe duart e tyre do të dëshmojnë kundër tyre.

Kjo dëshmon se zemrat e pabesimtarëve të cilët i kanë djegur besimtarët kanë qenë zemra të ngurta, bile edhe më të ngurta se gurët. Ata kanë qenë të pamëshirshëm dhe jonjerëzorë. Kjo si rezultat i pabesimit, të padrejtës dhe të devijimit.

Shkak i atyre torturave, dhe djegies së tyre në zjarr: Ata pabesimtarë kriminel në Nexhran të Jemenit, te besimtarët asgjë tjetër nuk e kanë konsideruar të keqe pos besimin e tyre.

Ata pabesimtarë kriminelë, e kanë urryer vetëm besimin e besimtarëve në Zot i Cili nuk mposhtet.

I Cili gjithmonë Lartmadhërohet dhe Lavdërohet.

I Cili është Sundimtar i tokës dhe çdo gjë kthehet tek Ai.

Ai meriton të besohet se është Zoti Një. Allahu është dëshmitar dhe e di se çka kanë vepruar me besimtarët. Atij nuk mund t'i fshihet asgjë.

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ الَّذِينَ فَتَنُوا الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ لَمْ يَتُوبُوا فَلَهُمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ وَلَهُمْ عَذَابُ الْحَرِيقِ ﴿١٠﴾

“Është i sigurt se ata që i sprovuan besimtarët dhe besimtare dhe nuk u penduan; ata kanë dënimin e Xhehennemit dhe dënimin e djegies.” (El-Buruxhë, 10)

Do t'i dënon ashtu siç e meritojnë për veprat e tyre.

Ky është kërcënim i ashpër për hapësit e hendekut dhe premtim për mirësi për ata besimtarë të cilët janë dënuar për fenë e tyre, të cilët kanë duruar dhe nuk janë zmbarsur nga feja e tyre, pavarësisht situatave të vështira.

Ky është kërcënim i ashpër për të ngjashmit me persekutuesit e Hendekut dhe njëkohësisht premtim për mirësi për ata besimtarë të cilët janë dënuar për fenë e tyre, të cilët kanë duruar dhe nuk janë zbrapsur nga feja e tyre pavarësisht situatave të vështira.

Mënyra e shpagimit do të jetë për të dy grupet.

- Ata të cilët, me zjarr i kanë djegur besimtarët dhe besimtare në Zot, në peygamber dhe nuk i kanë lënë të lirë në fenë e tyre, dhe i kanë detyruar: ose të digjen në zjarr, ose që të zbrapseshin nga feja e tyre, e pastaj nuk janë penduar nga veprimet e tyre të shëmtuara, dhe nga devijimi i keq i tyre, ata, për devijimin e tyre, në botën tjetër i pret dënimi i xhehenemit. Ata do të dënohen me zjarr. Kjo nga shkaku se dënimi shkon paralelisht me llojin e krimit (veprës).

- Fjala “Dënim me zjarr” është rikonfirmim për dënimin e xhehenemit, ose xhehenemi dhe zjarri: janë dy nivele të zjarrit.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَهُمْ جَنَّاتٌ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ذَلِكَ الْفَوْزُ الْكَبِيرُ



“Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, ata kanë Xhennete nën të cilët burojnë lumenj, e ai është suksezi më i madh.” (El-Buruxhë: 11)

- Sa i përket atyre të cilët kanë besuar në Zotin, në peygamberët, në ditën e gjykimit, në melaqet, në librat e Zotit, të cilët kanë vepruar vepra të mira, duke i zbatuar urdhrat e Allahut dhe duke u larguar nga ndalesat, e prej tyre janë edhe ata të cilët kanë duruar nga zjarri i hendekut të cilët kanë qëndruar stoik në fenë e tyre dhe nuk janë zbrapsur, të cilët nuk e kanë tradhtuar fenë, ata të cilët i posedojnë dy attribute: Besimin dhe veprat e mira, ata shpërblehen me xhenetet ku nën pallatet e tyre dhe nën pemët e atyre xheneteve rrjedhin lumenj.

Ky shpërblim dhe këto të mira të përmendura më lartë janë sukses dhe fitim i madh i pakrahasueshëm me diçka tjetër.

Ky është shpërblim për besimin e tyre dhe për devotshmërinë e tyre.

Njeriu duhet ta kuptojë dallimin në mes përfundimit të atyre të cilët këmbëngulin në devijim dhe të atyre të cilët e kanë besimin e sinqertë.

Besimtarë të nderuar!

Në ajetet në vijim Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ بَطْشَ رَبِّكَ لَشَدِيدٌ ﴿١٢﴾

إِنَّهُ هُوَ يُبْدِي وَيُعِيدُ ﴿١٣﴾

“Është e vërtetë se goditja e Zotit tënd është e fortë.

Në të vërtetë, Ai është që e fillon (krijimin) dhe e rikthen.” (El-Buruxhë: 12, 13)

Prej mirësisë absolute të Allahut të Madhërishëm dhe prej mëshirës së plotë të Tij: Është ajo se gjithmonë, në vende të ndryshme na tregon për fuqinë absolute dhe të pakufishme të Tij.

Fuqia e Zotit është absolute. Fuqi e krijimit dhe e shpikjes.

Fuqi gjithëpërfshirëse dhe e përgjithmonshme.

Fuqi dhe përpikëri në të njëjtën kohë.

Para fuqisë së Tij nuk mund të qëndron asnjë fuqi tjetër.

Përmendja e kësaj fuqie bëhet për t'i frikësuar pabesimtarët dhe për t'i motivuar besimtarët.

Përmendja e kësaj fuqie bëhet për të forcuar besimin e besimtarëve përballë rreziqeve dhe vështirësive, për të duruar në rast të sprovave dhe fatkeqësive.

Shembuj të torturave të besimtarëve nga pabesimtarët janë të shumta te popujt e mëhershëm, siç janë: nga Firauni dhe ushtria e tij, nga firauni dhe Themudi, nga populli Tubia, nga banorët e Ejketes, e kështu me radhë.

Ky është premtim dhe paralajmërim për ndodhitë e mëparshme të cilat tregojnë për fuqinë absolute të Allahut për të zbatuar paralajmërimin e Tij, dhe për të realizuar premtimin e Tij.

Hakmarrja ndëshkuese e Zotit tënd, pra dënon me forcë të madhe dhe në shpejtësi.

Të dënuarit do të dënohen ashpër.

Allahu kur dënon, i dënuari e ndien fortë dhembjen.

Allahu e dyfishon dënimin ndaj atyre të cilët dëshiron t'i dënon.

Allahu Famëlartë ka fuqi jashtëzakonisht të madhe. Ai është i Fuqishmi absolut dhe çka të dëshiron bëhet sa çelë e mbyll sytë, ose edhe më shpejtë se kjo.

Kjo përhapë frikën para pabesimtarëve kurejshit dhe te të ngjashmit me ta. Fuqinë absolute të Tij e konfirmon ajo se Allahu Famëlartë është Ai i Cili e ka

filluar krijimin për të parën herë në këtë botë, e Ai po ashtu ka mundësi që t'i rikthen të gjallë pas vdekjes së tyre. E ka filluar krijimin me zanafillën e tyre, e pastaj i rikrijon për t'i tubuar.

Në kuptim të përgjithshëm, kjo është e përgjithshme për të gjitha sendet. Është shprehje se Zoti vepron çdo gjë, pra e ka krijuar çdo gjë që është e krijuar, dhe e rikthen çdo gjë që kthehet. Këto, paralelisht shkojnë për të gjitha sendet (krijimin dhe rikrijimin).

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishtëm thotë:

وَهُوَ الْغَفُورُ الْودُودُ ﴿١٤﴾

ذُو الْعَرْشِ الْمَجِيدُ ﴿١٥﴾

فَعَالٌ لِّمَا يُرِيدُ ﴿١٦﴾

“Ai është që falë mëkatet, është i dashur.

Është i zoti i Arshit, të madhëruar!

E punon atë që dëshiron.” (*El-Buruxh: 14-16*)

Allahu i Madhërishtëm e konfirmon premtimin fisnik, duke i paraqitur pesë atributet e Tij, e ato janë:

- Ai falë shumë, dhe mirësia e Tij është e gjerë.

Falë: do të thotë se i fsheh gabimet e robërve besimtarë, atëherë kur pendohen dhe kthehen tek Ai, dhe se Ai (Allahu) i do shumë të devotshmit, dashamirët e Tij dhe të ndershmit pranë Tij.

Qëllimi: Të devotshmit i shpërblejnë siç është më së miri.

“Gafurul-Vedudë” janë dytribute.

E para: I fshinë gabimet e robërve të Tij.

E dyta: Butësia dhe mirësia ndaj robërve të Tij.

Allahu është Sundimtari i Arshit të madh. Më i larti i të gjitha krijesave. Madhështia e Tij shprehet në çdo gjë.

Allahu është më Fisniku dhe më Bujari. Lartësia e Tij dhe Madhështia e Tij është mbi çdo gjë. Allahu i Madhërishtëm e ka specifikuar arshin për ta nderuar arshin, dhe për të tërhequr vërejtjen se Arshi është prej krijesave më të mëdha.

Fjala “Mexhidë”, e cila në bazë të disa lexuesve lexohet me zanoren “i” (mixhidë) është cilësi e arshit. Kjo dëshmon se fjala “Mexhd” (Famë) dhe të

cilësuarit “I famshëm” është fjalë e cila mund të përdoret dhe të cilësohen shumica e krijesave.

Të lexuarit me zanoren “e” (mexhidë) në rasën emërore, e cila lexohet te shumica dërmuese e dijetarëve, tregon për atributin e Allahut të Madhërishëm.

Pastaj Allahu i Madhërishëm e informon peygamberin e Tij për historinë e firaunit dhe të Themudit për ta inkurajuar dhe për ta forcuar në misionin e tij.

Përfundim

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْجُنُودِ ﴿١٧﴾

فِرْعَوْنَ وَثَمُودَ ﴿١٨﴾

“A të ka ardhur ty lajmi i ushtrive.

Të faraonit dhe të Themudit?” (*El-Buruxhë: 17, 18*)

O peygamber, a të ka ardhur lajmi për një pjese pabesimtarësh të cilët i kanë përgënjeshtruar peygamberët e tyre, të cilët kanë përgatitur ushtri për t'i vra peygamberët?

O peygamber, a je i informuar se si janë ndëshkuar dhe çka ju ka ndodhur?

Kjo për shkak të zhytjes së tyre në pabesim dhe të thelluar në devijim.

E prej atyre historive është:

- Historia e firaunit dhe ushtrisë së Tij.
- Historia e fisit Themudë, fis arab, popull i Salihut a.s.

Qëllimi i temës për ta:

- Kryeneçësia dhe veprimet e atyre pabesimtarëve dhe
- Për të treguar se çka ju ka ndodhur më pastaj, si janë dënuar.

Këta pabesimtarë të cilët të kundërshtojnë lëri pas shpine, mos u intereso për ta. Ngase, Allahu është hakmarrë ndaj tyre të cilët kanë qenë të fuqishëm, e të mos bëhet pyetja për këta?

Në këtë rast është përmendur vetëm firauni ngase ai ka qenë udhëheqësi i popullit të tij dhe familjes së tij.

بَلِ الَّذِينَ كَفَرُوا فِي تَكْذِيبٍ ﴿١٩﴾

“Por, këta që mohuan (idhujtarët), vazhdojnë me gënjeshtëri.” (El-Buruxhë: 19)

Allahu është larguar nga tema për gjendjen e firaunit dhe të Themudit, dhe paraqet çështje se ata pabesimtarë të cilët nuk e besojnë pejgamberinë e Muhamedit a.s. nuk kanë fakte dhe argumente, por vetëm përgënjeshtrojnë për shkak të xhelozisë.

O pejgamber, e vërteta është se ata idhujtarë arab qëndrojnë në idenë e tyre të rreptë dhe të përgënjeshtrojnë ty pa kufi.

Përgënjeshtrojnë edhe mesazhin tënd, dhe nuk marrin mësim nga ajo çka i ka ndodhur pabesimtarëve të mëhershëm.

وَاللَّهُ مِنْ وَرَائِهِمْ مُحِيطٌ ﴿٢٠﴾

“Po All-llahu ata i ka rrethuar (nuk mund t’i shpëtojnë)!” (El-Buruxhë: 20)

Allahu i Madhërishëm i paralajmëron ku thotë: **“Allahu është pas tyre dhe i ka në dorë, i ka të përfshirë (në dënim)”**. (El-Buruxhë: 20).

Pra, Allahu ka mundësi t’i dënon tani, ashtu siç i ka dënuar ata. Allahu është Triumfues, nuk mund t’i ikin Atij, dhe nuk kanë mundësi të mbrohen prej Tij. Ai ka mundësi të bën çka të donë dhe kur të dëshiron. Ata kur të ngërthehen, nuk mund të ikin.

Allahu i Madhërishëm u kundërpërgjigjet përgënjeshttrimin të kurejshitëve të cilët e përgënjeshtrojnë Kur’anin, dhe thotë:

بَلْ هُوَ قُرْآنٌ مَجِيدٌ ﴿٢١﴾

فِي لَوْحٍ مَّحْفُوظٍ ﴿٢٢﴾

“Por, ky është Kur’ani Famëlartë.

Në një pllakë të ruajtur mirë (në Levhi Mahfudhë).” (El-Buruxhë: 21, 22)

Ky Kur’an të cilin e kanë përgënjeshtruar është i çmuar, me vlerë të madhe, në sistemimin e tij dhe në metodologjinë e tij dhe është mrekulli mbinatyrore.

Kur'ani është i bekuar dhe fisnik, dhe nuk është ashtu siç pretendojnë se është poezi, se është fall dhe se është magji, por është fjalë e Allahut, e ruajtur, i siguruar nga ndryshimi apo nga deformimi, dhe është i shkruar në Levhi Mahfudhë.

Ajo është ajka e librit.

Kjo është një paraqitje e përgënjeshtërimit kurejshit dhe deklasimin e tyre me kundërpërgjigje dhe informim se ky libër është Kur'ani Famëlartë. Nuk ka të pavërteta në të.

Kur'ani është fjalë e Allahut i zbritur nga "Levhi Mahfudhi" ku janë të përmbledhura të gjitha çështjet.

"LevhiMahfudhi" është ajo për të cilën na ka informuar Allahu. Duhet ta besojmë ashtu siç na ka treguar Allahu, edhe pse nuk e dimë esencën (bazën) e saj. Janë shumë çështje sekrete të cilat ne nuk i dimë. Panjohuria për të është për të përhapur frikë në ne.

Duhet të frikësohemi që të mos befasohemi.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Buruxhë.

SURETU TARIKË (1)

Suretu Tarikë: 1-10

وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ ﴿١﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ ﴿٢﴾ النَّجْمُ الثَّاقِبُ ﴿٣﴾ إِنَّ كُلَّ نَفْسٍ لَّمَّا عَلَيْهَا
حَافِظٌ ﴿٤﴾ فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ ﴿٥﴾ خُلِقَ مِنْ مَّاءٍ دَافِقٍ ﴿٦﴾ يَخْرُجُ مِنْ بَيْنِ الصُّلْبِ
وَالْتَرَائِبِ ﴿٧﴾ إِنَّهُ عَلَى رَجْعِهِ لَقَادِرٌ ﴿٨﴾ يَوْمَ تُبْلَى السَّرَائِرُ ﴿٩﴾ فَمَا لَهُ مِنْ قُوَّةٍ وَلَا نَاصِرٍ
﴿١٠﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Tarik e ka specifikën e vet, të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Tarik që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Surja Tarik përbëhet prej dy pjesëve.

Në pjesën e parë e vërteton ringjalljen.

Në pjesën e dytë vërteton saktësinë e Kur’anit.

Sot do të flasim për pjesën e parë të kësaj sureje.

Allahu është betuar në mundësinë e ndodhisë së ringjalljes së krijesave.

E vërteton në mënyrë kategorike.

I kundërpërgjigjet idhujtarëve përgënjeshtres.

Informon se Allahu, i Cili e ka krijuar njeriun nga asgjëja, ka mundësi ta rikrijon.

Allahu, i Cili e ka krijuar njeriun nga asgjëja, ka mundësi ta ringjallë njeriun përsëri pas vdekjes.

Këto janë çështjet të cilat i trajton pjesa e parë e kësaj sure.

Besimtarë të nderuar!

Zoti Famëlartë thotë:

وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ ﴿١﴾

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ ﴿٢﴾

النَّجْمِ الثَّاقِبِ ﴿٣﴾

“Pasha qiellin dhe yllin ndriçues (të natës)!

E ku e di ti se çka është tariku - trokitësi?

Ai është ylli që shpon (errësirën me dritë).” (Et-Tarik: 1-3)

Kur’ani, i cili tregon për ringjalljen, tregon se momentin e asaj dite e di vetëm Allahu Famëlartë dhe askush tjetër.

Është betuar në qiellin e krijuar.

Është betuar në yllin ndriçues i cili ndriçon natën.

Pastaj e ka pyet pejgamberin a.s.:

O pejgamber, çka di ti për esencën e saj?

Pastaj ia sqaron se: Ai është ylli ndriçues i natës, i cili e ndriçon natën nga errësira e madhe.

Fjala “Tarik” është emër i cili përdoret për çdo gjë që paraqitet dhe del natën.

Më pastaj sqarohet se ai është ylli “Thakib” shpues.

Thuaja se e djegë apo e çelë jorganin e errësirës.

Betimi në yje tregon se ato yje janë të krijuara në mënyrë të përpiktë dhe janë të sistemuara saktësisht.

Këto yje e zbukurojnë qiellin e kësaj bote.

Këto yje janë shenja edhe të udhëzimit në tokë.

Besimtarë të nderuar!

Cila është arsyeja e betimit në këtë rast?

Arsyeja e betimit, me fjalë tjera përgjigjja e betimit është se:

﴿إِنْ كُلُّ نَفْسٍ لَّمَّا عَلَيْهَا حَافِظٌ ۚ﴾

“Nuk ka asnjë njeri që ndaj tij të mos ketë përcjellës.” (Et-Tarik: 4)

Nga kjo kuptojmë se:

Allahu e ruan çdo shpirt.

Allahu e siguron dhe e garanton çdo shpirt.

E ruan nga fatkeqësitë.

E ata ruajtës janë melekët të cilat i ruajnë punët e njerëzve.

Melekët i regjistrojnë fjalët e njerëzve.

Melekët i arkivojnë veprat e njerëzve.

Melekët grumbullojnë çdo gjë që rezulton prej njerëzve, qoftë e mirë qoftë e keqe.

Pra: Nuk ka shpirt vetëm se çka ka në të ruhet dhe sigurohet.

Edhe pse ajeti ka kuptim të përgjithshëm, ajeti në fjalë ka zbritur për Ubej el Eshed bin Keldete el Xhumehijin.

Ai ngrihej dhe hynte nën një lëkurë dhe thoshte: O ju grup kurejshit: Kush e largon këtë nga unë, ai do ta fiton këtë.

Pastaj thoshte: “Muhamedi po thotë se rojtarë të xhenetit janë nëntëmbëdhjetë. Unë i vetëm ballafaqohem me dhjetë prej tyre, ndërsa për nëntë të tjerët më ndihmoni!”. Pastaj ka zbritur ajeti:

“Nuk ka asnjëri njeri që ndaj tij të mos ketë përcjellës”. (Tarik, 4)

Çdo njeri i ka sekretarët të cilët i shënojnë fjalët, punët, fitimin, të keqën e të mirën.

Sqaron se njeriu ka përcjellës, siç thuhet edhe në ajetin tjetër ku Zoti i madhërishëm thotë:

لَهُ مُعَقِّبَاتٌ مِّن بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِ يَحْفَظُونَهُ مِّنْ أَمْرِ اللَّهِ

“Ai (njeriu) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhrin e All-llahut e ruajnë atë”. (Read, 11)

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

فَلْيَنْظُرِ الْإِنْسَانُ مِمَّ خُلِقَ ﴿٥﴾

“Le të shikojë njeriu se prej çkahit është krijuar?” (Et-Tarik: 5)

Allahu i Madhërishëm ia tërheqë vërejtjen njeriut që të shikon bazën e krijimit të tij, ashtu që të merr mësim.

Allahu i Madhërishëm ia tërheqë vërejtjen njeriut që të shikon bazën e krijimit të tij, që të argumentohet në atë se mundësia e ringjalljes ekziston.

Njeriu duhet që të mediton në mënyrën e fillimit të krijimit të tij, që ta mëson fuqinë absolute të Allahut.

Njeriu duhet që të mediton edhe në çështjet tjera përpos mundësisë për të ringjallë njeriun.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

خُلِقَ مِنْ مَّاءٍ دَافِقٍ ﴿٦﴾

يَخْرُجُ مِنْ بَيْنِ الصُّلْبِ وَالتَّرَائِبِ ﴿٧﴾

“Ai (njeriu) është krijuar prej një uji që hidhet fuqishëm,

E që del nga kurrizi i shpinës dhe dërrasa e gjoksit.” (Et-Tarik: 6, 7)

Allahu e ka krijuar njeriun nga një pikë uji i hedhur në mitër.

Ajo pikë uji është pika e ujit të mashkullit (spermatozoidit) dhe pika e ujit të femrës (vezori).

Ajo pikë uji, është pika e ujit të mashkullit, spermatozoidi i mashkullit dhe pika e ujit të vezorit të femrës.

E ka bë një pikë uji pas bashkëdyzimit të tyre.

Ajo pikë uji del nga boshti kurrizor i njeriut, i nxitur nga truri dhe nga mesi i trupit të femrës, pra nga eshtrat e gjoksit të saj, ose nga vendi i cili ndërlidhet me gjoksin.

Fëmija rezulton me bashkëdyzimin e dy ujërave (spermatozoidit dhe vezorit). Pastaj uji i bashkëdyzuar zë vend në mitër dhe me dëshirën e Zotit formohet embrioni.

Embrioni zanafillën e ka në vullnetin e Allahut të Madhërishëm.

Besimtarë të nderuar!

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّهُ عَلَىٰ رَجْعِهِ لَقَادِرٌ ﴿٨﴾

“E s’ka dyshim se Ai ka fuqi ta rikthejë në jetë atë.” (Et-Tarik: 8)

Allahu i Madhërishëm ka mundësi që njeriun ta kthen tek Ai.

Allahu i Madhërishëm ka fuqi që njeriun ta kthen tek Ai.

Në këtë rast qëllimi është për kthimin me ringjallje pas vdekjes së njeriut. Kjo nga shkakun se ai i cili ka mundësi të fillon krijimin e një çështjeje për të parën herë, Ai ka mundësi që ta ngjallë herën tjetër.

Besimtarë të nderuar!

Cila është dita e kthimit të Zotit?

Këtë e tregon Zoti i Madhërishëm ku thotë:

يَوْمَ تُبْلَى السَّرَائِرُ ﴿٩﴾

“Ditën kur do të zbulohen të fshehtat.” (Et-Tarik: 9)

Pa dyshim se:

- Dita e gjykimit është dita e zbulimit të sekreteve.

Në ditën e gjykimit do të shpalosen të gjitha çështjet dhe nuk do të ketë mbulesa.

Atëherë njeriu jep llogari dhe shpaguhet.

Allahu kur ta kthen njeriun në ditën e gjykimit, ta kthen te Vetja e Tij, ta teston dhe t’i kuptohen njeriut sekretet e tij, atëherë kur të dalin në sipërfaqe sekretet e tij.

Pra, fshehtësitë e shpirtave dhe të zemrave, duke filluar në bindjet (besimet), qëllimet (nijetet), sekretet, e kështu me radhë.

E fshehta zbulohet, konfidencialja shpaloset.

Pejgamberi a.s. ka thënë: Në trup është një organ, nëse ai është i mirë i tërë trupi është i mirë, nëse ai organ është i keq, i tërë trupi është i keq, e ai organ është zemra.

Nuk do të zbulohen vetëm sekretet shtetërore, as të njeriut ndaj njeriut, por do të zbulohen sekretet e njeriut ndaj vetes së tij do të zbulohet se çka ka fsheh në zemrën e tij.

Përfundim

Pastaj Zoti i madhërishëm thotë:

فَمَا لَهُ مِنْ قُوَّةٍ وَلَا نَاصِرٍ ﴿١٠﴾

“E ai (njeriu) nuk ka forcë as ndihmëtarë.” (*Et-Tarik: 10*)

Njeriu, pasi të ringjalljet nuk ka forcë as për veten e tij që të mbrohet nga dënimi i Allahut.

Njeriu nuk ka mundësi që ta mbron tjetrin nga dënimi prej Allahut.

Njeriu nuk mund të gjen ndihmëtarë i cili do t'i ndihmonte.

Njeriu nuk ka mundësi të shpëton nga situatat në të cilën do të gjendet.

Nuk ka as fuqi të brendshme për ta shpëtuar veten e tij nga dënimi prej Allahut.

Nuk ka as ndihmë nga ndokush tjetër për ta shpëtuar veten e tij nga dënimi prej Allahut.

Atë ditë njeriu nuk ka ndihmëtarë apo ndërmjetësues.

Atë ditë njeriu nuk do të ketë mundësi të ikë.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Tarik.

SURETU TARIKË (2)

Suretu Tarikë: 11-17

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الرَّجْعِ ﴿١١﴾ وَالْأَرْضِ ذَاتِ الصَّدْعِ ﴿١٢﴾ إِنَّهُ لَقَوْلُ فَصْلٍ ﴿١٣﴾ وَمَا هُوَ بِالْهَزْلِ ﴿١٤﴾ إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا ﴿١٥﴾ وَأَكِيدُ كَيْدًا ﴿١٦﴾ فَمَهْلِ الْكَافِرِينَ أَمَهُلُهُمْ رُويْدًا ﴿١٧﴾

Surja Tarikë përbëhet prej dy pjesëve:

- Në pjesën e parë e vërteton ringjalljen.
- Në pjesën e dytë e vërteton saktësinë e Kur'anit.

Sa i përket pjesës së dytë, Zoti Famëlartë betohet si në vijim:

وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الرَّجْعِ ﴿١١﴾

“Pasha qiellin që kohë pas kohe kthehet me shi.” (Et-Tarik: 11)

Me këtë ajet Allahu është betuar në qiellin i cili është rikthyes i çështjeve.

Po ashtu,

me këtë ajet Allahu është betuar në qiellin plot shi, i cili shi nga qielli zbret në tokë.

Është betuar në qiellin i cili e zbret shiun vazhdimisht nëpërmjet vetëtimës dhe murmurimës.

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ عِلْمُ السَّاعَةِ وَيُنَزِّلُ الْغَيْثَ وَيَعْلَمُ مَا فِي الْأَرْحَامِ ۚ وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ مَّاذَا تَكْسِبُ غَدًا ۚ وَمَا تَدْرِي نَفْسٌ بِأَيِّ أَرْضٍ تَمُوتُ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿٣٤﴾

“S’ka dyshim se vetëm All-llahu e di kur do të ndodhë kijameti, Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se çka në mitra (të nënave), nuk e di kush pos Tij se çka do t’i ndodhë (çka do të punojë) nesër, dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç’vend (ose kohë) do të vdesë. All-llahu është më i dijsmi, më i njohuri.” (Llukman, 34)

Pra ajeti në fjalë është dykuptimësh:

- Qielli e rikthen çështjen në tokë.
- Qielli e zbret shiun nga retë, e kështu e ngjallë tokën pasi të vdes (pasi të thahet ajo tokë) e pastaj shumohen bimët, pastaj rriten dhe zhvillohen bimët.

Besimtarë të nderuar!

Pastaj Zoti i Madhërishëm është betuar në tokën e cila çahet dhe kur çahet në brendi prej saj dalin bimët ku thotë:

وَالْأَرْضِ ذَاتِ الصَّدْعِ ﴿١٢﴾

“Edhe tokën që çahet për bimë.” (*Et-Tarik: 12*)

Toka kur çahet në brendi, prej saj dalin farërat (frytet).

Toka kur çahet në brendi, prej saj dalin pemët.

Toka kur çahet në brendi, prej saj dalin xehet.

Toka kur çahet në brendi, prej saj dalin thesaret.

Toka kur çahet në brendi dhe prej saj dalin pasuritë e naftës dhe lëndëve djegëse, e kështu me radhë...

Besimtarë të nderuar!

Parashtrohet pyetja:

Cila është arsyeja e këtij betimi?

Përgjigja e betimit, me fjalë tjera arsyeja e betimit është se:

إِنَّهُ لَقَوْلُ فَصْلٍ ﴿١٣﴾

“Është e vërtetë se ai (Kur’ani) është fjalë që dallon - gjykon.” (*Et-Tarik: 13*)

Ajetet e Kur’anit janë fjalë sqaruese.

Ajetet e Kur’anit janë fjalë determinuese.

Ajetet e Kur’anit e bëjnë sqarimin në mes të vërtetës dhe të pavërtetës.

Ajetet e Kur’anit e bëjnë ndarjen e së drejtës nga e padrejta.

Kur’ani është fjalë sqaruese dhe kristalizuese e Allahut, e ndanë të vërtetën nga e pavërteta.

Besimtarë të nderuar!

Pastaj Zoti i Madhërishëm tregon se:

وَمَا هُوَ بِالْهَزْلِ ﴿١٤﴾

“Nuk është ai i parëndësishëm (lojë e kotë)!” (Et-Tarik: 14)

Kur’ani nuk është i pavlerë.

Kur’ani nuk ka zbritur për t’u tallur, e për të lozur.

Kur’ani është çështje serioze.

Kur’ani nuk është çështje joserioze.

Fjala e Allahut nuk është poezi.

Kur’ani nuk është as magji.

Kur’ani nuk është as fall.

Kur’ani është zbritje nga i Urti dhe i Famshmi.

Besimtarë të nderuar!

Allahu i ka paralajmëruar ata të cilët e përgënjeshtrojnë Kur’anin ku thotë:

إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا ﴿١٥﴾

“Ata përgatitin kurthe”. (Et-Tarik: 15)

Por Zoti i madhërishëm thotë:

وَأَكِيدُ كَيْدًا ﴿١٦﴾

“Po edhe Unë e përgatis dështimin e kurtheve të tyre!” (Et-Tarik: 16)

Kundërshtarët e Mekës përgatitin kurthe për pejgamberin a.s. për ta mposhtur atë me çka ka ardhur pra me fenë e vërtetë.

Kundërshtarët e Islamit për të penguar rrugën në drejtim të Allahut dhe të Kur’anit, me thënien se Kur’ani është proverb e popujve të lashtë.

Kundërshtarët e Muhamedit a.s. me thënien se Muhamedi është magjistar.

Kundërshtarët Muhamedit a.s. i kanë thënë ashtu sikurse edhe sot thonë se Muhamedi është i çmendur.

Kundërshtarët e Islamit thonë se Kur’ani është poezi dhe vargje të cilat i ka thurë Muhamedi a.s. dhe se në këtë aspekt Muhamedi a.s. është poet.

Kundërshtarët e Islamit thonë se Kur'ani është prozë, poemë dhe vargje të cilat i ka thurë Muhamedi a.s. dhe se në këtë aspekt fjala e Muhamedit a.s është prozë.

Kundërshtarët e Muhamedit a.s. kanë bërë plane për ta mbytur Muhamedin a.s.

Ateistët bëjnë plane kundër asaj me çka ka ardhur Muhamedi a.s. dhe për çka ka zbritur Kur'ani.

Ateistët bëjnë projekte kundër asaj për çka ka zbritur Kur'ani.

Mirëpo Allahu ka plan krejtësisht tjetër, i përshkallëzon me mëkatet e tyre e që më pastaj i dënon për dredhitë e tyre.

Përfundim

Zoti i Madhërishëm thotë:

فَمَهْلُ الْكَافِرِينَ أَمْهَلُهُمْ رُؤْيَا ﴿١٧﴾

“E ti jobesimtarëve jepu afat, afatizoi ata pak.” (*Et-Tarik: 17*)

Pastaj, Allahu i premtan fitore pejgamberit të Tij, në kuptimin që: O pejgamber, priti ata, të mos shkatërrohen njëherë,

O pejgamber, mos ngurro! Pajtohu me atë se si do ta programon Allahu çështjen e tyre për ty.

O muslimanë, mos ngurro! Pajtohu me atë se si do ta programon Allahu çështjen e tyre për Islamin.

Jepu afat pak, deri në një ditë të afërme.

Jepu afat pak, deri në një ditë të afërme, e do ta shohësh se si do të dënohen.

Priti pak dhe do të shohësh se si do të dërmohen.

Priti pak dhe do të shohësh se si do të dhe do të shkatërrohen.

Kjo është përsëritje për të treguar çështjen në mënyrë të hiperbolizimit.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e sures Tarik.

SURETU EALA

Suretu Eala

سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى ﴿١﴾ الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّى ﴿٢﴾ وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَى ﴿٣﴾ وَالَّذِي أَخْرَجَ
الْمَرْعَى ﴿٤﴾ فَجَعَلَهُ غُثَاءً أَحْوَى ﴿٥﴾ سَنُفِرُّكَ فَلَا تَنْسَى ﴿٦﴾ إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ إِنَّهُ يَعْلَمُ
الْجَهْرَ وَمَا يَخْفَى ﴿٧﴾ وَنُيْسِرُكَ لِلْمِيسِرَى ﴿٨﴾ فَذَكِّرْ إِنْ نَفَعَتِ الذِّكْرَى ﴿٩﴾ سَيَذَكِّرُ مَنْ يَخْشَى ﴿١٠﴾
وَيَنْجِنُهَا الْأَشْقَى ﴿١١﴾ الَّذِي يَصْلَى النَّارَ الْكُبْرَى ﴿١٢﴾ ثُمَّ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى ﴿١٣﴾
قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى ﴿١٤﴾ وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ﴿١٥﴾ بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا ﴿١٦﴾
وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴿١٧﴾ إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ﴿١٨﴾ صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ﴿١٩﴾

Ta analizojmë suren të cilën pejgamberi a.s. e ka dashur shumë, të cilën e ka lexuar në namazin e vitrit.

Ta analizojmë suren të cilën pejgamberi a.s. e ka dashur shumë, të cilën e ka lexuar në namaz të bajrameve, të xhumasë.

Ta analizojmë suren të cilën pejgamberi a.s. e ka dashur shumë, të cilën e ka lexuar në namazin e Istiskasë.

Surja Eala sqaron për:

- Tesbihin,
- Dhikrin dhe
- Lakminë ndaj kësaj bote.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى ﴿١﴾

“Madhëroje emrin e Zotin tënd të Lartë!” (El-Eala: 1)

Allahu i ka thënë pejgamberit që ta madhëron Zotin e tij.

Zoti të thotë ty: Madhëroje Zotin tënd.

“Me emrin e Zotit tënd”: qëllimi është se Ai, Allahu është Zoti yt.

Allahu është i Lartësuar, i pa të meta dhe është krejtësisht ndryshe nga gjithë ajo që i përshkruajnë idhujtarët.

Allahu është i Lartësuar, i pa të meta dhe është krejtësisht ndryshe nga gjithë ajo që i përshkruajnë filozofët etj.

Çka pikësynohet me këtë urdhër?

Të lartësohet Allahu nga çdo e metë e cila i përshkruhet Atij.

Absolutisht Ai është pa asnjë mangësi.

Fjala “Eala”: Është më i Larti dhe i pa të meta.

Ai nuk posedon përshkrimet dhe cilësitë të cilat ia përshkruajnë Atij.

Ai është i Larti dhe më i Larti ashtu siç është i Madhi dhe më i Madhi.

Na mëson se Allahu është më i madhi, më i larti dhe nëse ne veprojmë sipas urdhrave të Allahut jemi më të ngriturit.

Nëse ne veprojmë sipas urdhrave të Allahut jemi më të më të zhvilluarit.

Nëse ne veprojmë sipas urdhrave të Allahut jemi më të civilizuarit, siç thotë Zoti i Madhërisëm:

وَلَا تَهْنُوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَنْتُمُ الْأَعْلَوْنَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ﴿١٣٩﴾

“E mos u dobësoni (fizikisht dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të singertë.” (Ali Imranë, 139)

Kur ka zbritë ky ajet, Pejgamberi a.s. ka thënë bëjeni praktikë ta thoni në sexhde.

Na urdhëron për tesbih.

Pejgamberi a.s. bënte tesbih në çdo kohë.

Pejgamberi a.s. e zbukuronte kuvendin me tesbih.

Pejgamberi a.s. e fillonte fjalimin me tesbih dhe e përfundonte fjalimin me tesbih.

Pejgamberi a.s. ka thënë: **“Kush thotë brenda një dite 100 herë “Subhanellahi ve bihamdihi”, i fshihen mëkatet qofshin ato mëkate të shumta sa shkuma e detit”.**

Po ashtu pejgamberi a.s ka thënë: **“Për çdo tesbih regjistrohet sadaka”.**

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّى ﴿٢﴾

“I cili krijoi dhe përsosi” (El-Eala: 2)

Atributet e Zotit më të Lartit janë si në vijim:

- Ai i ka krijuar të gjitha krijesat, e prej tyre është krijesa njeri.
- Secilën krijesë të cilën e ka krijuar, e ka krijuar me atë çka është në përshtatshmëri të asaj krijese,
- Secilën krijesë të cilën e ka krijuar e ka strukturuar qenien e tyre, ia ka përshtatë pjesët e trupit të saj.
- Pjesët e trupit i ka përshtatë të jenë në proporcion me njëra-tjetrën e jo disproporcionale në mes vete.
- Pjesët e trupit i ka përshtatë të jenë në harmoni me njëra-tjetrën e jo në disharmoni në mes vete.

Thënia e Allahut: “**Fe sevva**” e ka kuptimin se i ka harmonizuar, i ka nivelizuar dhe i ka përsosur.

Allahu është Ai i Cili, secilës krijesë ia ka përcaktuar atë që i përshtatet asaj krijese, duke ia përcaktuar çka është specifikuar për atë krijesë.

Ka krijuar çdo gjë të precizuar.

Po ashtu njeriun e ka krijuar në formën më të bukur.

Besimtarë të nderuar!

Pastaj e ka udhëzuar dhe ia ka mundësuar që ta mësojnë mënyrën se si të përfitojnë nga çështjet.

وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَى ﴿٣﴾

“Dhe i cili përcaktoi e orientoi” (El-Eala: 3)

Thënia e Allahut: “Fe kaddere” ka kuptimin: Vlerësimin dhe krahasimin në mes sendeve dhe çështjeve.

Pastaj e ka udhëzuar në atë çka është për të mirën e tyre.

Të vegjlit dinë të pinë qumështin nga nëna e tyre.

Ka treguar rrugën e fatkeqësisë dhe të lumturisë.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالَّذِي أَخْرَجَ الْمَرْعَى ﴿٤﴾

فَجَعَلَهُ غُثَاءً أَحْوَى ﴿٥﴾

“Dhe i cili mundësoi mbirjen e kullosës;

E pastaj atë e bëri mbeturinë të zezë.” (El-Eala: 4, 5)

Allahu është Ai i Cili ka bë të kultivohen barishte ashtu që t'i konsumojnë kafshët. Allahu është Ai i Cili ka bë që të kultivohen bimët dhe drithërat të cilat i konsumojnë njerëzit.

Pastaj, ato barishte, pasi të jenë të njoma dhe me ngjyrë të gjelbër i bënë që të thahen dhe të marrin ngjyrën e bojherit.

Zoti zbret shiun për gjelbërim për rritjen dhe për zhvillimin e bimëve; pemëve; perimeve dhe çdo gjë tjetër në natyrë.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm i ka thënë Pejgamberit a.s.:

سَنُقَرِّئُكَ فَلَا تَنْسَى ﴿٦﴾

إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ إِنَّهُ يَعْلَمُ الْجَهْرَ وَمَا يَخْفَى ﴿٧﴾

“Ne do të lexojmë ty e nuk do të harrosh (Kur’anin).

Përveç asaj që All-llahu dëshiron. Ai e di të hapurën e të fshehtën.” (El-Eala: 6, 7)

Allahu i premton pejgamberit të Tij se do t’ia forcon Kur’anin në zemrën e tij.

O pejgamber, Ne do të të bëjmë ty lexues ashtu që do të të inspirojmë leximin e Kur’anit dhe nuk do ta harrosh atë të lexuar.

Kur Xhibrili zbriste shpalljen, para se Xhibrili ta përfundonte ajetin e fundit, pejgamberi i lexonte ajetet e mëparshme, nga frika se mos po harronte ndonjë pjesë të Kur’anit (ajeteve). Atëherë ka zbritur ajeti: **“Ne do të ta lexojmë ty dhe t’i nuk do ta harrosh”**. Pas këtij momenti ti nuk do të harrosh asgjë. Të mjaftoj Unë ty për atë çështje.

Pas zbritjes së këtij ajeti, pejgamberi a.s. nuk ka harruar asgjë deri sa ka vdekur.

Ti do ta memorizosh Kur’anin i cili të zbret ty dhe nuk do ta harrosh, pos nëse Allahu dëshiron që ta harrosh. Po që se dëshiron Ai që ti të harrosh diçka, atëherë e bënë që ta harrosh.

Allahu e di të fshehtën.

Ky ajat është në kuptim të thënies së Allahut të Madhërishëm:

لَا تُحَرِّكُ بِهِ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِ ﴿١٦﴾ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ ﴿١٧﴾ فَإِذَا قَرَأَهُ فَاتَّبِعْ

قُرْآنَهُ ﴿١٨﴾

“Ti (Muhamed) mos shqiptoj atë (Kur’anin) me gjuhën tënde për ta nxënë atë me të shpejtë!

Sepse Ne e kemi për detyrë tubimin dhe leximin e tij!

E kur ta lexojnë atë ty, ti përcille me të dëgjuar leximin e tij.” (Kijame: 16-18)

Allahu i ka premtuar se do t’ia mundëson leximin dhe e ka informuar se nuk do ta harron aspak dhe pas këtij ajeti do t’ia përkujton që të mos e harron. Kjo nga shkaku se pejgamberi a.s. i lëvizte me shpejtësi buzët. Kjo nga frika se mos po harronte diçka nga Kur’ani. Kjo mund të interpretohet në atë se

pejgamberi a.s. ka qenë analfabet, ndërsa, Allahu ia ka mundësuar që ta memorizon shpalljen dhe e ka garantuar se nuk do ta harronte.

Pastaj, Allahu i Madhërishëm e ka rikonfirmuar premtimin se do t'ia lexonte dhe pastaj nuk do ta harronte. Kjo nga shkakun se Allahu e di se çka publikojnë robërit e Tij dhe çka fshehin nga fjalët e tyre dhe nga veprat e tyre. Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَيْسِّرْكَ لِلْيُسْرَى ﴿٨﴾

“Dhe Ne do ta lehtësojmë ty më të lehtën.” (El-Eala: 8)

Allahu e përgëzon pejgamberin a.s. me një lajm tjetër, e ai është se do t'ia harmonizon atë që është më e lehta në dispozitat e sheriatit.

Ne ty, do t'i lehtësojmë veprat e mira dhe thëniet e drejta, do të të ligjësojmë atë çka është e lehtë dhe tolerante. Do të ta mundësojmë rrugën më të lehtën.

Kuptimi në mënyrë të shkurtuar: Me ty do të shkojmë në atë mënyrë që çështjet do t'i lehtësojmë dhe do t'i bëjmë të mira edhe për këtë botë, edhe për botën tjetër, ashtu që do të të ndihmojmë të triumfosh, të përfitosh, dhe ty me mesazhin tënd do të të ngritim në ditën e gjykimit në pozitë të lartë në xhenet.

Besimtarë të nderuar!

Pastaj, Allahu i Madhërishëm e urdhëron pejgamberin a.s. për të marrë rrugën e këshillimit.

فَذَكِّرْ إِنْ نَفَعَتِ الذِّكْرَى ﴿٩﴾

“Pra këshillo aty ku këshilla bën dobi.” (El-Eala: 9)

O pejgamber, këshilloji njerëzit në rrugën e drejtë dhe të dobishmes.

O pejgamber, udhëzoji njerëzit në rrugën e drejtë dhe të dobishmes.

O besimtarë, këshilloji njerëzit në rrugën e drejtë.

Udhëzoi në ligjet e fesë. Dhe kjo, nëse bëjnë dobi këshillat te ta.

Kjo është një paraqitje e çështjes në mënyrën e qortimit për kurejshitet. Pra, nëse këshillat ju bëjnë dobi atyre kokëfortëve mizorë.

Ti o Muhamed këshillo për botën tjetër, për sheriatin, për rrugën e drejtë.

Ti musliman këshillo për botën tjetër, për sheriatin, për rrugën e drejtë, sepse:

Besimtarë të nderuar!

Një pjesë e pranon këshillën, ndërsa

Një pjesë tjetër e refuzon dhe nuk e pranon këshillën.

Pabesimtari nuk e pranon këshillën, atëherë ky do të digjet në zjarr të madh.

Zjarri i xhehenemit është i madh. Dënimi në xhehenem është i vazhdueshëm dhe i pandërprerë.

Zoti i Madhërishëm thotë:

سَيَذَكَّرُ مَنْ يَخْشَى ﴿١٠﴾

“Do të këshillohet ai që ka frikë” (El-Eala: 10)

Këshillën do ta pranon ai i cili i frikësohet Zotit dhe botës tjetër, e, ata janë dijetarët.

Këshillën do ta pranon ai i cili i frikësohet Zotit dhe botës tjetër, e, ata janë besimtarët.

Secili e pranon këshillën dhe merr mësim në bazë të kapacitetit.

Në anën tjetër:

وَيَجْنِبُهَا الْأَشْقَى ﴿١١﴾

الَّذِي يَصْلَى النَّارَ الْكُبْرَى ﴿١٢﴾

ثُمَّ لَا يَمُوتُ فِيهَا وَلَا يَحْيَى ﴿١٣﴾

“Ndërsa do të shmanget më i keqi,

I cili do të hyjë në zjarrin e madh.

Pastaj nuk do të vdesë në të, por as nuk do të jetojë.” (El-Eala: 11-13)

Nuk do ta pranon këshillën, ai i cili i paraprinë rebelimit.

Nuk do ta pranon këshillën, dhe do t'i largohet të mirës ai i cili i paraprinë devijimit dhe pabesimit.

“I cili do të hyjë në zjarrin e madh.

Pastaj nuk do të vdesë në të, por as nuk do të jetojë.” (El-Eala: 12-13)

E, atëherë ai meriton të digjet në zjarrin e madh dhe në dënim të përgjithmonshëm.

Banori i përgjithmonshëm i xhehenemit kur do të hynë në xhehenem.

Banori i xhehenemit do të mbetet aty përgjithmonë.

Aty, as nuk do të vdesë që të qetësohet nga dënimi, por edhe nuk do të ketë jetë të mirë e të qetë ku do të përfitonte diçka, apo të ishte i lumtur në të.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿١٤﴾ قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى

وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى ﴿١٥﴾

“Ka shpëtuar ai që është pastruar.

Që e përkujton emrin e Zotit të vet dhe falet.” (El-Eala: 14, 15)

Ka korrë suksese ai i cili është pastruar nga idhujtaria dhe mëkatet.

Ka shpëtuar nga dënimi ai i cili është pastruar nga idhujtaria dhe mëkatet.

Ka fituar ai i cili ka besuar në Zotin Një dhe ka vepruar me ligjet e Tij, pastaj e ka edukuar shpirtin dhe e ka pastruar nga degjenerimi dhe të këqijat.

Ka shpëtuar kush e pastron shpirtin, largohet nga edukata e keqe, nga sjellja e keqe ndaj njerëzve dhe vazhdimisht e përmend Zotin, me gjuhë, me zemër, pastaj i falë namazet, ai do të jetë i lumtur dhe i qetë.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿١٦﴾ بَلْ تُؤْثِرُونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا

وَالْآخِرَةَ خَيْرٌ وَأَبْقَى ﴿١٧﴾

“Po ju i jepni përparësi jetës së dunjasë,

Ndërsa ahireti është më i mirë dhe i përjetshëm.” (El-Eala: 16, 17)

Allahu i Madhërishëm i ka informuar njerëzit se: Ata i kanë dhënë prioritet kësaj bote:

- Pabesimtari ndikohet në këtë botë dhe nuk beson në botën tjetër.

- Besimtari, beson në botën tjetër, por ndikohet në mëkate, dhe e mbizotëron epshi, përpos nëse e mbron Allahu i Madhërishëm.

Mirëpo, bota tjetër, të mirat e botës tjetër janë më të vlefshme dhe më të çmuara se kjo botë, njëkohësisht janë të përgjithmonshme.

Shpërblimi i Allahut në botën tjetër është më i çmueshëm dhe i përgjithmonshëm. Kjo nga shkaku se kjo botë është e përkohshme, ndërsa bota tjetër është e përgjithmonshme.

Sqaron se ata i japin prioritet kësaj bote ndaj botës tjetër.

Sqaron se ata e për zgjedhin këtë botë të përkohshme dhe e harrojnë botën tjetër të përgjithmonshme përkundër asaj se bota tjerët në krahasim me këtë botë është më e mirë.

Përfundim

Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنَّ هَذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَى ﴿١٨﴾

صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى ﴿١٩﴾

“Vërtet kjo ishte në broshurat e lashta:

në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait.” (El-Eala: 18, 19)

Secila sure e Kur’anit fisnik e përmban besimin, bazat e adhurimit.

Secila sure e Kur’anit fisnik i përmban bazat e moralit dhe pastrimit shpirtëror.

Suret Kur’anore tërheqin vërejtjen për t’u mos mashtruar në këtë botë, por duhet orientuar në vepra të mira për botën tjetër të përherëshme.

Kjo qasje e Kur’anit fisnik ka qenë edhe e qasje e librave qiellorë.

Kjo qasje e Kur’anit fisnik ka qenë edhe në fletushkat e Ibrahimit, Shijtit.

Kjo qasje e Kur’anit fisnik ka qenë edhe në fletushkat e Musaut.

Ky është model i jetesës në Islam, i cili model është në suretul-Eala.

Allahu i Madhërishëm bënë me dije se ligjet e Zotit janë Një, në bazë të tyre dhe në edukatën në mënyrë të përgjithshme, dhe se ajo çka është treguar për shpëtimin dhe pastrimin shpirtëror dhe ajo çka ka këshilluar Allahu.

Ndikimi i kësaj bote tek njerëzit ka qenë e vërtetuar në dhjetë fletushkat e Ibrahimit, në dhjetë fletushkat e Musaut përpos Tevratit.

Kanë vazhduar librat e Allahut që të dokumentojnë se bota tjetër është më e vlefshme, më e çmuar, dhe e përgjithmonshme, në krahasim më këtë botë e cila është e përkohshme.

O besimtarë, këto janë treguar dhe janë përmendur në librat e mëhershme të Ibrahimit dhe të Musaut.

O besimtarë, këto janë sqaruar në librat e mëhershme të Ibrahimit dhe të Musaut.

Pejgamberi a.s. ka thënë: **“Pejgamberët janë vëllezër të nënave të ndryshme dhe e kanë vetëm një fe”.**

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e sures Eala.

SURETU GASHIJE (1)

Suretu Gashije: 1-16

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ ﴿١﴾ وَجُودَ يَوْمِنِذٍ خَاشِعَةٍ ﴿٢﴾ عَامِلَةً نَّاصِبَةٍ ﴿٣﴾ تَصَلَّى نَارًا حَامِيَةً ﴿٤﴾ تُسْقَى مِنْ عَيْنٍ آتِيَةٍ ﴿٥﴾ لَيْسَ لَهُمْ طَعَامٌ إِلَّا مِنْ ضَرِيعٍ ﴿٦﴾ لَا يُسْمِنُ وَلَا يُغْنِي مِنْ جُوعٍ ﴿٧﴾ وَجُودَ يَوْمِنِذٍ نَّاعِمَةٍ ﴿٨﴾ لَسَعِيهَا رَاضِيَةٌ ﴿٩﴾ فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ ﴿١٠﴾ لَا تَسْمَعُ فِيهَا لِأَعِيَةٍ ﴿١١﴾ فِيهَا عَيْنٌ جَارِيَةٌ ﴿١٢﴾ فِيهَا سُرُرٌ مَرْفُوعَةٌ ﴿١٣﴾ وَأَكْوَابٌ مَوْضُوعَةٌ ﴿١٤﴾ وَنَمَارِقُ مَصْفُوفَةٌ ﴿١٥﴾ وَزَرَابِيُّ مَبْثُوثَةٌ ﴿١٦﴾

Në fillim të suretul Gashije përshkruhet kataklizma dhe

Në fillim të suretul Gashije përshkruhet situata e njerëzve në atë ditë.

Suretu Gashije sqaron rëndësinë e ditës së gjykimit ku njerëzit do të ndahen në dy grupe:

- Në fatkeq dhe

- Në fatmirë.

Suretu Gashije tregon llojet e dënimit të banorëve të xhehenemit.

Suretu Gashije tregon se si do të poshtërohen banorët e xhehenemit.

Suretu Gashije tregon se si do të veprohet me banorët e xhehenemit.

Suretu Gashije tregon se si do të pinë ujë banorët e xhehenemit.

Suretu Gashije tregon se si do të ushqehen banorët e xhehenemit.

Esenca e zjarrit të xhehenemit nuk krahasohet me zjarrin e kësaj bote.

Ushqimet e xhehenemit nuk krahasohen me ushqimet e kësaj bote.

Pijet e xhehenemit nuk krahasohen me pijet e kësaj bote.

Zoti i Madhërishëm thotë:

هَلْ أَتَاكَ حَدِيثُ الْغَاشِيَةِ ﴿١﴾

“A të erdhi ty lajmi për belanë që kaplon (kijameti)?” (El-Gashije: 1)

Dita e kataklizmës quhet: Kaplimi, pra, tmerri i tërësishëm.

Dita e kataklizmës quhet: Ngërthimi.

Ajo ditë i tmerron shpirtrat, i dridh zemrat dhe i humbë vetëdijet.

Kataklizma është quajtur “Kaplimi, ngërthimi” sepse i kaplon dhe i ngërthen (i përfshinë) të gjitha krijesat me tmerr, trishtim dhe e ndryshon tërësisht strukturën e botës.

Atëherë njerëzit ndahen në dy grupe:

- Një grup në xhenet.
- Një grup në xhehenem.

Në atë ditë, situata e njerëzve do të bazohet në formimin e dy grupeve:

- Të padëgjueshmit në xhehenem.
- Të dëgjueshmit fatlum në xhenet.

Fillimi me “A të ka ardhur lajmi” tregon atë çka e dridh shpirtin te i referuari atëherë kur ta pranon lajmin.

O pejgamber, a të ka ardhur lajmi për ndodhinë e kataklizmës dhe a e ke mësuar, kuptuar, atë lajm.

Besimtarë të nderuar!

﴿٢﴾ وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ خَاشِعَةٌ

﴿٣﴾ عَامِلَةٌ نَّاصِبَةٌ

﴿٤﴾ تَصَلَّى نَارًا حَامِيَةً

﴿٥﴾ تُسْقَى مِنْ عَيْنٍ آنِيَةٍ

“Atë ditë sheh fytyra të përulura,

Të lodhura e të rraskapitura (nga mundimi).

Ato hyjnë në zjarrin të ndezur fort,

U jepet të pinë prej një kroi të valë.” (El-Gashije: 2-5)

Njeriu, pavarësisht sprovave, asnjëherë në veten e tij nuk mund përjetojë diçka më të vështirë se sa në ditën e kataklizmës.

Njeriu, pavarësisht krizave, asnjëherë në veten e tij nuk mund përjetojë diçka më të vështirë se sa në ditën e kataklizmës.

Njeriu, pavarësisht katastrofave, asnjëherë në veten e tij nuk mund përjetojë diçka më të vështirë se sa në ditën e kataklizmës.

Atëherë njerëzit ndahen në dy grupe:

- Një grup në xhenet.
- Një grup në xhehenem.

Dallimi në mes tyre është i madh.

Informacionet Kur'anore për kataklizmën dhe agoninë e saj janë paralajmërim, që të tregohen të vëmendshëm para se të befasohen nga tmerri i asaj dite.

Në ditën e gjykimit do të ketë njerëz në paraqitje të tyre me fytyra të frikësuar, të ngrysur, të përulura të cilat janë ndryshuar për shkak të dënimit.

Fytyrat e pabesimtarëve janë dërmuar duke punuar për këtë botë dhe janë të lodhura, por puna e tyre nuk ka dhënë rezultat përpos vuajtje e dëshpërim.

Fytyrat e pabesimtarëve janë dërmuar duke punuar për këtë botë dhe janë të lodhura, por puna e tyre nuk ka dhënë rezultat përpos lodhje e mundim.

E përfundimi i tyre është xhehenemi.

Ata nuk kanë qenë të udhëzuar.

Ata në dunja kanë punuar shumë.

Ata e kanë lodhur veten e tyre me adhurime të devijuara, por nuk ka shpërblime për ta, nga shkak se ata kanë qenë të devijuar dhe të humbur.

Besimi në Allahun dhe në të dërguarin e Tij është kusht në pranimin e veprave.

Dënimi i atyre në ditën e gjykimit do të jetë ashtu siç thotë Allahu i Madhërishëm: **“Do të hedhet mbi ta zjarr djegës dhe përvëlues”**. (*Gashije: 4*).

Pra, në ato fytyra do të hedhet zjarr me nxehtësi të madhe, ai zjarr përvëlton, dënon për shkak të dështimit të veprave.

Kur të eten, shërbehen me ujë të përvëluar, pra përvëlton.

Fjala “Anijetun” ka kuptimin e nxehtësisë ekstreme, ai ujë nuk e shuan etjen.

Fjala “Anijetun” nxehtësia maksimale.

Fjala “Hamije” ka kuptimin: Flakëron, përvëlton.

Besimtarë të nderuar!

لَيْسَ لَهُمْ طَعَامٌ إِلَّا مِنْ ضَرِيعٍ ﴿٦﴾

“Ata nuk kanë ushqim tjetër pos një barishte me ferra helmuese.” (*El-Gashije: 6*)

Nuk ka ushqim tjetër me të cilin shërbehen përpos llojit të ushqimit “Darijë”:

Ai ushqim i banorëve të xhehenemit është ushqim i thatë, i ithët dhe i dëmshëm.

“Darijë” është ajo çka mbetet prej zjarrit (hiri i zjarrit).

Pastaj Zoti i Madhërishëm tregon se:

لَا يُسْمِنُ وَلَا يُغْنِي مِنَ جُوعٍ ﴿٧﴾

“Që as nuk jep fuqi, as nuk largon uri.” (*El-Gashije: 7*)

Ky ushqim me të cilin ushqehen, nuk e realizon qëllimin e caktuar.

Ky ushqim nuk e largon të keqen.

Ky ushqim nuk i bënë dobi konsumuesit dhe nuk e shuan urinë.

Ekziston edhe ushqim tjetër për banorët e zjarrit:

- Ushqimi “Gislinë” dhe

- Ushqimi “Zekumë”.

Allahu i Madhërishëm thotë:

وَلَا طَعَامٌ إِلَّا مِنْ غِسْلِينَ ﴿٣٦﴾

“As ushqim tjetër përveç të shpëlarave.” (*El-Hakatu: 36*)

Allahu i Madhërishëm thotë:

إِنَّ شَجَرَتَ الرَّقْمِ ﴿٤٣﴾ طَعَامُ الْآثِمِ ﴿٤٤﴾

“Është e vërtetë se pema e Zekumit. Do të jetë ushqim i mëkatarëve”.
(*Ed-Duhanë: 43-44*)

Besimtarë të nderuar!

Allahu i Madhërishëm, pasi i ka përmendur fytyrat e banorëve të xhehenemit, ka vazhduar dhe i përmend fytyrat e banorëve të xhenetit.

Kjo për të bërë dallimin në mes fytyrave.

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿٨﴾ وَجُوهٌ يَوْمَئِذٍ نَّاعِمَةٌ

لَّسَعِيهَا رَاضِيَةٌ ﴿٩﴾

فِي جَنَّةٍ عَالِيَةٍ ﴿١٠﴾

**“Atë ditë sheh fytyra të ndritshme,
Të kënaqura për veprimet e veta,
Në Xhenet të shkallës së lartë”** (*El-Gashije: 8-10*)

Zoti i madhërishëm thotë:

﴿٧٦﴾ جَنَّاتٌ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَذَلِكَ جَزَاءُ مَنْ تَزَكَّى

“Fytyrat e besimtarëve do të shkëlqejnë, do të rrezatojnë.” (*Taha, 76*)

وَفِي الْأَرْضِ آيَاتٌ لِلْمُؤْمِنِينَ ﴿٢٠﴾

“Në xhenet vendet janë me shtretër komod.” (*Dharijat, 20*)

Në ditën e gjykimit do të ketë fytyra shkëlqyese, rrezatuese.

Në ditën e gjykimit do të ketë fytyra të bukura dhe të ndriçuara.

Vërehet gëzimi dhe mirësia në to.

Vërehet lumturia në to, siç thotë Allahu i Madhërishëm:

تَعْرِفُ فِي وُجُوهِهِمْ نَضْرَةَ النَّعِيمِ ﴿٢٤﴾

“Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë e përjetimeve”. (*El-Mutaffifinë: 24*)

Ato janë fytyrat e të lumturve, atëherë kur ta kuptojnë shpëtimin e tyre.

Ato janë fytyrat e të lumturve, atëherë kur ta kuptojnë suksesin e tyre.

Ato janë fytyrat e të lumturve, atëherë kur ta kuptojnë pranimin e veprave të tyre.

Ai rezultat është për veprimet të cilat i kanë vepruar në dunja, dhe për devotshmërinë e tyre është arritur kënaqësia. Pra veprat e tyre i kanë kënaqë. Kjo nga shkaku se u është dhënë shpërblimi me të cilin janë kënaqur.

Pastaj, Allahu i Madhërishëm përshkruan evenimentin e shpërblimeve, e ai është xheneti, i cili përbëhet nga shumë cilësi, e ato janë:

- Ata të cilët i kanë fytyrat shkëlqyese,
- ata janë besimtarët e lumtur në xhenet,
- ata janë në vende dhe pozita të larta,
- ata janë në nivele të larta,
- ata janë të qetë në dhomat e tyre.

Lartësia e xhenetit:

- Edhe për nga aspekti konkret në vende të larta.
- Edhe për nga aspekti abstrakt, në pozita të larta.

Kjo nga shkaku se në xhenet ka nivele dhe pozita lartë e më lartë, ashtu sikurse në xhehenem ka pozita poshtë e më poshtë.

Zoti i Madhërishëm thotë:

لَا تَسْمَعُ فِيهَا لِأَغْيَةٍ ﴿١١﴾

“Aty nuk dëgjojnë fjalë të pakëndshme.” (El- Gashije, 11)

Në xhenet, nuk dëgohen fjalë banale.

Në xhenet, nuk dëgohen fjalë të kota.

Kjo nga shkaku se ata nuk flasin ndryshe pos me urtësi.

Pastaj e Lavdërojnë Allahun për të mirat me të cilat i ka furnizuar Allahu, me të mirat e përgjithmonshme.

Ata me meritë lavdërojnë dhe falënderojnë në mënyrë të papërshkrueshme me fjalë.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

فِيهَا عَيْنٌ جَارِيَةٌ ﴿١٢﴾

“Aty ka kroje që rrjedhin” (El- Gashije: 12)

- Në xhenet burojnë burime uji, prej të cilit rrjedhin lloje të ndryshme dhe të këndshme të pijeve.

- Në xhenet ekzistojnë burime uji, prej të cilit rrjedhin pije të pastra.

Qëllimi është: “emër i llojit”, pra burime të cilat burojnë dhe rrjedhin.

فِيهَا سُرُرٌ مَّرْفُوعَةٌ ﴿١٣﴾

“Aty kanë shtretër të lartë” (El- Gashije: 13)

- Në xhenet ka shtretër të lartë të shtruar të cilat janë të buta dhe të lëmuara, ato janë shumëkatëshe, të ngritura në lartësi, atëherë kur besimtari do të ulet në të do të kënaqet dhe i sheh bahçet e xhenetit dhe të mirat e saj, siç figuron në ajetin tjetër:

وَفُرُشٌ مَّرْفُوعَةٌ ﴿٣٤﴾

“Edhe shtretër të lartë (ose gra të larta)”. (El-Vakia: 34)

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَأَكْوَابٌ مَّوْضُوعَةٌ ﴿١٤﴾

“Aty kanë gota pa dorëza” (El- Gashije: 14)

- Në xhenet do të ketë “ibrikë”, pra gota për pije, dhe gota të mbushura me alkool jo dehës.

Fjala “Ekvabë”: janë gotat dhe enët si f.v.: ibrikët pa doreza, në formë të kupës.

Fjala “Mevduatu”: janë të gatshme për t’u përdorur dhe për të konsumuar çfarëdo pije.

Të gjitha këto janë të përgatitura dhe qëndrojnë pranë tyre, i konsumojnë kur të dëshirojnë.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَنَمَارِقُ مَصْفُوفَةٌ ﴿١٥﴾

وَزَرَائِي مَبْثُوثَةٌ ﴿١٦﴾

“Edhe jastëkë të renduar për mbështetje,

Edhe qilima të shtruar.” (*El-Gashije: 15, 16*)

Aty do të kenë jastëkë të butë dhe komplete për t’u ulur ose për t’u mbështetur në to.

Do të ketë shtroja të rrafshëta për kuvendim.

Pastaj qilima të butë dhe të lëmuar, të përgatitura për kuvendime, për të qëndruar në to dhe për t’u kënaq syri me ato orendi.

Aty do të ketë orendi dhe dizajnime me bukuri madhështore.

Fjala “Nemariku”: jastëk dhe mbështetëse. Ato janë të buta dhe të përshtatshme për t’u mbështetur.

Fjala: “Mebthuthe” qilima të llojllojshme dhe të shumta.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Gashije.

SURETU GASHIJE (2)

Suretu Gashije: 17-26

أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ ﴿١٧﴾ وَإِلَى السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ ﴿١٨﴾ وَإِلَى الْجِبَالِ
كَيْفَ نُصِبَتْ ﴿١٩﴾ وَإِلَى الْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ ﴿٢٠﴾ فَذَكِّرْ إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ ﴿٢١﴾ لَسْتَ
عَلَيْهِمْ بِمُصِيطِرٍ ﴿٢٢﴾ إِلَّا مَنْ تَوَلَّى وَكَفَرَ ﴿٢٣﴾ فَيُعَذِّبُهُ اللَّهُ الْعَذَابَ الْأَكْبَرَ ﴿٢٤﴾ إِنَّ إِلَيْنَا
إِيابُهُمْ ﴿٢٥﴾ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ ﴿٢٦﴾

Në pjesën e dytë të suretu Gashije Zoti i Madhërishëm përshkruan dukuritë e plotfuqisë së Tij ku thotë:

أَفَلَا يَنْظُرُونَ إِلَى الْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ ﴿١٧﴾

“A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar?” (El-Gashije, 17)

Atëherë kur Allahu i ka përshkuar të mirat e xhenetit, të devijuarit janë çuditur me atë përshkrim. Për këtë arsye, Allahu ka zbritur ajetet:

“A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar?” (El-Gashije, 17)

Kjo tufë e argumenteve për ekzistimin e Zotit, ashtu që:

- Njerëzit të meditojnë në Njëshmërinë e Tij,
- Të impresionohet me krijimtarinë e tyre dhe
- Të besojnë në fuqinë absolute të Tij,
- Le të udhëzohen në besimin e botës tjetër:

Kjo tufë e argumenteve për ekzistimin e Zotit, ashtu që:

- Njerëzit t'i analizojnë dhe të impresionohen me krijimtarinë e tyre,
- Njerëzit le të udhëzohen në besimin e botës tjetër.

Është parashtruar pyetja:

Si ka mundësi që idhujtarët ta mohojnë ringjalljen përderisa ata e shohin devenë e cila është prej kafshëve shtëpiake më të mëdha në hapësirën ku jetojnë!?

Si ka mundësi që idhujtarët ta konsiderojnë si çështje absurde ringjalljen, përderisa ata e shohin devenë e cila është dhe prej krijesave më të mëdha në hapësirën ku jetojnë!?

Si nuk e shohin se si Allahu e ka krijuar në mënyrë të mrekullueshme, me trup të madh, me fuqi të madhe, me cilësi fantastike!?

Deveja është krijesë impresionuese, me konstrukt të rrallë.

Paralelisht kësaj ajo bëhet e butë dhe bartë barrë të rëndë.

Devenë e menaxhon fëmija i vogël.

Devesë i konsumohet ushqimi pasi të prehet.

Shfrytëzohen eshtrat e saj.

Shfrytëzohet qumështi i saj, lëkura e saj, e kështu me radhë.

Pastaj, ajo i përballon kushteve të rënda atmosferike, i duron etjes dhe urisë.

- Zoti i Madhërishëm ka kërkuar prej tyre të meditojnë në kafshët me forma të mëdha dhe të ndryshme siç janë devetë, me trup të madh, e deri te kafshët me trup të vogël.

- Zoti i Madhërishëm kërkon prej ateistëve, laicistëve, që të meditojnë në kafshët me forma të mëdha dhe të ndryshme siç janë devetë, me trup të madh e deri te kafshët me trup të vogël.

Besimtarë të nderuar!

Është parashtruar pyetja:

وَالْيَ السَّمَاءِ كَيْفَ رُفِعَتْ ﴿١٨﴾

“Edhe qiellin se si është ngritur lart!” (*El-Gashije: 18*)

Ky është një argument tjetër:

Si ka mundësi që idhujtarët ta mohojnë ringjalljen përderisa ata e shohin qiellin e lartë.

- A nuk e shohin qiellin se si është i ngritur lartë, mbi tokën dhe pa shtylla!?

Allahu i Madhërishëm, ka paraqitur argumente të shumta kundër atyre të cilët nuk e besonin mundësinë e ringjalljes së trupave pas vdekjes ashtu që u ka përkufizuar në shumë vende shembuj të krijesave:

- Kërkon prej tyre që t'i kushtojnë vëmendje dhe të bëjnë analiza në çështjet konkrete të cilat i rrethojnë ato, duke filluar me madhësinë dhe lartësinë e qiellit dhe çka ka në të prej yjeve madhështorë.

Besimtarë të nderuar!

Është parashtruar pyetja:

وَإِلَى الْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ ﴿١٩﴾

“Edhe kodrat se si janë venduar!” (*El-Gashije: 19*)

- A nuk po i shohin kodrat e mëdha dhe të larta të vendosura në tokë. Ato janë të rrënjosura, që të mos zgjatet toka me banorët e saj gjatë rrotullimit të saj?

- Kërkon prej tyre të meditojnë në kodrat të cilat janë të rrënjosura dhe të ngritura lartë për të stabilizuar tokën dhe banorët e gjallesat të cilat jetojnë në ta.

Besimtarë të nderuar!

Është parashtruar pyetja:

وَإِلَى الْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ ﴿٢٠﴾

“Edhe tokën se si është shtruar!” (*El-Gashije: 20*)

- Kërkon prej tyre të meditojnë tokën e cila është e përshtatshme për të qëndruar mbi të.

Kërkon prej tyre të meditojnë tokën në të cilën jetohej me lehtësi.

Ai i Cili ka mundësi t'i krijon këto elemente, po ai ka mundësi që njerëzit t'i (ri)krijon edhe njëherë për të dhënë llogari.

Ai i Cili ka mundësi t'i krijon këto elemente tjera, po ai ka mundësi që njerëzit t'i ringjallë për t'i shpague.

- A nuk po e shohin tokën se si e keni rrafshuar, si e kemi shtruar dhe si e kemi përgatitur për të jetuar në të, ashtu që njerëzit të jetojnë të sigurt në të, dhe t'i shfrytëzojnë të mirat e saj dhe xehet e saj?

Po ashtu bënë që të zhvillohen bimët, drithërat dhe pemët e llojllojshme, në të sigurohet jeta dhe ekzistenca.

Sipërfaqja e rrafshët e tokës është për t'u shikuar, për t'u analizuar nga afër dhe për t'u jetësuar në të gjitha hapësirat e saj. Kjo nuk nënkupton se ajo nuk është e rrumbullakët (geoide). Kjo nga shkak se, siç e ka treguar Raziu, nëse është ekstrem e madhe, atëherë pjesët e saj duken të rrafshëta.

Janë përmendur këto krijesa dhe jo të tjerat, sepse ato janë elementet më të afërta të njeriut për t'i medituuar dhe për t'i analizuar.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

فَذَكِّرْ إِنَّمَا أَنْتَ مُذَكِّرٌ ﴿٢١﴾

“E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues,” (*El-Gashije: 21*)

Allahu i Madhërishëm e ka urdhëruar peygamberin e Tij për të këshilluar me këta argumente dhe me fakte konkrete, ku i thotë: “Këshillo”, pra, o peygamber,

këshilloji njerëzit me atë për çka je dërguar,

udhëzoji dhe paralajmëroji,

inspiroji për t’i analizuar këto dukuri të cilat paraqesin fuqinë e Zotit për çdo gjë, po ashtu paraqesin fuqinë e Allahut për ringjalljen e njerëzve dhe kthimin e tyre te Zoti.

Njëkohësisht edhe ty të thotë:

O besimtar, këshillo për t’i analizuar këto dukuri të cilat paraqesin fuqinë e Zotit për çdo gjë, po ashtu paraqesin fuqinë e Allahut për ringjalljen e njerëzve dhe kthimin e tyre te Zoti.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

لَسْتَ عَلَيْهِمْ بِمُصَيِّرٍ ﴿٢٢﴾

“Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!” (*El-Gashije: 22*)

O Muhamed, ti e ke për detyrë vetëm të këshillosh, sepse ti je i dërguar për këtë qëllim.

O Muhamed, Nuk ke pushtet dhe nuk ke sundim mbi ta ashtu që t’i detyrosh të besojnë në Allahun Zotin Një të pa ortak.

O besimtar, ti nuk ke pushtet dhe nuk ke sundim mbi ta për t’i detyruar për të besuar.

- Nëse besojnë, e kanë gjetur rrugën e drejtë.

- Nëse kundërshtojnë, ata kanë mohuar, kanë devijuar dhe kanë humbur.

Përfundim

Mirëpo, ai i cili kundërshton këshillën dhe nuk i pranon këshillat, mohon me gjuhën dhe me zemër, Allahu, në botën tjetër do ta dënon me dënimin e xhehenemit të përgjithmonshëm.

إِلَّا مَنْ تَوَلَّى وَكَفَرَ ﴿٢٣﴾

فَيُعَذِّبُهُ اللَّهُ الْعَذَابَ الْأَكْبَرَ ﴿٢٤﴾

“Përveç atij që zmbapset e nuk beson,

All-llahu atë me vuajtje e dënon.” (El-Gashije: 23, 24)

Ai i cili refuzon udhëzimin, mohon me gjuhën dhe me zemër, Allahu, në botën tjetër do ta dënon me dënimin e xhehenemit të përgjithmonshëm. Kjo nga shkaku se nëse nuk ke pushtet ndaj tyre, atëherë Allahu i ka nën kontroll, ata nuk mund të dalin nga sundimi dhe nga fuqia e Allahut.

Allahu i Madhërishëm ka konfirmuar edhe njëherë çështjen e ringjalljes, llogaridhënies dhe dënimit, pavarësisht asaj se idhujtarët e besojnë apo nuk e besojnë.

Vendimi i Zotit është i prerë në këtë drejtim, e ajo është: Kthimi dhe përfundimi është te Zoti, pastaj Ne do t'i gjykojmë për veprat e tyre pasi të ktheheni te Zoti.

Me fjalë tjera pas ringjalljes.

- Nëse kanë vepruar mirë, shpërblehen.
- Nëse kanë bë keq, dënohen.

Kundërshtuesit nuk mund të ikin.

Përgënjeshtresit nuk mund t'i shpëtojnë dënimit.

Fjala “Dënim i madh”: është dënimi i botës tjetër, kjo nga shkaku se ata janë dënuar në këtë botë me uri, vrasje, e kështu me radhë.

Përfundim

إِنَّ إِلَيْنَا إِيَابُهُمْ ﴿٢٥﴾

ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُمْ ﴿٢٦﴾

“Vetëm te Ne kthimin e kanë.

Dhe vetëm detyrë Jona është llogaira e tyre.” (*El-Gashije: 25, 26*)

Rikonfirmimi i ndodhisë së ringjalljes është argument se askush nuk mund t’i ikë zbatimit të ligjit të drejtësisë.

Rikonfirmimi i ditës së gjykimit është argument se askush nuk mund t’i shpëton veprës.

Nuk është drejtësi dhe as barazi dhe as e logjikshme që të barazohet i miri me të keqin, i drejti me kriminelin, besimtari me pabesimtarin.

- Kush beson dhe dëgjon, meriton të vlerësohet, të çmohet dhe të shpërblehet.

- Kush e mohon dhe bën mëkate, ai do të dënohet me dënim meritore, sepse vet e ka përzgjedhur atë dënim me veprat e tij në dunja.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Gashije.

SURETU FEXHR (1)

Suretu Fexhr: 1-8

وَالْفَجْرِ ﴿١﴾ وَلَيَالٍ عَشْرٍ ﴿٢﴾ وَالشَّفْعِ وَالْوَتْرِ ﴿٣﴾ وَاللَّيْلِ إِذَا يَسْرِ ﴿٤﴾ هَلْ فِي ذَلِكَ قَسَمٌ
لِّذِي حِجْرِ ﴿٥﴾ أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ ﴿٦﴾ إِرَمَ ذَاتِ الْعِمَادِ ﴿٧﴾ الَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلُهَا
فِي الْبِلَادِ ﴿٨﴾

Prej ligjeve të prera të Zotit është:

- Shpërblimi i besimtarëve është meritore dhe i drejtë.
- Dënimi për pabesimtarët është i drejtë dhe përfundimtar.

Kjo, për t'u realizuar ligji i drejtësisë dhe barazisë në mes njerëzve dhe për të respektuar parimet dhe të drejtën ligjore.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالْفَجْرِ ﴿١﴾

وَلَيَالٍ عَشْرٍ ﴿٢﴾

“Pasha agimin!

Pasha dhjetë netët!” (*El-Fexhr: 1, 2*)

Betohem në kohën e agimit, apo në kohën e mëngjesit kur të paraqitet drita dhe fillon dita.

Betohem në dhjetë netët e fillimit të çdo muaji hënorë, e prej tyre në dhjetë netët e para të dhil Hixhes.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالشَّفْعِ وَالْوَتْرِ ﴿٣﴾

وَاللَّيْلِ إِذَا يَسْرِ ﴿٤﴾

هَلْ فِي ذَلِكَ قَسَمٌ لِّذِي حِجْرِ ﴿٥﴾

“Pasha çiftin dhe pasha tekun!

Pasha natën që shkon!

A janë këto betime për të mençurin?” (*El-Fexhr, 3-5*)

Betohet në çiftin dhe tekun e atyre netëve dhe të çdo sendi.

Betohet në natën e cila afrohet dhe errësohet, pastaj shkon dhe largohet.

Arsyeja e betimit:

Përgjigja e betimit: Është e anuluar retorikisht: “Pa dyshim se do të ringjallen!”.

A nuk mjaftojnë të gjitha këto betime në këto çështje madhështore për çdo njeri të mençur apo të logjikshëm.

Fjala “Hixhr” ka kuptim: të mendjes, të logjikës, të asaj çka është racionale.

Kuptimi:

Le të merr mësim çdo njeri i mençur, le t’i shikon ajetet e Allahut të Madhërishëm.

Le të merr mësim çdo njeri racional, le t’i shikon ajetet e Allahut të Madhërishëm.

Pastaj,

Allahu i Madhërishëm tregon se çka ju ka ndodhur popujve pabesimtarë.

Allahu i Madhërishëm tregon se si Allahu i ka dënuar dhe i ka shkatërruar.

Besimtarë të nderuar!

Suretu Fexhr tregon për tri lloje të kriminelëve:

- Populli Adë i Hudit a.s.
- Populli Themud i Salihut dhe
- Populli i Firaunit te rasti me Musain a.s.

Këto janë pakti i kriminelëve.

Përballë këtij pakti janë pakti i pejgamberëve, respektivisht përballë:

Hudi a.s. përballë popullit Adë;

Salihu a.s. përballë popullit Themud;

Musai a.s. përballë Firaunit.

Mirësi dhe mëshirë e Zotit është se na tregon shembuj të dënimit të pabesimtarëve në këtë botë, ashtu që kriminelin të heqë dorë të mos i torturoj dhe të mos i maltretoj besimtarët për shkak të besimit të tyre.

Vëllezër të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ ﴿٦﴾

إِرمَ ذَاتِ الْعِمَادِ ﴿٧﴾

الَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلُهَا فِي الْبِلَادِ ﴿٨﴾

“A nuk e di ti se ç'bëri Zoti yt me Ad-in?

Me banorët e Iremit me ndërtesa të larta?

Që si ata (populli Ad) nuk është krijuar askush në tokë!” (*El-Fexhr: 6-8*)

O njeri, po a nuk e di se si Allahu e ka shkatërruar fisin e parë të Adit, të cilët banonin në qytetet e shpellave.

Ato qytete ishin në gadishullin arabik.

Po ashtu edhe të atij vendbanimi me emër tjetër, të quajtur: “Ireme”, të cilët kishin ndërtesa të larta.

Kjo është metaforë për jetën luksoze dhe me gjendje të mirë ekonomike, dhe në kohën e tyre, nga të gjitha vendet tjera të ndryshme nuk mund të krahasohej me zhvillimin e tyre.

Fjala “Ireme” ka të bëjë më konkretisht për fisin Adë, te i cili ishte dërguar peygamberi Hudë a.s.

Sot do të flasim për popullin e Adë të Hudit a.s.

Pas Ademit a.s. deri te Nuhu a.s., njerëzimi ishte besimtarë.

Në kohën e Nuhut a.s. për herë të parë është shfaqë politeizmi dhe paganizmi.

Pastaj Zoti i Madhërishëm i dënoi me vërshimën interkontinentale, ku u zhdukën të gjithë përpos besimtarëve të cilët ishin në Anije me Nuhun a.s.

Pastaj, besimtarët u shpërndanë nëpër tokë.

Nga paraardhësit besimtarë u formuan politeistët, e këta politeist ishin politeistët e parë pas Nuhut a.s.

Këta politeist ishin të fisit Adë, me një fjalë të popullit Adë. Kështu pra, populli Adë ka qenë populli parë i cili ka qenë politeist pas Nuhut a.s.

Populli i Ad-it përbëhej prej njëzetetë fisesh. Emri i këtij populli, i është dhënë nga nipi i Nuhut a.s., Adi.

Thuhet se këta kanë jetuar përafërsisht tetëqind vjet pas Nuhut a.s.

Vëllezër të nderuar!

Populli Adë specifikohet me disa specifika të asaj kohe, prej më të njohurave janë:

1. Populli Adë ishte superfuqi e asaj kohe.
 2. Populli Adë ishin idhujtarë dhe paganë.
 3. Populli Adë kanë qenë kriminel dhe arrogant.
 4. Populli Adë në vend se të pasonin peygamberët, pasonin kriminelët.
- Këto janë katër specifikat me të cilat janë dalluar populli Adë.

Vëllezër të nderuar!

Sa i përket specifikës së parë: Populli Adë ishte superfuqi e asaj kohe.

Populli Adë ka qenë popull me zhvillim të lartë ekonomik. Zoti i Madhërishëm tregon ku thotë:

“Iremi (populli Irem) të cilit kishin ndërtesa të larta.”

Fjala “Ireme” ka të bëjë më konkretisht për fisin Adë, te i cili ishte dërguar peygamberi Hudë a.s.

Civilizim i paparë i asaj kohe. Nuk ka pas të ngjashëm në vendet tjera.

Siç thotë Zoti i Madhërishëm:

أَتَبْنُونَ بِكُلِّ رِيعٍ آيَةً تَعْبَثُونَ ﴿١٢٨﴾

“A në çdo bregore ngritni ndonjë shtëpi (ndërtesë) sa për lojë?”
(Shuara, 128)

Kjo është për jetën luksoze dhe me gjendje të mirë ekonomike. Në kohën e tyre, nga të gjitha vendet tjera të ndryshme askush nuk mund të krahasohej me zhvillimin e tyre.

Vëllezër të nderuar!

Sa i përket specifikës së dytë, ata janë dalluar me idhujtari dhe paganizëm edhe pse paraardhësit i kishin besimtarë.

Ajo çka është për t’u habitur është se pretendonin se feja e tyre idhujtare është fe e të parëve të tyre. Ashtu sikurse sot që pretendojnë të kthehemi në fenë e të parëve tanë kur dihet se të parët tanë kanë qenë besimtarë qoftë prej Ademit a.s., qoftë prej Nuhut a.s., qoftë edhe prej baballarëve tanë.

Vëllezër të nderuar!

Sa i përket specifikës së tretë, ata kanë qenë kriminelë dhe arrogant.

فَأَمَّا عَادُ فَاسْتَكْبَرُوا فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَقَالُوا مَنْ أَشَدُّ مِنَّا قُوَّةً أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّ اللَّهَ الَّذِي خَلَقَهُمْ هُوَ أَشَدُّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَكَانُوا بِآيَاتِنَا يَجْحَدُونَ ﴿١٥﴾

“Sa i përket popullit të Ad-it, ata u treguan arrogantë në Tokë dhe, pa kurrfarë të drejte, thoshin: “Kush është më i fortë se ne?” Vallë, a nuk e dinin ata se Allahu që i kishte krijuar, është më i fuqishëm se ata?! Kështu, ata i mohuan shpalljet Tona.” (*Fussilet, 15*)

Ata e tepruan në luks dhe filluan të shtypnin të dobëtit, duke u bërë njerëz tiranë e të padrejtë.

Populli i Adit vazhdonte ta tepronte çdo ditë e më shumë, në padrejtësi, mosbindje dhe mizori.

Pra, zemrat u ishin ngurtësuar aq shumë, sa mizoritë e tyre kishin arritur kulmin.

وَتَتَّخِذُونَ مَصَانِعَ لَعَلَّكُمْ تَخْلُدُونَ ﴿١٢٩﴾

“E kur rrëmbeni, rrëmbeni mizorisht”. (*Shuara, 129*)

Pra, Nuhu ju ka thënë se Uzoti fuqisë suaj u ka shtuar fuqi, mos e keqpërdorni atë foecë e të bëheni mëkatarë!

قَالُوا يَا هُوْدُ مَا جِئْتَنَا بِبَيِّنَةٍ وَمَا نَحْنُ بِتَارِكِي آلِهَتِنَا عَنْ قَوْلِكَ وَمَا نَحْنُ لَكَ بِمُؤْمِنِينَ ﴿٥٣﴾

“Ata thanë: "O Hud, ti nuk na solle ndonjë argument, e ne nuk i braktisim zotat tanë për fjalën tënde dhe ne nuk të besojmë ty". (*Hud, 53*)

أَوْعَجِبْتُمْ أَنْ جَاءَكُمْ ذِكْرٌ مِّن رَّبِّكُمْ عَلَى رَجُلٍ مِّنكُمْ لِيُنذِرَكُمْ ۖ وَاذْكُرُوا إِذْ جَعَلَكُمْ خُلَفَاءَ مِن بَعْدِ قَوْمِ نُوحٍ وَزَادَكُمْ فِي الْخَلْقِ بَسْطَةً ۖ فَاذْكُرُوا آلَاءَ اللَّهِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٦٩﴾

“Përkujtoni kur Ai ju bëri sundues pas popullit të Nuhut dhe ju shtoi fuqinë fizike.” (*Earaf, 69*)

Ky referim në këtë ajet është referim për popullin e Hudit.

Njerëz gjigant të gjatë sikurse pemët, sikurse trugu e i hurmave. Tek ne e përdorim shprehjen se kanë pas shtatin sa një plep, mirëpo jo vetëm për shkak të gjatësisë, por kanë qenë edhe njerëz të gjatë edhe të fuqishëm.

Kanë qenë kriminelë dhe arrogantë. Populli Adë me kriminalitetin e tyre kanë tejkaluar çdo cak, janë rebeluar, janë egërsuar me forcën e tyre.

Populli Adë me pabesimin e tyre janë treguar arrogantë.

Janë krekosur me mëkatet e tyre dhe me padrejtësitë e tyre kanë shkaktuar shkatërtime.

Vëllezër të nderuar!

Sa i përket specifikës së katërt.

Populli Adë në vend se të pasonin pejgamberët, pasonin kriminelët.

“Adi”, populli i Hudit i kanë përgënjeshtuar pejgamberët e tyre.

Përfundim

Çka i ka ndodhë popullit Ad?

Zoti atyre u ka dërguar një erë të fortë, me zë trishtues dhe të ftohtë.

Era e fortë e pandërprerë ka shkaktuar mallkimin e vetes së tyre.

Ajo erë e ftohtë me zë trishtues nuk i ka shkatërruar dhe nuk i ka dërmuar menjëherë.

Ajo gjendje mjeruese ka vazhduar deri sa u është afruar zjarri.

Njerëzit binin të vdekur në tokë ashtu siç bien palmat me rrënjët e tyre.

Njerëzit binin në tokë dhe bëheshin sikur të ishin kufoma të kalbura prej kohës, apo pjesë të kalbura të palmave të kamotshme.

Pra, ato pjesë janë shkëputur dhe janë shpërndarë nga trupi i njeriut ashtu siç shpërndahen degët dhe gjethet e palmave.

تَنْزِعُ النَّاسَ كَأَنَّهُمْ أَعْجَازُ نَخْلٍ مُنْقَعِرٍ ﴿٢٠﴾

“I ngriste njerëzit si të ishin trupa hurmash të shkulura”. (Kamer: 20)

Ndërsa Adi është shkatërruar me një erë të fortë, të pakufishme.

وَأَمَّا عَادٌ فَأُهْلِكُوا بِرِيحٍ صَرْصَرٍ عَاتِيَةٍ ﴿٦﴾

سَخَّرَهَا عَلَيْهِمْ سَبْعَ لَيَالٍ وَثَمَانِيَةَ أَيَّامٍ حُسُومًا فَتَرَى الْقَوْمَ فِيهَا صَرْعَى كَانَهُمْ أَعْجَازُ نَخْلٍ خَاوِيَةٍ

﴿٧﴾

“Atë Ai e lëshoi kundër tyre shtatë net e tetë ditë rresht, kur shihje njerëzit në to të rrëzuar si të ishin trupa hurmash të zgavruara.” (Haka: 6,7)

Këtu referimi është për popullin Hud pas Nuhut a.s.

مَا لَهُ مِنْ دَافِعٍ ﴿٨﴾

يَوْمَ تَمُورُ السَّمَاءُ مَوْرًا ﴿٩﴾

“Adi përgënjeshtroi, e çfarë ishte ndëshkimi Im dhe kërcënimi?

Atyre Ne në një ditë fatkeqe të përjetshme u lëshuam një erë të fortë.” (Et-Turë: 18, 19)

وَأَمْدَدْنَاهُمْ بِفَاكِهَةٍ وَلَحْمٍ مِّمَّا يَشْتَهُونَ ﴿٢٢﴾

“I ngriste njerëzit si të ishin trupa hurmash të shkullura.” (Et-Turë: 22)

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e pjesës së parë të sures Fexhr.

SURETU FEXHR (2)

Suretu Fexhr: 9-14

وَتَمُودَ الَّذِينَ جَابُوا الصَّخْرَ بِالْوَادِ ﴿٩﴾ وَفِرْعَوْنَ ذِي الْأَوْتَادِ ﴿١٠﴾ الَّذِينَ طَعَوْا فِي الْبِلَادِ ﴿١١﴾
فَأَكْثَرُوا فِيهَا الْفَسَادَ ﴿١٢﴾ فَصَبَّ عَلَيْهِمْ رَبُّكَ سَوْطَ عَذَابٍ ﴿١٣﴾ إِنَّ رَبَّكَ لَبِالْمِرْصَادِ ﴿١٤﴾

Prej ligjeve të prera të Zotit është:

- Shpërblimi i besimtarëve është meritore dhe i drejtë,
- Dënimi për pabesimtarët është i drejtë dhe përfundimtar.

Kjo për t'u realizuar ligji i drejtësisë dhe barazisë në mes njerëzve dhe për të respektuar parimet dhe të drejtën ligjore.

Besimtarë të nderuar!

Suretu Fexhr tregon për tri lloje të kriminelëve:

- Populli Adë i Hudit a.s.
- Populli Themud i Salihut dhe
- Populli i Firaunit te rasti me Musain a.s.

Këta janë pakti i kriminelëve.

Përballë këtij pakti janë pakti i peygamberëve, respektivisht:

- Hudi përballë popullit Adë;
- Salihut Përballë popullit Themud;
- Musai a.s. përballë Firaunit.

Mirësi dhe mëshirë e Zotit është të na tregon shembuj të dënimit të pabesimtarëve në këtë botë, ashtu që kriminelin të heqë dorë ngarkimi dhe që të beson besimtari.

Sot do të flasim për popullin e Salihut a.s. dhe të Firaunit pasi kemi shpjeguar për popullin e Hudit a.s.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَتَمُودَ الَّذِينَ جَابُوا الصَّخْرَ بِالْوَادِ ﴿٩﴾

“Dhe me Themudin, të cilët shpuan shkëmbinj në luginën (kura)”. (El-Fexhr: 9)

A e di se çka ka vepruar Allahu me popullin e Salihut a.s., ata të cilët kanë çelë shpella në kodrina dhe me gurë kanë ndërtuar shtëpi për të jetuar në to, pastaj edhe pallate të larta (gjigante).

Hixhr: është vend në mes të Shamit (Sirisë) dhe Hixhazit.

Hixhr: kodrinë me vendbanime.

Se si Allahu i ka dënuar dhe i ka shkatërruar.

Kjo, për t'i paralajmëruar duke sqaruar se ngjashëm mund të ju ndodhë atyre.

Vëllezër të nderuar!

Themudi dhe Adi përgënjeshtroan kijametin.

Sa i përket Themudit, ata u shkatërruan me krismë të tmerrshme.

كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِالنُّذُرِ ﴿٢٣﴾

فَقَالُوا أَبَشَرًا مِّنَّا وَاحِدًا نَّتَّبِعُهُ إِنَّا إِذَا لَفِي ضَلَالٍ وَسُعُرٍ ﴿٢٤﴾

أَلْقَى الذِّكْرُ عَلَيْهِ مِن بَيْنِنَا بَلْ هُوَ كَذَّابٌ أَشْرٌ ﴿٢٥﴾

سَيَعْلَمُونَ غَدًا مِّنَ الْكَذَّابِ الْأَشْرِ ﴿٢٦﴾

إِنَّا أَرْسَلْنَا النَّاقَةَ فِتْنَةً لَهُمْ فَارْتَبِعْهُمْ وَاضْطَبِرْ ﴿٢٧﴾

وَبَيَّنَّهُم أَنَّ الْمَاءَ قِسْمَةٌ بَيْنَهُمْ كُلُّ شِرْبٍ مُحْتَضَرٌ ﴿٢٨﴾

فَنَادَوْا صَاحِبَهُمْ فَتَعَاطَى فَعَقَرَ ﴿٢٩﴾

فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذُرٍ ﴿٣٠﴾

إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ صَيْحَةً وَاحِدَةً فَكَانُوا كَهَشِيمِ الْمُحْتَظِرِ ﴿٣١﴾

“Themudi përgënjeshtroi të dërguarit.”

E thanë: “A të shkojmë pas një të vetmit njeri që doli nga mesi ynë, po Ne atëherë do të jemi të humbur në një marrësi!”

A, atij nga mesi jonë iu dha shpallja? Jo, por ai është një gënjeshtar mendjemadh.

Mirëpo ata nesër do të kuptojmë se kush është gënjeshtari, mendjemadhi!

Ne atyre do t'ua dërgojmë devenë si sprovë e ti vetëm priti dhe bën durim.

Dhe lajmëroji ata se uji është i ndarë për ta veç e veç, secili do të paraqitet për të pirë ujë në rendin e vet.

Po ata e ftuan shokun e vet, e ai mori dhe e theri atë.

E çfarë ishte ndëshkimi ndëshkimi Im dhe kërcënimi Im?

Ne lëshuam kundër tyre një ushtimë, e ata u bënë si shtrojë vathi. (Mbeturinë e ushqimit të kafshëve që u shtohet)." (El-Kamer: 23-31)

Vëllezër të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

وَفَرَعُونَ ذِي الْأَوْتَادِ ﴿١٠﴾

الَّذِينَ طَعَوْا فِي الْبِلَادِ ﴿١١﴾

فَأَكْثَرُوا فِيهَا الْفَسَادَ ﴿١٢﴾

"Dhe me faraonin i fortifikuar me tenda (ushtarake)!

Të cilët e tepruan me krime në tokë.

Dhe në të shtuan shkatërrimin." (El-Fexhr: 10-12)

A e di se si ka vepruar Allahu me kriminelin firaun i cili ishte udhëheqës i Egjiptit në kohën e Musait a.s.

I cili kishte pallate gjigante, stabile, të ndërtuara si shtylla me themele të forta në tokë,

E, prej tyre edhe piramidat të cilat i ka ndërtuar firauni që të ishin varreza të tyre.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

فَصَبَّ عَلَيْهِمْ رَبُّكَ سَوْطَ عَذَابٍ ﴿١٣﴾

إِنَّ رَبَّكَ لَبِالْمِرْصَادِ ﴿١٤﴾

"E All-llahu kundër tyre lëshoi llojloj dënimesh.

Pse Zoti yt është që përcjell (u rri në pritë)." (El-Fexhr: 13, 14)

Allahu i Madhërishëm, në vazhdimësi i ka goditur me lloje të ndryshme të dënimeve. Kjo i ngjason kërbaçit i cili shkakton dhembje, i cili përdoret për të zbatuar dënimin.

Thënia e Allahut: “Fe sabbe” kjo fjalë përdoret për shkopin (goditje me shkop). Nga shkak se godet me shpejtësi.

O ju të cilëve po ju adresohem, shikoni se si janë paralajmëruar dhe se si janë ndëshkuar.

Fjala “Paralajmërimet” është shumës i fjalës “Paralajmërim”.

Adi, Themudi dhe Firauni i kanë tejkaluar kufijtë në vendet e tyre.

Allahu i Madhërishëm, në vazhdimësi i ka goditur me lloje të ndryshme të dënimeve.

Ata të cilët i përmendëm janë: Adi, Themudi, Firauni, të cilët i kanë tejkaluar kufijtë në vendet e tyre. Ata me kriminalitetin e tyre kanë tejkaluar çdo cak, janë rebeluar, janë egërsuar, me forcën e tyre janë treguar arrogantë dhe me pabesimin e tyre, me mëkatet e tyre dhe me padrejtësitë e tyre kanë shkaktuar shkatërrime.

Përfundim

Allahu i monitoron krimet e tyre dhe e sheh çdo vepër të njeriut.

Allahut nuk mund t’i ikë asgjë, pastaj për të mirën shpërblen mirë, ndërsa për të keqen dënon keq.

Nuk anashkalon asgjë sa do të që jetë e vogël.

Fjala “Mirsad” e ka kuptimin e bazës së monitorimit.

Monitoron fjalët e çdo folësi dhe

Monitoron veprat e çdo vepruesi.

Historia e shkatërrimit të këtyre popujve përsëritet. Kjo për t’i rikujtuar me qëllim që të merret këshillë dhe mësim prej tyre.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e pjesës së dytë të sures Fexhr.

SURETU FEXHR (3)

Suretu Fexhr: 15-30

فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ﴿١٥﴾ وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهَانَنِ ﴿١٦﴾ كَلَّا بَلْ لَا تُكْرِمُونَ الْيَتِيمَ ﴿١٧﴾ وَلَا تَحَاضُونَ عَلَى طَعَامِ الْمُسْكِينِ ﴿١٨﴾ وَتَأْكُلُونَ التُّرَاثَ أَكْلًا لَمًّا ﴿١٩﴾ وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا ﴿٢٠﴾ كَلَّا إِذَا دُكَّتِ الْأَرْضُ دَكًّا دَكًّا ﴿٢١﴾ وَجَاءَ رَبُّكَ وَالْمَلَكُ صَفًّا صَفًّا ﴿٢٢﴾ وَجِيءَ يَوْمَئِذٍ بِجَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ يَتَذَكَّرُ الْإِنْسَانُ وَأَنَّى لَهُ الذِّكْرَى ﴿٢٣﴾ يَقُولُ يَا لَيْتَنِي قَدَّمْتُ لِحَيَاتِي ﴿٢٤﴾ فَيَوْمَئِذٍ لَا يُعَذِّبُ عَذَابُهُ أَحَدٌ ﴿٢٥﴾ وَلَا يُوثِقُ وَثَاقَهُ أَحَدٌ ﴿٢٦﴾ يَا أَيُّهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ ﴿٢٧﴾ ارْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً ﴿٢٨﴾ فَادْخُلِي فِي عِبَادِي ﴿٢٩﴾ وَادْخُلِي جَنَّتِي ﴿٣٠﴾

Njeriu nuk i kushton vëmendje këshillave të tjerëve.

Njeriu nuk i kushton vëmendje eksperiencave të tjerëve.

Njeriu nxiton në çështje:

- Kur Allahu i jep të mira kënaqet dhe qetësohet.

- Kur Allahu ia mbulon me fjalë tjera ia pengon ato mirësi, ose e godet me fatkeqësi, ai ankohet dhe rënkon.

Kjo është e qartë dhe vërehet në natyrshmërinë e njeriut në këtë botë.

Zoti i Madhërishëm thotë:

فَأَمَّا الْإِنْسَانُ إِذَا مَا ابْتَلَاهُ رَبُّهُ فَأَكْرَمَهُ وَنَعَّمَهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَكْرَمَنِ ﴿١٥﴾

**“E njeriu, kur e sprovon Zoti i tij, e nderon dhe e begaton, ai thotë:
“Zoti im më ka nderuar!” (El-Fexhr: 15)**

Me këtë ajet, Allahu i Madhërishëm tregon për mendimet e kurejshitëve se ata ishin të nderuar nga Allahu i Madhërishëm dhe se rob i Tij ishte i poshtëruar.

Me këtë ajet, Allahu i Madhërishëm tregon thëniet e tyre se ata ishin të nderuar nga Allahu i Madhërishëm dhe se rob i Tij ishte i poshtëruar.

Ata bazoheshin në atë se kur shihnin veten e tyre posedonin pasuri, fëmijë, jetë të mirë, e kjo (në bazë të tyre) ishte nderë për ta, ndërsa e kundërta ishte poshtërim, dhe se në përgjithësi ky mendim dominon te shumica e pabesimtarëve.

Ky ajet “Sa i përket njeriut” është kritikë dhe qortim.

Fjala “Njeri” është emër i llojit, pasi mund të rezultojnë një mendim i tillë edhe te disa besimtarë për disa raste, në mënyrë të tillë. Kjo në bazë të natyrshmërisë.

Njeriu gabon atëherë kur mendon se: Nëse e sprovon Zoti, dhe i jep mirësi, e nderon me pasuri dhe ia zgjeron furnizimin e ai thotë: Zoti më ka nderuar dhe më ka vlerësuar, më ka përzgjedhur dhe më ka pasuruar.

Po ashtu njeriu gabon atëherë kur krijon bindje se: Nëse e sprovon Zoti, dhe i jep mirësi, e nderon me pasuri dhe ia zgjeron furnizimin e ai thotë: Zoti më ka nderuar dhe më ka vlerësuar, më ka përzgjedhur dhe më ka pasuruar.

Allahu e mallkon njeriun për shkak të asaj se çka mendon: Pra (kur mendon se) Allahu i ka zgjeruar furnizimin, dhe kjo është se është i privilegjuar dhe i nderuar prej Allahut, ndërsa çështja nuk është ashtu, por ai vet është në sprovë dhe në test. Kjo sa i përket të pasurit dhe të atij i cili e ka gjendjen e mirë ekonomike.

Besimtarë të nderuar!

Përderisa, sa i përket atij i cili ballafaqohet me varfëri.

Varfëria nuk është dëshmi se Allahu është i hidhëruar me atë njeri.

Gjendja e vështirë ekonomike nuk është dëshmi se Allahu është i hidhëruar me atë njeri.

Por, kur për ta sprovuar ia pakëson furnizimin (e varfëron), ai thotë:

وَأَمَّا إِذَا مَا ابْتَلَاهُ فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقُهُ فَيَقُولُ رَبِّي أَهَانَنِ ﴿١٦﴾

“Zoti im më ka nënçmuar!” (*El-Fexhr: 16*)

Kur Allahu e sprovon njeriun me varfëri, nuk ka gjendje të mirë ekonomike thotë: Zoti më poshtëroi.

Kur Allahu e i ngushton furnizimin, thotë: Zoti më përbuzi.

Edhe ky mendim është i gabuar.

Nuk është e drejtë për njeriun të mendon se pasi i është penguar risku dhe i është vështirësuar gjendja ekonomike është përbuzur.

Nuk është e drejtë për njeriun të mendon se pasi i është penguar furnizimi dhe i është vështirësuar gjendja ekonomike është poshtëruar.

Thënia e Allahut: “Ibtelahu” ka kuptimin: I ka dhënë të mira.

Besimtarë të nderuar!

Nëse njeriut i mundësohet diçka në pasuri, nuk është argument se Allahu është i kënaqur me të.

Nëse njeriut i mundësohet famë, nuk është argument se Allahu është i kënaqur me të.

Nëse njeriut i mundësohet pozitë, nuk është argument se Allahu është i kënaqur me të.

Nëse njeriut i mundësohet shëndet, nuk është argument se Allahu është i kënaqur me të.

Në anën tjetër:

Pengimi nga rizku nuk janë dëshmi se Allahu është hidhëruar me atë njeri dhe e dënon.

Varfëria nuk është dëshmi se Allahu është hidhëruar me atë njeri dhe e dënon.

Gjendja e vështirë ekonomike nuk është dëshmi se Allahu është hidhëruar me atë njeri dhe e dënon.

Por është vetëm provë.

Obligim i të pasurit edhe i të varfrit është që të dëgjon.

Ai i cili sprovohet me varfëri duhet të falënderon dhe të duron.

Sa i përket nderimit të Allahut, shihet në devotshmëri, ndërsa,

Sa i përket poshtërimi prej Allahut vërehet në mëkatin ndaj tij.

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿١٧﴾ كَلَّا بَلْ لَا تُكْرِمُونَ الْيَتِيمَ

وَلَا تَحَاضُّونَ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ ﴿١٨﴾

وَتَأْكُلُونَ التُّرَاثَ أَكْلًا لَّمًّا ﴿١٩﴾

وَتُحِبُّونَ الْمَالَ حُبًّا جَمًّا ﴿٢٠﴾

“Jo, nuk është ashtu! Por (punoni edhe më zi) ju nuk përfillnit bonjakun,

Nuk cytni njëri-tjetrin për ta ushqyer të varfrin,

Dhe ju e hani me të madhe trashëgiminë (padrejtë).

Dhe pasurinë e doni së tepërmi.” (El-Fexhr: 17-20)

Allahu i Madhërishëm e ka qortuar njeriun i cili krijon bindje të gabuar, ose kur mendon se nëse ka jetë komode është i nderuar, ndërsa nëse jeton jetë të vështirë është i poshtëruar.

Pastaj ka sqaruar se esenca e rezultateve të njeriut dhe e veprimtarisë së tij shihet në atë kur e sheh se:

- Nuk e nderon jetimin ose nevojtarin.
- Nuk e motivon në ushqimin e të varfrit.
- Mundohet me çdo kusht që ta shfrytëzon pasurinë e trashëguar.
- Mundohet të tubon pasuri.

Besimtarë të nderuar!

﴿٢١﴾ كَلَّا إِذَا دُكَّتِ الْأَرْضُ دَكًّا دَكًّا

﴿٢٢﴾ وَجَاءَ رَبُّكَ وَالْمَلَكُ صَفًّا صَفًّا

﴿٢٣﴾ وَجِيءَ يَوْمَئِذٍ بِجَهَنَّمَ يَوْمَئِذٍ يَتَذَكَّرُ الْإِنْسَانُ وَأَنَّى لَهُ الذِّكْرَى

﴿٢٤﴾ يَقُولُ يَا لَيْتَنِي قَدَّمْتُ لِحَيَاتِي

“Jo, mosni ashtu! Kur të dridhet toka njëpasnjëshëm!

Dhe kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt qëndrojnë radhë-radhë!

Dhe atë ditë sillet Xhehennemi, ditën kur përkujtohet njeriu, e ç’dobi i bën atij përkujtimi?

Thotë: “O, i gjori unë, sikur të isha i parapërgatitur për jetën time!”
(*El-Fexhr: 21-24*)

Në këto ajete, Allahu tregon për veprat e njerëzve në mënyrë kritikuese dhe qortuese.

Jo, kurrresi, jo. Pra duke qortuar pretendimet e kurejshitëve në atë se: Allahu i jep pasuri atij të cilin e do dhe atë të cilin nuk e do. Mirëpo në të dy rastet shikohet devotshmëria e tij:

- Nëse është i pasur falënderon.
- Nëse është i varfër duron.

Ata neglizhojnë për të punuar vepra të mira.

Ata as nuk i nderojnë jetimët dhe as nuk ju ndihmojnë atyre, i largojnë edhe nga e drejta e tyre, nga e drejta e trashëgimisë, të cilën e meritojnë. Marrin pasuri prej tyre.

Të drejtën trashëgimore e rrëmbejnë me forcë, dhe e hanë vetë, tubojnë pasuri, dhe nuk bëjnë dallimin çka është e lejuar dhe çka është e ndaluar.

E duan pasurinë ekstrem dhe pa kurrfarë turpi.

O ju njerëz, ju mendoni për këtë botë e nuk mendoni për botën tjetër, Allahu dëshiron që të veproni për botën tjetër.

Jo, kurrresi jo, pra i qorton për mendimet dhe për veprimet e tyre. Nuk është e drejtë që të veproni dhe ta lakmoni vetëm këtë botë, e të privoni të tjerët nga mirësitë e kësaj bote dhe të pasuroheni me çdo kusht dhe në çfarëdo mënyre, qoftë hallall qoftë haram.

Përgatituni për ditën e llogaridhënies ku do të bëhet gjykimi në mes njerëzve, sa që do të dridhet, pra do të çahet toka dhe do të përplasjet me përplasje të fortë.

E, atëherë Allahu do t'i gjykon njerëzit në mes vete dhe do të merr vendime gjyqësore të rëndësishme, në dënim dhe shpagam.

Atë ditë do të paraqiten ajetet e fuqisë së Allahut, të sundimit të Tij, dhe të triumfit të Tij.

Melaqet e përzgjedhura dhe të dalluara do të qëndrojnë në rresht për të siguruar dhe për të mbrojtur çdo gjë.

Atëherë, ata të cilët do të shikojnë në atë moment do të ju zbulohet xhehenemi pasi ka munguar dhe ka qenë i mbyllur për ta, siç figuron në ajet tjetër:

وَبُرَزَتِ الْجَحِيمُ لِمَنْ يَرَى ﴿٣٦﴾

“Dhe do të paraqitet xhehenemi për ata të cilët e shohin.” (*En-Naziatë: 36*).

Në atë ditë të tmerrshme njeriu do ta kupton ku ka gabuar, dhe çka ka lëshuar, çfarë mëkate ka bë dhe çka ka përgënjeshtuar, dhe cilat vepra të këqija i ka punuar.

Në ditën e gjykimit pendohet, e mallkon veten e tij pse ka qenë indiferent. Në ditën e gjykimit ballafaqohet me realitetin (drejtësinë): E kupton se s'ka pushtet në llogaridhënie dhe shpagam. Kjo sepse sundimi absolut i takon Allahut. Kështu ndodhë në të shumtën e rasteve.

Mirëpo a i bënë dobi ai përkujtim? Pra, a i bën dobi kujtimi?

Natyrisht se nuk i bënë dobi. Koha ka mbaruar. Afati ka skaduar.

Pa dyshim se do t'i bënte dobi po të kishte menduar dhe të vepronte të drejtën para vdekjes. Njeriu i cili ka bë mëkate në dunja do të thotë: Ah, i mjeri unë po të prezantoheshin vepra të cilat do të më bënin dobi për këtë botë të përgjithmonshme.

Thotë, sikurse të ekzistonte vetëm bota e përgjithmonshme. Ah, i mjeri unë po të kisha vepruar vepra të mira për jetën time për në botën tjetër e cila është e përgjithmonshme. Ajo botë është e përgjithmonshme si për banorët e xhehenemit, si për banorët e xhenetit.

Sa i përket pjesës së ajetit “Për jetën time”, dijetarët kanë dhënë dy mendime:

Mendimi i parë: Ka kuptimin “për jetën time të përgjithmonshme” pra për botën tjetër.

Mendimi i dytë: ka kuptimin “për jetën time të kaluar të dunjasë”.

Përgjigja e fjalës: “Atëherë kur toka pëlçet” është fjala: “Atëherë nuk do të dënohet” që nënkupton: Në ditën e gjykimit, askush nuk e merr përsipër që t’i dënon mëkatarët, t’i gjykon ata dhe t’i shpague përpos Zotit, askush nuk e merr përsipër që t’i lidh me hallka dhe me pranga, apo t’i gjykon për t’i lidhur pabesimtarët përpos Allahut.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٢٥﴾ فَيَوْمَئِذٍ لَا يُعَذِّبُ عَذَابُهُ أَحَدًا

وَلَا يُوثِقُ وَثَاقَهُ أَحَدًا ﴿٢٦﴾

“Pra, ditën kur nuk dënon si Ai askush.

Dhe nuk do të farkojë pranga si Ai askush.” (*El-Fexhr: 25, 26*)

Askush nuk dënon siç dënon Allahu. Këtu shohim motivimin për të vepruar vepra të mira dhe për të besuar, dhe frikësimin për të mos devijuar dhe për mosbërje të mëkateve.

Përemri në “Adhabehu” dhe “Vithakahu” është për Allahun e Madhërishëm, i Cili në ajetin në fjalë ka bërë përmbledhjen e dy kuptimeve:

E para: Allahu, atëherë nuk ja vendos barrën e mëkatit të pabesimtarit askujt.

E dyta: Dënimi për ta është aq i ashpër dhe vuajtja është aq e madhe sa që nuk mund të krahasohet me asnjë dënim të kësaj bote. Kështu është situata për njeriun materialist.

Përfundim

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٢٧﴾ يَا أَيَّتُهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ

ارْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً ﴿٢٨﴾

فَادْخُلِي فِي عِبَادِي ﴿٢٩﴾

وَادْخُلِي جَنَّتِي ﴿٣٠﴾

“O shpirt i qetësuar!

Kthehu te Zoti yt i kënaqur (për vete) e kënaqës (për Zotin)!

Hyr mes robërve të Mi!

Dhe hyr në Xhennetin Tim!” (*El-Fexhr: 27-30*)

Shkaku i zbritjes së ajetit në fjalë:

- Ka mendime se ky ajet ka zbritur për Hamzën.

- Ka mendime se ajeti në fjalë ka zbritur për Othmanin kur e ka ble burimin e quajtur “Rumë” dhe e ka lënë që ta shfrytëzojnë njerëzit për pije.

Kështu pra, sa i përket të mirit i cili ka vepruar vepra të mira dhe e ka dëgjuar Zotin e tij, ai te Zoti i tij kthehet me shpirt të qetë, kthehet i kënaqur me atë që ka punuar.

Sa i përket të mirit i cili e ka dëgjuar Zotin e tij, ai te Zoti i tij, kthehet i kënaqur me shpërblimin.

Ai hynë në xhenetin e përgjithmonshëm me robërit e mirë të Allahut.

Pas sqarimit se me çka do të ballafaqohen ata të dënuar, Allahu tregon për gjendjen e shpirtave të besimtarëve. Ata janë shpirtat e ndritur dhe të cilat nuk kanë qenë materialist ku thotë: **“O ti shpirt i qetë (i bindur)”**.

Allahu, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet melaqes thotë: O ti shpirt i cili ka besim të plotë e të drejtë, i cili ka besuar në Një Zot, i cili ka besuar me bindje të plotë dhe nuk ka dyshuar, i cili është pajtuar me caktimin e Zotit dhe me fuqinë e Tij, dhe i je përmbajtur ligjeve të Zotit.

Në ditën e gjykimit i ardhur me veprën e “përmendjes ndaj Allahut”, i palëkundur në besim, besimtar me besim stabil, kthehu te shpërblimi i Zotit tënd të cilin ta ka dhuruar ty, në vendin ku të nderon dhe të gradon.

Kënaqu me këtë shpërblim për të cilën ke vepruar në këtë botë, dhe në atë që ka vendosur Allahu. Ktheu i kënaqur me vlerësimin e Zotit. Hyn në grupin e robërve të Mi të mirë së bashku me ta hyni në xhenetin Tim. Ky është nderimi, pas të cilit nderim nuk ka nderim më të madh. Allahu na bëftë prej tyre.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Fexhr.

SURETU BELED

Suretu Beled

لَا أُقْسِمُ بِهَذَا الْبَلَدِ ﴿١﴾ وَأَنْتَ حِلٌّ بِهَذَا الْبَلَدِ ﴿٢﴾ وَوَالِدٍ وَمَا وَلَدَ ﴿٣﴾ لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي
كَبَدٍ ﴿٤﴾ أَيْحَسِبُ أَنْ لَنْ يَقْدَرَ عَلَيْهِ أَحَدٌ ﴿٥﴾ يَقُولُ أَهْلَكْتُ مَالًا لُبَدًا ﴿٦﴾ أَيْحَسِبُ أَنْ لَمْ
يَرَهُ أَحَدٌ ﴿٧﴾ أَلَمْ نَجْعَلْ لَهُ عَيْنَيْنِ ﴿٨﴾ وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ ﴿٩﴾ وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ ﴿١٠﴾ فَلَا
اِقْتَحَمَ الْعَقَبَةَ ﴿١١﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْعَقَبَةُ ﴿١٢﴾ فَكُّ رَقَبَةٍ ﴿١٣﴾ أَوْ إِطْعَامٌ فِي يَوْمٍ ذِي مَسْغَبَةٍ
﴿١٤﴾ يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ ﴿١٥﴾ أَوْ مِسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ ﴿١٦﴾ ثُمَّ كَانَ مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ
وَتَوَاصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ ﴿١٧﴾ أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ ﴿١٨﴾ وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا هُمْ أَصْحَابُ
الْمَشْأَمَةِ ﴿١٩﴾ عَلَيْهِمْ نَارٌ مُؤَصَّدَةٌ ﴿٢٠﴾

Jeta është përplot mundime.

Njeriu është i krijuar për t'u ballafaquar me mundime, me brenga.

Njeriu është i krijuar për t'u ballafaquar me sprovat jetësore.

Njeriu është mashtruar me këtë jetë dhe me të mirat e kësaj bote.

Ai mendon se është zotëria i kësaj toke dhe askush asgjë nuk e ka në dorë, mirëpo:

- Allahu është Ai i Cili e ka pajisur njeriun me dituri,

- Allahu është Ai i Cili e ka pajisur njeriun me mjetet e hulumtimit të çështjeve.

- Allahu është Ai i Cili ia ka dhënë mjetet e hulumtimit dhe ia ka treguar rrugën për t'u drejtuar dhe për t'u udhëzuar.

Allahu ia ka treguar njeriut mënyrën për të pasur sukses në jetë dhe për të shpëtuar. Mirëpo ai neglizhon dhe nuk angazhohet për t'u ngjitur në rrugën përpjetë, e ajo rrugë është: Lirimi i robërve dhe furnizimi me ushqim të tjerët.

Kjo ka ndikuar që njerëzit të ndahen në dy grupe:

- Njerëzit e pozicionuar në anën e djathtë.

- Njerëzit e pozicionuar në anën e majtë.

Cili është qëllimi i i Suretul Beled?

- Qëllimi i suretul Beled është sqarimi se Allahu është i Gjithëfuqishëm kundrejt qytetarëve.

- Qëllimi i suretul Beled është Sqarimi se Allahu është i Gjithëfuqishëm kundrejt të pasurve të qytetit.

- Qëllim tjetër është se Allahu ia kujton peygamberit rëndësinë dhe vlerën e Mekës, të banorëve të Mekës, paraardhësve të mekës dhe e esencën e dërgimit duke i qortuar dhe mallkuar idhujtarët.

- Ua kujton se begatitë ndaj tyre duhet të shprehen me mirënjohje, me falënderim.

- Ua kujton se nuk dënohen nëse veprojnë punë të mira, si f.v. duke ndihmuar jetimët dhe të varfrit.

Suretu Beled sqaron se ekzistojnë dy rrugë:

- Rruga e drejtë dhe

- Rruga e gabuar.

Suretu Beled, pasi që sqaron situatën e dy rrugëve, tregon rezultatin dhe përfundimin e secilës rrugë.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿ لَا أُقْسِمُ بِهَذَا الْبَلَدِ ﴾ ﴿١﴾

“Betohem në këtë qytet!” (*El-Beled: 1*)

Betohem në këtë qytet: Është Mekeja Fisnike, tregon për madhësitinë e saj.

Kur Zoti betohet në elemente, betohet për të treguar rëndësinë, vlerën dhe madhësitinë e tyre, e prej tyre:

Është betuar në Mekën, vlera e së cilës është se në Meke është Qabja.

Është betuar në Mekën i cili është vendi më i vlefshmi në fytyrën e tokës.

﴿ إِنَّ أَوَّلَ بَيْتٍ وُضِعَ لِلنَّاسِ لَلَّذِي بِبَكَّةَ مُبَارَكًا وَهُدًى لِّلْعَالَمِينَ ﴾ ﴿٩٦﴾

“Më e para shtëpi që është vënë për gjithë njerëzit, është ajo që gjendet në Mekë.” (*Ali Imran, 96*)

﴿ وَأَنْتَ حِلٌّ بِهَذَا الْبَلَدِ ﴾ ﴿٢﴾

“E ti je që gjendesh në këtë qytet!” (*El-Beled: 2*)

Është betuar në elemente për të treguar rëndësinë, vlerën dhe madhësitinë e tyre, e prej tyre:

E ti, o pejgamber, ti e ke të lejuar këtë qytet.

Lejohet ta vrasësh cilin do.

Kjo ka qenë në ditën e çlirimit të Mekës.

Ata kishin kryer krime, për të cilat krime ishte i merituar ekzekutimi i tyre.

Në çfarëdo situatë, Mekeja ka vlerë të madhe sa që edhe në situatën e pabesimtarëve, o pejgamber e ke të lejuar ekzekutimin me vrasje në atë qytet, nuk e ke të ndaluar. Kjo është poshtërim dhe përbuzje për ta.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

وَوَالِدٍ وَمَا وَلَدَ ﴿٣﴾

“Betohem në prindin dhe në atë që lind prej tij!” (El-Beled: 3)

Është betuar në elemente për të treguar rëndësinë, vlerën dhe madhësitinë e tyre, e prej tyre:

Është betuar në babanë, në Ademin, të cilin e ka krijuar dhe e ka bërë pejgamber:

إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ ﴿٣٣﴾

“All-llahu e zgjodhi (pejgamber) Ademin, Nuhun, familjen Ibrahimit, familjen e Imranit mbi popujt tjerë (të asaj kohe).” (Ali Imran, 33)

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً ۖ قَالُوا أَتَجْعَلُ فِيهَا مَن يُفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدِّمَاءَ وَنَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ وَنُقَدِّسُ لَكَ ۗ قَالَ إِنِّي أَعْلَمُ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٣٠﴾

“(Kur Zoti yt u tha melekëve): “Unë po krijoj në tokë një zëvendës!” (Bekare, 30)

Është betuar në bijtë e Ademit për njerëzit e mirë dhe për ata të cilët jetojnë në Meke ose për ata të cilët kanë kaluar pranë saj. Pra, në Ibrahimin a.s. dhe Ismailin a.s.

Dihet vlera e Ibrahimit a.s.

Dihet vlera e Ismailit. Zoti i Madhërishëm e ka shpërblyer ku thotë:

وَفَدَيْنَاهُ بِذَبْحٍ عَظِيمٍ ﴿١٠٧﴾

“Ne e shpaguam atë me një të therur (kurban) të rëndësishëm.” (Saffat, 107)

Besimtarë të nderuar!

Zoti i madhërishëm thotë:

لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي كَبَدٍ ﴿٤﴾

“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në vështirësi të njëpasnjëshme.” (El-Beled: 4)

Çdo betim e ka edhe arsyen e betimit.

Arsyeja e betimit është se:

- Zoti e ka krijuar njeriun për vështirësi.
- Të gjithë njerëzit përfshihen nën rregullin e jetesës me vështirësi.
- Të gjithë njerëzit përfshihen nën rregullin e jetesës me vuajtje dhe me prova.
- Të gjithë njerëzit përfshihen nën rregullin e jetesës me prova.
- Njeriu sprovohet për çështjet e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٥﴾ أَيَحْسَبُ أَنْ لَنْ يَقْدِرَ عَلَيْهِ أَحَدٌ

“A mendon ai, se atë nuk mund ta mposhtë askush?” (El-Beled: 5)

Njeriun e ka mashtruar fuqia e tij.

Njeriun e ka mashtruar vetvetja e tij. Për këtë arsye i është thënë: Biri i Ademit a mos po mendon se nuk e ngërthen (nuk e mposhtë) askush. A mendon se nuk mund t'i hakmerret askush. Allahu është Ai i Cili ka mundësi për gjithçka.

Shkaku i zbritjes së ajetit:

Dy shkaqe të zbritjes së ajetit në fjalë:

E para:

Ky ajet ka zbritur për el-Xhemhijun. Ai mendonte se atë nuk mund ta mposhtë askush.

Ka mendime se ajeti në fjalë ka zbritur për tjetërkënd, siç ishte Amr bin Abdin, i cili ka dashur të dyluftonte dhe ta mbyste Aliun r.a. në fushë, ku ishte ndërtuar (hapur) hendeku,

Kur’ani, për këtë arsye ka qortuar.

Zoti i madhërishëm tregon dhe thotë:

﴿٦﴾ يَقُولُ أَهْلَكْتُ مَالًا لُبَدًا

﴿٧﴾ أَيَحْسَبُ أَنْ لَمْ يَرَهُ أَحَدٌ

“E thotë: “Unë kam shpenzuar shumë pasuri!

A mendon ai se atë askush nuk e ka parë?” (El-Beled: 6, 7)

Allahu e mallkon njeriun i cili shpenzon (donon) pasuri me qëllim proklamimi, lavdërimi dhe syfaqësimi, ashtu që në ditën e gjykimit të thotë: Unë kam donuar (shpenzuar) shumë pasuri.

Kam shpenzuar për të tjerët.

Kjo është ajo që pjesëtarët e kohës së injorancës thoshin: “Fisnik”, “Dorëdhënës”, “Është njeri i madh”, “Është njeri me vlerë”.

E dyta:

Ajeti në fjalë ka zbritur për Harith bin Amirin bin Nufelin: Ai gabonte, dhe e ka pyetur pejgamberin a.s. Pejgamberi a.s e ka urdhëruar të shfajësohej me kompensim (dëmshpërblim).

Pastaj ai (Harithi) ka thënë: Më është harxhuar pasuria duke paguar dëmshpërblime dhe shpenzime (donime), prej se kam hy në fenë e Muhamedit.

Kjo thënie e tij ose ka qenë thënie e tepruar për atë që shpenzonte, kështu që do të ishte mëkat i madh (krim) prej tij, ose e ka fajësuar veten e tij dhe ka shfaqur pendim për veten e tij, pastaj Allahu e kritikon njeriun për injorancën e tij, sa që Allahu thotë për të se a mos po mendon njeriu i cili pretendon se shpenzon në rrugë të Allahut se nuk do t'i zbulohet brendësia e tij, dhe se nuk do të pyetet për pasurinë e tij se ku e ka fituar dhe ku e ka shpenzuar.

Pastaj Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿۸﴾ أَلَمْ نَجْعَلْ لَهُ عَيْنَيْنِ

وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ ﴿۹﴾

وَهَدَيْنَاهُ النَّجْدَيْنِ ﴿۱۰﴾

فَلَا اقْتَحَمَ الْعَقَبَةَ ﴿۱۱﴾

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْعَقَبَةُ ﴿۱۲﴾

“A nuk i dhamë Ne atij dy sy?

Edhe gjuhë e dy buzë?

Dhe i sqaruam atij për të dy rrugët.

E ai nuk u hodh në të përpjetmen (rrugë e vështirë - qafëmalit).

E ç’gjë të mësoi ty se ç’është Akabe (rruga e vështirë)?” (El-Beled: 8-12)

Sqaron të mirat e njeriut e prej tyre:

- Begatinë e shikimit,
- Begatinë e të folurit.

- Begatinë e shijes së ushqimit.

Këto janë begati për të shkuar drejt rrugës së drejtë.

Këto janë begati për të shkuar rrugës së udhëzimit siç vazhdon e tregon se ne i kemi sqaruar dy rrugë.

Zoti i Madhërishëm ia ka dhënë njeriut:

- Mendjen për të menduar.

- Mendjen për të kuptuar.

Sqaron rrugën e cila sjellë lumturi në botën tjetër.

Tregon disa arsye dhe shkaqe të cilat sjellin lumturi në botën tjetër e prej tyre:

- Lirimi i robit.

- Ushqimi i nevojtarit.

Në fazën e Mekës pabesimtarëve ua përmend të mirat ndaj tyre:

-Idhujtarëve u ka dhënë sy, gjuhë dhe buzë mjete të cilat mjete u sjellin shpëtim ata i kanë keqmenaxhuar.

Idhujtarët i kanë keqpërdorë mirësitë.

Idhujtarët i kanë keqpërdorë veshët e tyre.

Idhujtarët nuk ushqejnë të varfrit.

Idhujtarët nuk lirojnë rob.

Idhujtarët nuk ndihmojnë jetimin.

Pastaj sqaron shkaqet e fatkeqësisë e prej tyre:

- janë mashtruar me forcën e tyre,

- janë mashtruar me pasurinë e tyre.

Pabesimtari krenohet se ka shpenzuar pasuri për t'i larguar njerëzit nga rruga e Zotit.

I mohohen të mirat e Zotit.

Në vend se të liron robin, në vend se të ushqen jetimin, të varfrin, ai e jep në pengimin nga rruga e Zotit.

Allahu i Madhërishëm nuk e ka lënë njeriun në kategorinë e të paditurve, por e ka pajisur me atë që e dallon të mirën nga e keqja, duke i krijuar atij çelësat e njohurive.

Ia ka dhënë sytë, gjuhën, buzët dhe mendjen e ndritur saqë Allahu i ka thënë atij: O njeri injorant, i cili je mashtruar në forcën tënde, po a nuk t'i kemi dhënë sytë për me pa, dhe gjuhën për me folë, po ashtu t'i kemi dhënë buzët që t'i mbyllësh, ashtu që t'i shfrytëzosh për të folur e për t'u ushqyer.

A nuk të kemi sqaruar dhe a nuk ta kemi treguar rrugën e së mirës dhe së keqes.

Të kemi dhënë mendjen dhe të kemi bërë ashtu që në mënyrë të natyrshme mund të kuptosh çka është e mirë dhe çka e keqe, e që për veten tënde ta përzgjedhësh rrugën e shpëtimit.

Rruga e shpëtimit: është përzgjedhja më e mira. Andaj pse njeriu nuk angazhohet dhe të çlirohet nga pengesat për të qenë i devotshëm ndaj Allahut të Madhërishëm. Pse i pason cytjet e shejtanit dhe të epshit!?

Pse nuk angazhohet ta lehtëson rrugën e mundimshme!?

Çka është ajo që të mëson ty se çka është rrugë e mundimshme!?

فَكُ رَقَبَةً ﴿١٣﴾

أَوْ إِطْعَامٌ فِي يَوْمٍ ذِي مَسْغَبَةٍ ﴿١٤﴾

يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ ﴿١٥﴾

أَوْ مَسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ ﴿١٦﴾

“Është lirimi i një skllavi,

Ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria:

Ndonjë jetimi që është i afërt,

Ose ndonjë të varfëri që e ka molisur varfëria.” (El-Beled: 13-16)

Ajo rrugë lehtësohet duke çliruar robër.

Ajo rrugë lehtësohet duke ushqyer njerëzit në kohë krize dhe urie.

Ajo rrugë lehtësohet duke i ndihmuar jetimit të cilit i ka vdekur babai e që është edhe i afërt i juaji.

Ajo rrugë lehtësohet duke ushqyer të gjorin, i cili ka nevojë për gjithçka.

E i cili nuk ka mundësi të fiton pasuri për shkak të paaftësisë së tij, thuaja se i janë ngjitur duart për toke. Kjo ngase i mungon pasuria.

“Mesgabetun” është uria në kuptim të përgjithshëm.

“Metrahe” atij të cilit i ngjiten duart për toke.

Me këtë kuptohet se “Miskini” (i gjori) është ai i cili është në gjendje më të rëndë se i varfri.

Përpos kësaj, ka qenë prej atyre të cilët kanë besuar Allahun, pejgamberin e Tij dhe ditën e gjykimit. Kjo ngase veprat e mira kushtëzohen që të pranohen me kushtin e besimit.

Pastaj

ثُمَّ كَانَ مِنَ الَّذِينَ آمَنُوا وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ وَتَوَاصَوْا بِالْمَرْحَمَةِ ﴿١٧﴾

“E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë).” (El-Beled: 17)

Ka qenë prej besimtarëve të cilët kanë vepruar vepra të mira prej të cilëve ka porositur për durim ndaj ofendimeve dhe në kryerjen e obligimeve ndaj Allahut, ndaj sprovave dhe ndaj caktimeve të Zotit.

Pastaj ka duruar dhe nuk e ka pasuar epshin e nuk ka bë mëkate, dhe kanë qenë të mëshirshëm në mes vete dhe ndaj krijesave të Allahut.

Fjala “Merhametun”: çdo gjë e cila ndikon në fitimin e mëshirës së Allahut të Mëshirshëm.

Përfundim

أُولَئِكَ أَصْحَابُ الْمَيْمَنَةِ ﴿١٨﴾

“Të tillët janë të zotët e anës së djathtë.” (El-Beled: 18)

Këta të cilët edukohen dhe cilësohen me këto cilësi: janë të djathtët, këta janë banorët e xhenetit.

Të djathtët janë ata të cilët janë nga ana e djathtë e arshit, është vendi i xhenetit, dhe vendi ku njerëzit do të jenë të mëshiruar.

وَالَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا هُمْ أَصْحَابُ الْمَشْأَمَةِ ﴿١٩﴾

عَلَيْهِمْ نَارٌ مُّؤَصَّدَةٌ ﴿٢٠﴾

“Ndërsa ata që nuk i besuan argumentet Tona, ata janë të së majtës.

Kundër tyre është zjarri i mbyllur.” (El-Beled: 19, 20)

Ata të cilët mohojnë ajetet tona të zbritura, këta janë të majtët.

Ata të cilët mohojnë shenjat në gjithësi të cilat tregojnë fuqinë tonë, këta janë të majtët.

Ata do të mbyllen në xhehenem ku do t'i kaplon zjarri nga të gjitha anët.

Fjala “Mesh’eme”: është ana e majtë, në këtë drejtim është xhehenemi, ajo është rruga e të dënuarve të cilët e marrin rrugën e anës së majtë.

Faza e mekës e tregon gjendjen e mushrikëve dhe të besimtarëve, cilësitë e mushrikëve dhe të besimtarëve, gjendjen e pejgamberit a.s. në fazën e mekës në fazën e daves (thirrjes).

Është betuar në mekën, në Ademin dhe në bijtë e mirë të Ademit,
pasardhësit besimtarë të Ademit.

Duke e falënderuar Zotin, po e përfundojmë komentimin e sures Beled.

SURETU SHEMS

Suretu Shems

وَالشَّمْسِ وَضُحَاهَا ﴿١﴾ وَالْقَمَرِ إِذَا تَلَاهَا ﴿٢﴾ وَالنَّهَارِ إِذَا جَلَّاهَا ﴿٣﴾ وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَاهَا ﴿٤﴾
وَالسَّمَاءِ وَمَا بَنَاهَا ﴿٥﴾ وَالْأَرْضِ وَمَا طَحَاهَا ﴿٦﴾ وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ﴿٧﴾ فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا
وَتَقْوَاهَا ﴿٨﴾ قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا ﴿٩﴾ وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسَّاهَا ﴿١٠﴾ كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِطَغْوَاهَا
﴿١١﴾ إِذِ انْبَعَثَ أَشْقَاهَا ﴿١٢﴾ فَقَالَ لَهُمْ رَسُولُ اللَّهِ نَاقَةَ اللَّهِ وَسُقْيَاهَا ﴿١٣﴾ فَكَذَّبُوهُ فَعَقَرُوهَا
فَدَمْدَمَ عَلَيْهِمْ رَبُّهُمْ بِذَنبِهِمْ فَسَوَّاهَا ﴿١٤﴾ وَلَا يَخَافُ عُقْبَاهَا ﴿١٥﴾

Prej qëllimeve të suretu Shems është pastrimi i shpirtit.

Allahu i Madhërishëm ka treguar se, dënimi shkon për përgënjeshtresit, ashtu siç ka ndodhur me fisin Themud, për shkak të krimeve dhe devijimit të tyre.

Allahu i Madhërishëm e ka treguar se, dënimi shkon për shkak se i kanë sulmuar pejgamberët dhe mrekullitë mbinatyrore.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالشَّمْسِ وَضُحَاهَا ﴿١﴾

“Pasha diellin dhe dritën e tij!” (*Esh-Shems: 1*)

Është betuar në diellin i cili e ndriçon veten e vet, pa marrë parasysh edhe pas perëndimit apo kur lindë.

Është betuar në Diellin që e ka ndriçuar tokën.

Është betuar në dritën e saj të mesditës kur është në horizont. Ai ngjallë kërshërinë e jetës.

Ose ka kuptimin: Betohem në Diellin, në mesditën dhe në hënën.

Fjala “Duha” ka kuptimin e ngritjes dhe plotësimit të dritës, ose mund të jetë e gjithë dita (drita e ditës), ose edhe nxehtësia përcëlluese e diellit.

Është betuar në ditën e cila është prej shenjave të dukshme me dritën e cila e ndriçon ditën.

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالْقَمَرَ إِذَا تَلَاهَا ﴿٢﴾

“Pasha hënën kur vjen pas tij!” (*Esh-Shems: 2*)

Është betuar në hënën e ndriçuar, kur e përcjell diellin kur lindë e perëndon.

Hëna është shenjë e natës, është prej shenjave të dukshme, drita e së cilës e ndriçon natën, e ndriçon errësirën në tokë, e mbulon dritën e ditës.

Hëna e ndjek diellin që nga fillimi i muajit e deri në mes të tij në drejtim të perëndimit.

Pastaj hëna perëndon dhe ai dielli perëndon.

Pastaj e ndjek në gjysmën tjetër me ndjekje tjetër, ashtu që ajo perëndon, ndërsa dielli lindë.

Në fakt kjo ndjekje nuk specifikohet me gjysmën e parë dhe as me gjysmën e dytë.

Po ashtu Zoti i Madhërishëm thotë:

وَالنَّهَارَ إِذَا جَلَّاهَا ﴿٣﴾

“Pasha ditën kur ai (dielli) e shndrit!” (*Esh-Shems: 3*)

Zoti është betuar në ditën kur dielli e shpalos, e zbulon dhe e paraqet të plotë.

Në plotësimin e ditës bëhet edhe plotësimi i qartë i diellit.

Po ashtu Zoti i Madhërishëm thotë:

وَاللَّيْلَ إِذَا يَغْشَاهَا ﴿٤﴾

“Pasha natën kur ajo e mbulon atë (dritën e diellit)!” (*Esh-Shems: 4*)

Zoti është betuar në natën e cila e mbulon dritën e ditës me errësirën e saj, ashtu që mënjanon dritën me zhdukjen e diellit kështu që errësohet gjysma e rruzullit tokësorë.

Pastaj dielli lindë në gjysmën tjetër të tokës.

Kjo ka qenë kundërpërgjigje ndaj idhujtarëve të cilët i adhuronin trupat qiellorë.

Kjo ka qenë kundërpërgjigje ndaj paganëve të cilët thoshin ekzistojnë dy zota: zotin e natës dhe zotin e ditës.

Kjo ka qenë kundërpërgjigje në atë se Zoti nuk zhduket dhe nuk e ndryshon gjendjen.

Vëllezër të nderuar!

Në vazhdim, Allahu i Madhërishëm përmendë atributet e kozmosit sa që thotë:

وَالسَّمَاءِ وَمَا بَنَاهَا ﴿٥﴾

وَالْأَرْضِ وَمَا طَحَاهَا ﴿٦﴾

“Pasha qiellin dhe Atë që e ndërtoi atë!

Pasha tokën dhe Atë që e shtriu atë (e sheshoi)!” (*Esh-Shems: 5, 6*)

Është betuar në qiellin e lartë, në tokën që e ka krijuar të drejtë dhe në natyrshmëri të shëndoshë.

Zoti është betuar në qiellin, të cilin Allahu e ka ndërtuar me plotë trupa qiellorë.

Zoti është betuar edhe në tokën dhe në atë që e ka sheshuar në të gjitha anët dhe e ka bërë të përshtatshme për banorët në të.

Thënia e Allahut: “Ve ma benaha”. Pastaj edhe “Ve ma tahaha” ka kuptimin: “I Cili”, pra, “Betohem për Atë i Cili”.

Betimi është bërë për vet Vetën e Allahut të Madhërishëm, por pjesëza “Ma” mund ta ketë qëllimin për të gjitha ato dukuri dhe krijesa.

Kjo i bie sikur të ketë thënë Allahu: “Betohem në qiellin dhe të ndërtuarat në të”.

Vëllezër të nderuar!

وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّاهَا ﴿٧﴾

“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë!” (*Esh-Shems: 7*)

Betohem në shpirtin njerëzorë dhe në Atë i Cili e ka krijuar të plotë dhe stabil, në natyrshmërinë e drejtë.

Fjala “Sevaha” ka kuptimin: Plotësimi i logjikës së saj, plotësimi i mendjes së saj dhe të adhurimit çka i nevojitet për ta programuar trupin, e ato janë organe konkrete dhe jo konkrete.

Besimtarë të nderuar!

Prej mëshirës së Zotit është fakti se sqaron rrugën e së mirës për ta pasuar ashtu siç e tregon rrugën e së keqes për t'u larguar.

فَالْهَمَّهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا ﴿٨﴾

“Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij.” (*Esh-Shems: 8*)

Zoti e ka inspiruar dhe ia ka mundësuar njeriut ta kupton çka është e keqe dhe çka është e mirë për ta bërë dallimin në mes të së mirës dhe së keqes.

Zoti e ka inspiruar dhe ia ka mundësuar njeriut ta kupton çka është krim dhe çka është devotshmëri dhe për ta bërë dallimin në mes tyre.

Zoti e ka inspiruar dhe ia ka mundësuar ta kupton çka është e bukur dhe e shëmtuar për ta bërë dallimin në mes tyre.

Çdo foshnje lindë në natyrshmëri.

Allahu e ka sqaruar rrugën e së mirës dhe së keqes.

Rruga e mirë është rruga të cilën e zgjedhë njeriu, të cilën e ka sqaruar nëpërmjet suneteve të pejgamberit dhe të librit të Allahut.

Rruga e keqe është rruga të cilën e zgjedhë njeriu, të cilën e ka sqaruar nëpërmjet suneteve të pejgamberit dhe të librit të Allahut.

Thënia e Allahut “Elhemeha” ka kuptimin: Ia ka mundësuar t'i kupton ato rrugë.

Shpirti simpatik i dashur ka nevojë për ndjenja të pastra, dhe orientimi në atë çka është më e mira.

Shpirti simpatik ka nevojë që të lufton kundër shejtanit dhe epshit.

Atëherë kur njeriu i lufton dëshirat dhe epshin, ai është besimtar me besim të vërtetë.

Besimtarë të nderuar!

Cila është përgjigja e betimit:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا ﴿٩﴾

“Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten.” (*Esh-Shems: 9*)

Përgjigja e betimit është në thënien e Allahut: “Ka shpëtuar” pra veç ka shpëtuar, që do të thotë se ka arritur sukses në të gjitha të kërkuarat, i ka realizuar ai cili e ka pastruar shpirtin, e edukon dhe e zhvillon me të mira, dhe e bën të praktikon devotshmërinë dhe veprat e mira.

Përgjigja e betimit është se ka arritur sukses në të gjitha të kërkuarat, i ka realizuar ai cili e ka pastruar shpirtin, e edukon dhe e zhvillon me të mira, dhe e bën të praktikon devotshmërinë dhe veprat e mira.

Përgjigja e betimit është se ka arritur sukses në të gjitha të kërkuarat, i ka realizuar ai i cili e ka pastruar shpirtin, e edukon dhe e zhvillon me të mira, dhe e bën të praktikon devotshmërinë dhe veprat e mira. Kjo, pas dërgimit të peygamberëve, pas argumenteve dhe pas shenjave madhështore.

Zoti është betuar në 11 çështje se Zoti e mbështetë:

- Atë i cili pastron shpirtin,
- I cili plotëson besimin, dhe
- I cili Vepron vepra të mira,
- I cili Largohet nga çdo gjë e njollosë shpirtin
- I cili Largohet nga idhujtaria dhe mëkatet.

I tilli ka shpëtuar në ditën e gjykimit.

I tilli ka shpëtuar nga çdo gjë e trishtueshme dhe

Zoti ia siguron çdo të mirë.

Besimtarë të nderuar!

Zoti është betuar në 11 çështje se:

وَقَدْ حَابَ مَنْ دَسَّاهَا ﴿١٠﴾

“E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten.” (*Esh-Shems, 10*)

- Ka dështuar ai i cili e ka ngatërruar shpirtin.
- Ka dështuar ai i cili nuk e ka edukuar shpirtin.
- Ka dështuar ai i cili nuk e ka përgatitur veten me devotshmëri.
- Ka humbur ai i cili e ka njollosur shpirtin, nuk e ka edukuar dhe e ka lënë të zhytet në mëkate, dhe nuk e ka përgatitur me vepra të mira.

Atëherë kur njeriu nuk kujdeset për shpirtin e tij, e lë të shkon në bazë të dëshirave epshore, ai ka pësuar dhe ka dështuar.

Allahu është përbetuar për këtë. Dështimi dhe disfata duhet të dënohen.

Ndërsa ai i cili e njollos shpirtin me të keqën, me të dëmshmen, me mëkate ai veç ka dështuar. Kjo, pasi u kanë ardhur peygamberët me argumente të qarta.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِطَغْوَاهَا ﴿١١﴾

إِذِ انْبَعَثَ أَشْقَاهَا ﴿١٢﴾

“Themudi përgënjeshtroi për shkak të arrogancës së vet.

Kur më i keqi i tyre u ngrit me të shpejtë.” (*Esh-Shems: 11, 12*)

Dënimi i cili do t'i godet përgënjeshtresit kur do të gjykohen dhe do të dënohen në botën tjetër është e padiskutueshme.

Është e padiskutueshme sepse, Themudi - vend në mes të Shomit dhe Hixhazit - e kanë përgënjeshtuar peygamberin e tyre Salihun për shkak se kanë qenë kriminel dhe arrogant. Kjo ka ndikuar që ata ta përgënjeshtrojnë.

Themudi e kanë tejkaluar kufirin me mëkate, atëherë kur është rebeluar Kudar bin Salefi nga populli Themud, i cili e ka therë devenë e Salihut a.s., me motivimin nga populli i tij dhe me pajtimin e tyre me atë vepër.

Therja e devesë është dëshmi se të gjithë e kanë përgënjeshtuar peygamberin e tyre dhe dëshmi për saktësinë e mesazhit të tij, atëherë kur i ka përfshi dënimi me të cilin janë paralajmëruar.

فَقَالَ لَهُمْ رَسُولُ اللَّهِ نَاقَةَ اللَّهِ وَسُقْيَاهَا ﴿١٣﴾

“... e Peygamberi atyre u pat thënë: “Kijeni kujdes devenë e All-llahut dhe ndaj pengimit të saj që të pijë ujë.” (*Esh-Shems: 13*)

Salihu u ka thënë atyre: Pra, grupit rebelues të peygamberit të Allahut, Salihut a.s.: Lëreni devenë e Allahut, e keni kujdes, mos i bëni ndonjë të keqe, pra,

Salihu u ka thënë atyre mos i shkaktoni asnjë të keqe, por lëreni që të pi ujë siç është përcaktuar dhe siç kanë bërë marrëveshje ashtu që ajo të konsumon ujin përgjatë një dite, ndërsa ju e konsumoni ujin në ditën tjetër.

E kanë përgënjeshtuar paralajmërimin se mund të dënohen, as që janë brengosur për paralajmërimin se do të dënoheshin.

E, pastaj rebeli e ka pre atë deve, pastaj populli janë pajtuar me atë veprim. Kështu, prerjen e devesë ia ka përshkruar të gjithëve kështu që dënimi është zbatuar te të gjithë dhe, Allahu i ka shkatërruar të gjithë.

Allahu është hidhëruar me të gjithë, kështu i ka dërmuar dhe i ka përfshi në dënim, e nuk ka shpëtuar asnjëri prej tyre.

Përfundim

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿١٤﴾ فَكَذَّبُوهُ فَعَقَرُوهَا فَدَمْدَمَ عَلَيْهِمْ رَبُّهُمْ بِذُنُوبِهِمْ فَسَوَّاهَا

“Ata nuk i besuan atij dhe atë (devenë) e therën dhe Zoti i tyre për shkak të mëkatit të tyre ua rreshtoi ndëshkimet dhe i rrafshoi.” (*Esh-Shems: 14*)

Salihu a.s.:

- I ka thirr në monoteizëm për t’u larguar nga politeizmi, e kanë përgënjeshtuar.

- Prapëseprapë kanë përgënjeshtuar.

- Prapëseprapë kanë mohuar dhe e kanë përgënjeshtuar peygamberin e Allahut.

- Prapëseprapë i kanë dëgjuar epshet e tyre, dëshirat e tyre.

- Prapëseprapë e kanë dëgjuar shejtanin.

Për këtë arsye janë dënuar.

I kanë kërkuar argumente, e ka sjellë devenë argument, atëherë deveja ka dalë nga shkëmbi.

Dënimi pas tri ditëve, deveja një ditë populli një ditë. Janë pajtuar të gjithë për mbytjen e devesë, i vogël e i madh, plak, femër e mashkull.

Dënimi i ka përfshi të madh e të vogël.

Ai rebel, nuk i ishte frikësuar pasojës së atij veprimi.

Thënia e Allahut: “Fe demdeme” ka kuptimin: Allahu i ka dënuar me dënim drithërues për ta. Pra dënim i cili i ka dridhë dhe i ka dërmuar.

Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿١٥﴾ وَلَا يَخَافُ عُقْبَاهَا

“Duke mos iu frikësuar prapavisë së atij (ndëshkimi).” (*Esh-Shems: 15*)

Aktivi i foljes (veprues) është për rebeluesin, i cili e ka pre devenë.

Ekziston mundësia është për Allahun e Madhërishëm. Pra, Allahu vepron mbi ta siç dëshiron dhe nuk pyet askënd për veprimet e Tij.

Ekziston mundësia që është për Salihun a.s. Pra, Salihu nuk është frikësuar, për atë se si Allahu do t’i dënon për veprën (kriminale) e tyre. Përderisa i kishte paralajmëruar më herët.

Allahu ka mundësi për çdo gjë.

Allahu nuk i frikohet askujt.

Duke e falënderuar Zotin po e përfundojmë komentimin e sures Shems.

SURETU LEJL

Suretu Lejl

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَى ﴿١﴾ وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّى ﴿٢﴾ وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنثَى ﴿٣﴾ إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّى ﴿٤﴾ فَأَمَّا مَنْ أَعْطَى وَاتَّقَى ﴿٥﴾ وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَى ﴿٦﴾ فَسَنِيْسِرُهُ لِلْيُسْرَى ﴿٧﴾ وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى ﴿٨﴾ وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى ﴿٩﴾ فَسَنِيْسِرُهُ لِلْعُسْرَى ﴿١٠﴾ وَمَا يُغْنِي عَنْهُ مَالُهُ إِذَا تَرَدَّى ﴿١١﴾ إِنَّ عَلَيْنَا لَلْهُدَى ﴿١٢﴾ وَإِنَّ لَنَا لَلْآخِرَةَ وَالْأُولَى ﴿١٣﴾ فَأَنْذَرْتُكُمْ نَارًا تَلَظَّى ﴿١٤﴾ لَا يَصْلَاهَا إِلَّا الْأَشْقَى ﴿١٥﴾ الَّذِي كَذَّبَ وَتَوَلَّى ﴿١٦﴾ وَسَيُجَنَّبُهَا الْأَتْقَى ﴿١٧﴾ الَّذِي يُؤْتِي مَالَهُ يَتَزَكَّى ﴿١٨﴾ وَمَا لِأَحَدٍ عِنْدَهُ مِنْ نِعْمَةٍ تُجْزَى ﴿١٩﴾ إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِ الْأَعْلَى ﴿٢٠﴾ وَلَسَوْفَ يَرْضَى ﴿٢١﴾

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin për ta analizuar dhe për ta studiuar për ta mësuar dhe për ta praktikuar.

Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin ta lexojmë dhe të veprojmë me të. Ta analizojmë dhe ta studiojmë. Ta studiojmë dhe ta praktikojmë.

Qëllimi kryesor i Kur'anit është analiza, studimi dhe mësimi. Zoti i madhërishëm thotë:

كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ مُبَارَكٌ لِيَدَّبَّرُوا آيَاتِهِ وَلِيَتَذَكَّرَ أُولُو الْأَلْبَابِ ﴿٢٩﴾

“(Kur’ani) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë ajetet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Sad, 29)

Ne kemi nevojë t’i studiojmë suret dhe ajetet Kur’anore dhe ta analizojmë, që të përfitojmë dhe ta praktikojmë.

Çdo sure e ka specifikën me të cilën specifikohet.

Si çdo sure edhe suretu Lejl e ka specifikën e vet të cilën do ta sqarojmë.

Do të kalojmë disa çaste me suren Lejl që të përfitojmë nga kjo sure me vlerë dhe rëndësi të madhe.

Kjo sure flet për dallimin e njerëzve dhe shpërblimet e tyre.

Njerëzit me mjetin e jetës së tyre ndryshojnë në qëllimet e tyre.

Njerëzit me mjetin e tyre të jetesës dallojnë në opinionet e tyre.

Njerëzit ndryshojnë në veprat e tyre dhe në aktivitetet e tyre.

Njerëzit ndryshojnë në veprat e tyre dhe në ambiciet e tyre.

Kjo për shkak të ndryshimit të ideve të tyre, dëshirave të tyre dhe të opinionëve të njerëzve.

Njerëzit ndryshojnë në zbatimin e rregullave fetare.

Njerëzit ndryshojnë në edukatë, në moral dhe në organizim të jetës.

Secili njeri përgjatë rrugës i siguron vetes atë që do ta fiton në të ardhmen e jetës së tij dhe të botës tjetër të tij.

- Sa i përket të devotshmëve: Ata qëndrojnë në rrugën për të realizuar të mira, për këtë shpërblehen në xhenet.

- Sa i përket të devijuarve dhe të humburve: Ata qëndrojnë në rrugën e cilësive të këqija, kështu për shkak të krimeve të tyre, për shkak të këqijave të tyre. do të hidhen në zjarr të xhehenemit.

Për të shpëtuar nga xhehenemi nuk i bënë dobi as familja, as pasuria, as shoku i ngushtë.

Besimtarë të nderuar!

Zoti i Madhërishëm thotë:

وَاللَّيْلِ إِذَا يَغْشَى ﴿١﴾

وَالنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّى ﴿٢﴾

“Pasha natën që me errësirë mbulon gjithësinë!

Pasha ditën kur ajo shkrepin!” (El-Lejl: 1, 2)

Allahu betohet në natën e cila me errësirën e vet mbulon çdo gjë e cila ka qenë e ndriçuar.

Betohet në ditën e cila shfaqet dhe shihet qartë, pasi e mënjanon errësirën e natës.

Është betuar në kohën në të cilën kryhen obligimet dhe detyrat, veprimet e njerëzve varësisht prej nevojave dhe qëllimeve.

Është betuar në natën e cila e errëson tokën me errësirën e saj që më pastaj njerëzit pushojnë, qetësohen, flenë nga lodhja dhe mundimet e ditës.

Pastaj betohet në ditën e cila ndriçon për krijesat me dritën e saj ku shpërndahen njerëzit për realizimin e qëllimeve të tyre.

Pastaj Zoti i madhërishëm thotë:

وَمَا خَلَقَ الذَّكَرَ وَالْأُنثَىٰ ﴿٣﴾

“Pasha Atë që krijoi mashkullin e femrën!” (El-Lejl: 3)

Zoti është betuar në atë që ka krijuar mashkull dhe femër në të gjitha llojet, të njerëzve dhe të tjerave.

Zoti është betuar në krijesat e Tij dhe përsosmërinë e Tij, në ata krijesa, në të gjitha ato që dëshirojnë të mbeten dhe të mos zhduken.

E ka bërë që të komplimentojnë njëri-tjetrin.

Për këtë i Takon falënderim krijuesit, më të mirit.

Besimtarë të nderuar!

Cila është arsyeja e betimit?

Përgjigja e betimit apo arsyeja e betimit:

إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّى ﴿٤﴾

“Pa dyshim se angazhimet (veprimtaritë) e juaja janë të shumta.” (El-Lejl: 4)

O njerëz, aktiviteti i juaj është i llojlojshëm varësisht prej nevojave, aftësive, dhe vazhdon angazhimi i asaj vepre dhe fiton ai cili kryen një punë për Allah.

O njerëz, aktiviteti i juaj është i llojlojshëm varësisht prej qëllimeve a ke vepruar për Allah dhe vazhdon angazhimi i asaj vepre dhe fiton ai cili kryen një punë për Allah.

O njerëz, aktiviteti i juaj është i llojlojshëm varësisht prej nevojave, aftësive, varësisht prej qëllimeve se a ke vepruar për Allah dhe vazhdon angazhimi i asaj vepre dhe fiton ai cili kryen një punë për Allah.

Po mos e ka pas për qëllim të interesit të kësaj bote dhe i zhvlerësohet angazhimi.

Të gjitha veprat e njerëzve janë të ndryshme dhe janë larg njëra-tjetrës.

Të gjitha veprat dallojnë shumë nga njëra-tjetra.

Vepra:

- ose e mira
- ose e keqe.

Vepra:

- ose udhëzuesja,
- ose devijuesja.

Vepra:

- ose me çka fitohet kënaqësia e Zotit, me të cilat fitohet xheneti,
- ose ajo me çka fitohet hidhërimi i Zotit, me të cilat meritohet xhehenemi.

Aktiviteti i juaj është i llojlojshëm.

Veprimtaria juaj është e llojlojshme.

Angazhimi i juaj është i llojlojshëm varësisht prej qëllimeve, varësisht prej dëshirave, varësisht prej nevojave.

A ke vepruar për Allah!?

A ke vepruar për qëllime të kësaj bote ashtu që ato vepra zhvlerësohen!

Pastaj Allahu tregon për dy kategori njerëzish dhe dy nënkategori.
Kategoria e parë:

﴿٥٥﴾ فَأَمَّا مَنْ أُعْطِيَ وَاتَّقَى

“E sa i përket atij që jep dhe ruhet,” (El-Lejl: 5)

- Besojnë në Zotin.
- Besojnë në ditën e gjykimit.
- Besojnë në llogaridhënie.
- Largohet prej haramëve,
- i kryen obligimet e pasurisë si f.v.: Zekatin, Kefaretet,
- jep sadaka, me fjalë tjera jep lëmoshë,
- shpenzon në të mira,
- E kupton se pasuria është pasuri e Allahut. Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٣٥﴾ كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ ۖ وَنَبْلُوكُم بِالشَّرِّ وَالْخَيْرِ فِتْنَةً ۚ وَإِلَيْنَا تُرْجَعُونَ

“Ne, në shenjë sprove ju sprovomë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne”. (Enbija, 35)

﴿٦٦﴾ وَصَدَقَ بِالْحُسْنَىٰ

“Dhe vërteton bindshëm për më të mirën,” (El-Lejl: 6)

- Beson në shpërblim shpagim,
- Beson në xhenet dhe në të mirat e xhenetit.
- Beson në premtimin e Zotit siç thotë Zoti i Madhërishëm:

﴿٥٦﴾ لِلَّذِينَ أَحْسَنُوا الْحُسْنَىٰ وَزِيَادَةٌ ۖ وَلَا يَرْهَقُ وُجُوهَهُمْ قَتَرٌ وَلَا ذِلَّةٌ ۚ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ

﴿٢٦﴾ الْجَنَّةِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ

“Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (Xhenneti) edhe më tepër (e shohin All-llahun). Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi, as nënçmimi, ata janë banues të Xhennetit, aty janë përgjithmonë”. (Junus, 26)

Cili është rezultati i kësaj kategorie?

(Përgjigja)

E do t'ia lehtëson Zoti çështjen e tij.

Besimtarë të nderuar!

Sa i përket kategorisë së dytë:

Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë të padëgjueshmit.

وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى ﴿٨﴾

وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى ﴿٩﴾

فَسَنِيْسِرُهُ لِّلْغُسْرَى ﴿١٠﴾

“E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti),

Dhe që mohon atë më të mirën,

Ne do ta përgatisim për më të vështirën.” (El-Lejl: 8-10)

I padëgjueshmi e pason rrugën e mëkateve dhe shpaguhet për mëkate, me fjalë tjera dënohet.

I padëgjueshmi bëhet koprrac në pasuri. Ai dëshiron vetëm famë. Ai dëshiron vetëm pozitë.

I padëgjueshmi keqpërdorë, shpenzon pa nevojë.

I padëgjueshmi nuk shpenzon në gjërat e nevojshme dhe të domosdoshme.

Bile nuk i mjafton vetëm kjo:

I padëgjueshmi e ndien veten të pavarur prej Allahut.

I padëgjueshmi nuk e adhuron Allahun.

I padëgjueshmi s’ka shpëtim.

I padëgjueshmi e harron krijuesin.

I padëgjueshmi e harron Zotin.

I padëgjueshmi e ka harruar atë i Cili ia ka dhënë shikimin, dëgjimin dhe mendjen.

I padëgjueshmi e ka harruar Atë i cili i ka dhënë pasuri dhe nuk falënderon.

Ku do të shkon?

Do të shkon te Zoti, siç thotë Zoti i Madhërishëm:

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنَافٍ ﴿٦﴾

أَن رَّاهُ اسْتَغْنَى ﴿٧﴾

إِنَّ إِلَىٰ رَبِّكَ الرُّجْعَىٰ ﴿٨﴾

أَرَأَيْتَ الَّذِي يَنْهَىٰ ﴿٩﴾

“Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë. Për shkak se e ndien veten të pavarur. Po kthimi është vetëm te Zoti yt”. (Alek: 6-9)

I padëgjueshmi e përgënjeshtroi shpagimin, premtimin e Zotit. E përgënjeshtroi xhenetin dhe xhehenemin.

Të padëgjueshmin e mashtroi pasuria, shëndeti, forca dhe pozita.

Sa i përket kësaj kategorie: E kanë harruar Zotin e edhe Zoti i harron. Kjo kategori e kanë harruar veten.

Vëllezër të nderuar!

Ebu Bekri Sidiki r.a. lironte robër në Mekë për ta pranuar Islamin.

Ebu Bekri i lironte të dobëtit dhe të ngratit me kushtin që ta pranonin Islamin.

Babai i tij (Ebu Kahafe) i ka thënë:

Biri im, po e shoh se po i liron të dobëtit.

Çka mendon sikur t'i liroje burrat e fortë të cilët po të sulmojnë.

Çka mendon sikur t'i liroje burrat e fortë të cilët po të pengojnë.

Ebu Bekri i thotë: O babai im, unë dëshiroj atë që dëshiron Allahu.

Atëherë ka zbritur ajetet:

﴿٥﴾ فَأَمَّا مَنْ أَعْطَى وَاتَّقَى

وَصَدَّقَ بِالْحُسْنَى

فَسَنِيَّ لَهُ لُيُوسَى ﴿٧﴾

“E sa i përket atij që jep dhe ruhet,

Dhe vërteton bindshëm për më të mirën,

Ne do ta përgatisim atë për më të lehtë.” (El-Lejl: 5-7)

Aktivistët janë dy llojesh:

- Ai i cili jep për mirësi dhe në rrugë të Allahut, njëkohësisht frikësohet ndalesave të cilat i ka ndaluar Allahu dhe beson në xhenetin.

- Ai i cili jep për mirësi dhe në rrugë të Allahut dhe beson se do të shpërblehet, atëherë do ta marrim për dore dhe do t’ia lehtësojmë çdo vepër obligative, pra për t’i vepruar, ose kur nuk duhet vepruar.

“husna” e ka kuptimin e xhenetit.

“jusra” - gjendjen e mirë dhe të kënaqshme në këtë botë dhe në botën tjetër.

Vëllezër të nderuar!

Në anën tjetër Umeje bin Halefi ka qenë koprrac, për të kanë zbritur ajetet në vazhdim:

﴿٨﴾ وَأَمَّا مَنْ بَخِلَ وَاسْتَغْنَى

وَكَذَّبَ بِالْحُسْنَى

فَسَنِيَّ لَهُ لُغُوسَى ﴿١٠﴾

“E sa i përket atij që bën koprraci dhe e ndien veten të pavarur (nga Zoti),

Dhe që mohon atë më të mirën,

Ne do ta përgatisim për më të vështirën.” (El-Lejl: 8-10)

Sa i përket atij i cili është dorështrenguar në pasurinë e tij, dhe nuk shpenzon asgjë në rrugën e Allahut dhe në rrugën e së mirës, dhe thotë se nuk ka nevojë për Allahun dhe në mëshirën e tij, dhe vetëkënaqet me dëshirat e kësaj bote dhe nuk mendon për të mirat e botës tjetër.

Pastaj, nuk i interesojnë Shpërblimet dhe mirësitë e Allahut.

Pastaj, edhe përgënjeshtrojnë se ka shpërblime në botën tjetër, atëherë e marrim për dore dhe ia lehtësojmë rrugën e vështirë e cila prodhon vetëm të këqija, saqë e ka të vështirë të shkon rrugës së mirë dhe të përmirësimit, dhe bëhet i dobët për punët e mira, deri sa të mbërrijë në xhehenem.

وَمَا يُغْنِي عَنْهُ مَالُهُ إِذَا تَرَدَّى ﴿١١﴾

“E pasuria e tij nuk do t’i bëjë dobi, kur ai të zhduket.” (El-Lejl: 11)

Mirëpo atëherë nuk i bënë dobi pasuria, të cilën se ka dhënë në bamirësi kur të shkon në xhehenem.

Kur të flet për të mirën dhe për të keqen, atëherë lehtësimi bëhet për të dyja rrugët:

- Bujaria (dhënia) dhe

- Koprracia,

kanë të bëjë vetëm në çështjet materiale.

Njeriu kur të vdes nuk i bën punë ajo pasuri edhe nëse e paraqet tek Allahu.

Nëse njeriu nuk e jep pasurinë për botën tjetër, ajo pasuri do të jetë mallkim për atë njeri.

Vëllezër të nderuar!

Pasi i ka përmend dy kategori të njerëzve, informon se i ka sqaruar dy rrugë:

- E ka sqaruar rrugën e drejtë, mirëpo është larguar,

- E ka sqaruar rrugën e drejtë dhe me zgjedhjen e lirë e ka trasuar dhe e ka pasuar.

“Inne alejna lel huda” - Sqaron rrugën e drejtë e cila të dërgon tek Allahu dhe në të cilën rrugë fitohet kënaqësia e Allahut.

Sa i përket rrugës së humbur, ajo e dërgon njeriun aty ku do të dënohet.

Jeta e kësaj bote dhe e botës tjetër është pronë e Allahut. Vetëm Zoti e ka në kompetencë çështjen e botës tjetër dhe të kësaj bote.

Vëllezër të nderuar!

Allahu i Madhërishëm tregon për çështjen e udhëzimit, dhe të sigurimit të udhëzimit ku thotë:

إِنَّ عَلَيْنَا لَلْهُدَىٰ ﴿١٢﴾

وَإِنَّ لَنَا لَلْآخِرَةَ وَالْأُولَىٰ ﴿١٣﴾

“Detyrë e jonë është vetëm të udhëzojmë.

Dhe vetëm e Jona është bota tjetër si dhe kjo.” (*El-Lejl: 12, 13*)

Thënia e Allahut: “idha teredda” ka kuptimin: Ka ra në xhehenem, pra prej pjesëve të xhehenemit.

Zoti e ka përsipër që të sqarojë rrugën e së mirës dhe së keqes, dhe rrugën e udhëzimit dhe të devijimit, të hallallit dhe të haramit.

Këtë e ka bë nëpërmjet peygamberëve dhe librave të cilat përmbajnë ligjet dhe dispozitat të cilat sqarojnë besimin, adhurimin, moralin dhe çështjen e akteve dhe të veprimeve dhe raporteve ndërnjerëzore.

Ne, në secilin botë, në atë të botës tjetër, dhe në çdo rast të kësaj bote, veprojmë si të dëshirojmë. Ai i cili dëshiron diçka për të dy botët, le të kërkon nga Ne, i japim dhe i dhurojmë çka të dëshiron kush të dëshiron. Nuk na dëmton asgjë fakti që ndonjërin e këshillojmë (udhëzojmë) e nuk e pranon këshillën (udhëzimin).

Si udhëzimi, si mosudhëzimi nuk përbënë asgjë te Ne, por dobia e udhëzimit dhe dëmi i mosudhëzimit kthehet te ju, o ju njerëz.

فَأَنْذَرْتُكُمْ نَارًا تَلَظَّى ﴿١٤﴾

لَا يَصْلَاهَا إِلَّا الْأَشْقَى ﴿١٥﴾

الَّذِي كَذَّبَ وَتَوَلَّى ﴿١٦﴾

“Unë ua kam tërhequr vërejtjen për zjarrin të ndezur fort.

Që aty nuk hyn tjetër kush, pos atij që është më i prishuri.

I cili përgënjeshtroi dhe u zmbraps.” (*El-Lejl: 14-16*)

Allahu tërheqë vërejtjen që të mos shkohet rrugës së zjarrit ku thotë:

“Unë veç ju kam paralajmëruar për zjarrin i cili do të ju përvëlonte.” (*El-Lejl: 14*).

Unë ju kam frikësuar për një zjarr të madh i cili flakëron, djegë, përvëlon dhe përcëllon. Aj zjarr i djegë vetëm të padëgjueshmit pabesimtarë të cilët e kanë përgënjeshtuar të vërtetën me të cilën kanë ardhur pejgamberët, e prej tyre kanë përgënjeshtuar pejgamberin a.s. i cili ka ardhur me Kur'anin.

Pastaj tërheq vërejtjen. Në xhehenem do të hyjë ai i cili përgënjeshton të mirat e Allahut.

Në xhehenem do të hyjë ai i cili refuzon urdhrat e Allahut.

﴿١٧﴾ وَسَيُجَنَّبُهَا الْأَتْقَى

“Ndërsa ai që është më i devotshëm do të jetë larg tij.” (El-Lejl: 17)

Nga xhehenemi largohet dhe mënjanohet i devotshmi, i cili e pastron shpirtin, pastrohet prej mëkateve dhe imoralitetit, të cilët veprojnë të mira vetëm për Allah.

الَّذِي يُؤْتِي مَالَهُ يَتَزَكَّى ﴿١٨﴾

وَمَا لِأَحَدٍ عِنْدَهُ مِنْ نِعْمَةٍ تُجْزَى ﴿١٩﴾

إِلَّا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِ الْأَعْلَى ﴿٢٠﴾

وَلَسَوْفَ يَرْضَى ﴿٢١﴾

“Ai që e jep pasurinë e vet e pastrohet,

E jo për ta shpërblyer ndokë që i ka bërë mirë më parë.

Por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të lartit,

Për Zotin, ai do të gëzojë atë kënaqësi!” (El-Lejl: 18-21)

Me fjalën “Nuk e djegë” ka për qëllimin nuk djegë me djegie të përgjithmonshme. Do të largohet nga zjarri çdonjëri i cili i është frikësuar pabesimit.

Do të largohet nga zjarri çdonjëri i cili i është frikësuar mëkateve.

E, i tilli është ai i cili shpenzon pasurinë duke dhënë në rrugë të dobishme, me qëllim që te Zoti të shkon i pastër.

Qëllim që te Zoti të shkon i pastër prej mëkateve dhe gabimeve, duke mos shpenzuar (donuar) për famë e syfaqësi, “i cili është pastruar” - qëllimi është për Ebu Bekri Sidikin r.a.

Thënia e Allahut “Jetezeka” ka kuptimin edhe të pastrimit edhe të zhvillimit (shtimit) të pasurisë.

Aspekti i jashtëm tregon për ndihmat vullnetare.

- ai, nuk jep ndihma vullnetare për të kërkuar kompensim nga njerëzit,
- ndihmat vullnetare të tij nuk janë që të kërkon t'i kompensohet ajo e cila i është dhënë, por ajo bëhet vetëm e vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut të Lartmadhërishëm,
- që shpërblimi të jetë vetëm shpërblimi i kënaqësisë së Allahut e, jo ndonjë shpërblim tjetër.

Allahu do të jetë i kënaqur me atë që jep me bujarinë e tij, dhe do ta shpërblen me shpërblim të madh.

Thënia e Allahut “vetëm për kënaqësinë e Allahut” është përjashtim i ndërprerë.

Përfundim

Thënia e Allahut: **“E, pastaj do të jetë i kënaqur”**.

Allahu i Madhërishëm i premtonte Ebu Bekrit se në botën tjetër ai do të jetë i kënaqur.

Vetëm Zoti shpërblen. Nuk ka vlerë puna pa njet.

Falënderojmë Zotin që e përfunduam komentimin e sures Lejl.

Përmbajtja:

DHIKRI PARA HUTBES SË XHUMASË.....	4
SURETU NEBEË (1)	5
SURETU NEBEË (2)	12
SURETU NEBEË (3)	20
SURETU NAZIATË (1).....	26
SURETU NAZIATË (2).....	31
SURETU NAZIATË (3).....	35
SURETU ABESE (1)	42
SURETU ABESE (2)	47
SURETU TEKVIRË (1)	55
SURETU TEKVIRË (2)	61
SURETU INFITARË	66
SURETU MUTAFFIFINË (1)	74
SURETU MUTAFFIFINË (2)	80
SURETU INSHIKAKË (1).....	87
SURETU INSHIKAKË (2).....	95
SURETU BURUXHË.....	101
SURETU TARIKË (1).....	113
SURETU TARIKË (2).....	119
SURETU EALA	123
SURETU GASHIJE (1).....	132
SURETU GASHIJE (2).....	140
SURETU FEXHR (1).....	146
SURETU FEXHR (2).....	153
SURETU FEXHR (3).....	157
SURETU BELED.....	165
SURETU SHEMS	175
SURETU LEJL	183